



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 10, 11 DHE 17 PRILL 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 10., 11. I 17. APRILA 2014. GODINE**

**PRILL - APRIL
2014**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin shëndetësor,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013,
11. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
12. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës,
13. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
14. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore,
15. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Vreme za deklaracije izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma za izvozni kredit između Republike Kosovo i Unicredit Banka Austria AG za finansiranje Projekta “Modernizacija sistema obrazovanja na Kosovu kroz E-obrazovanje”,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o visokom obrazovanju u Republiku Kosova,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o javnim preduzećima,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o kinematografiji,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o zdravstvenom osiguranju,
9. Razmatranje Izveštaja Komisije za obrazovanje, kulturu, omladinu, sport, javnu upravu lokalnu samoupravu i medije o nadgledanju sprovođenja Zakona o visokom obrazovanju u Republiku Kosova,
10. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Nezavisnog nadzornog odbora za civilnu službu Kosova za 2013. godinu,
11. Razmatranje Predloga-odluke Vlade Republike Kosova o imenovanju predsedavajućeg i članova Komisije za zaštitu konkurencije,
12. Razmatranje Predloga-odluke Vlade Republike Kosova o imenovanju članova u nacionalnom naučnom savetu,
13. Imenovanje članova Upravnog odbora Sudskog instituta Kosova,
14. Imenovanje člana u Komisiji za imovinske zahteve, i
15. Izbor jednog člana Nezavisne Komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetëve 3 minuta.

Veç të sqarojmë, a ka në emër të grupeve? Një, dy, nuk ka. Atëherë shkojmë sipas radhës.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më 21 tetor 2011, këtu në Kuvend, në pikën për deklarime jashtë rendit të ditës, e pata ngrehur shqetësimin rreth mospërkujdesjes institucionale për komplekset memorialë, me theks të veçantë për memorialin e UÇK-së në Morinë të Skenderajt, ku janë të skalitur emrat e të gjithë dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pas deklarimit tim, deputetët e këtij Kuvendi e kanë marrë një letër nga ideatori dhe sponsorizuesi i atij projekti amerikan Benito Mares, në dhjetor të vitit 2011. Faza e parë e punimeve të këtij projekti është financuar nga donatori Benito Mares, ndërsa faza e dytë e punimeve ishte financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Që nga themelimi i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Republikës së Kosovës, ky kompleks me karakter kombëtar ka mbetur në mëshirën e fatit dhe është shkatërruar tërësisht, ndërsa tani para 3-4 ditësh jemi dëshmitarë që ky kompleks është mbyllur dhe i është vënë çelësi nga vetë donatori, ose ideatori i këtij projekti, Benito Mares.

Mbyllja e këtij memoriali është ofendim për të gjithë dëshmorët dhe familjarët e tyre, është ofendim për shtetin tonë.

Prandaj, kërkoj nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës që urgjentisht të merret me këtë çështje dhe t'i hiqet dryni i atij kompleksi që është krenaria e kombit, që është krenaria e Kosovës, në përgjithësi.

Dua të citoj një fjalë që e pati shkruar Benito Mares në letrën që ua pati drejtuar atëherë deputetëve të Kosovës, ku, ndër të tjera, thotë: “Nderi dhe respekti i çdo kombi

reflektohet nga mënyra se si njerëzit i nderojnë dhe i respektojnë ata që e sakrifikuan jetën e tyre për ta, sidomos për të rinjtë. Ndërtimi dhe përkujdesja për mbrojtjen e përmendoreve dhe monumenteve janë burimi kryesor i krenarisë dhe patriotizmit. Pa krenari dhe patriotizëm kombet do të dështojnë përsëri dhe do të shkojnë drejt nënshtrimit”.

Mendoj që këto fjalë edhe një herë do ta thërrasin në ndërgjegje Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës dhe urgjentisht ta hapin atë memorial, i cili në pritje të investimeve dhe përfundimeve të punimeve ka mbetur i mbyllur dhe fatkeqësisht dëshmorët e Skenderajt, të cilët duhej të vendoseshin në atë kompleks ende gjenden në një lokacion jo të përshtatshëm dhe jo të merituar për dëshmorët e kombit.

Prandaj, urgjentisht kërkoj nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë që të ndërmarrë masa dhe të hapet ky kompleks memorial. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Pasi jemi te kompleksi, kur kemi diskutuar për Ligjin për buxhetin, unë e kam marrë fjalën dhe ju kam thënë që Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Urbanizmit nuk ia ka derdhur agjencisë buxhetin që e ka merituar me ligj, e ligjin ne e kemi miratuar.

Prandaj, agjencia nuk e ka përgjegjësinë, përgjegjësia është e Qeverisë dhe e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Dhe, ne si deputetë e kemi përgjegjësinë se kemi votuar që buxheti t'i mbetet Ministrisë, e jo Agjencisë për Mirëmbajtjen e Komplekseve Memorialë.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Do të doja që në emër të Grupit të shfaq shqetësimet e grupit dhe tonat, në përgjithësi, për zhvillimet e fundit rreth emërimit nëpër agjenci të ndryshme që po i bën Qeveria.

Konkretisht e kam fjalën për Agjencinë Qendrore të Prokurimit, ish-Agjencia e Prokurimit Publik, e cila është krijuar fillimisht në kuadër të Qeverisë, e tani me ndryshimet që janë bërë më vonë në ligj është pjesë e Ministrisë së Financave.

Sipas Ligjit të prokurimit publik të vitit 2003, në fuqi deri më 31.8.2011, Agjencia e Prokurimit Publik është udhëhequr nga drejtori dhe Bordi Ekzekutiv i zgjedhur me propozimin e Qeverisë dhe pas miratimit nga Kuvendi.

Po sipas këtij ligji, nga 1 korriku 2009, Bordi Ekzekutiv i Agjencisë së Prokurimit Publik është paraparë që të shpërbëhet dhe Agjencia Prokurimit Publik të administrohet vetëm nga drejtori ekzekutiv.

Kandidati është dashur të propozohet nga Qeveria dhe të aprovohet nga Kuvendi.

Në tetor të vitit 2008, drejtor i Bordit atëherë ka qenë një drejtoreshë, e cila pati dhënë dorëheqje dhe Qeveria, duke e aplikuar nenin 92.2 të ligjit në fjalë e kishte emëruar një ushtrues detyre të drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, afërsisht nëntë muaj, po e nënvizoj - nëntë muaj para se ky nen të hynte në fuqi, neni 92.2 ka mundur të zbatohet vetëm nga 1 korriku 2009.

Edhe pas skadimit të mandatit të Bordit më 1 korrik 2009, Qeveria ka vazhduar ta mbajë pozitën e drejtorit ekzekutiv me ushtrues detyre, duke e anashkaluar emërimin e tij nga Kuvendi, ashtu siç e kërkonte Ligji paraprak për prokurimin publik.

Kështu që kryeministri ka vazhduar ta mbajë pozitën e këtij drejtori ekzekutiv të Agjencisë së Prokurimit Publik me ushtrues detyre për gati gjashtë vjet me radhë, në kundërshtim të plotë me Ligjin e prokurimit publik.

Neni 7 i Ligjit për prokurimin publik, në fuqi deri më 31.8.2011, ka kërkuar, ndërmjet tjerash, po citoj: “Në rast të largimit, dorëheqjes, vdekjes ose paaftësisë së drejtorit të APP-së për ta ushtruar detyrën, Qeveria do ta emërojë një drejtor të përkohshëm. Drejtori i përkohshëm i emëruar sipas këtij paragrafi nuk do të shërbejë në këtë pozitë më shumë se gjashtë muaj”.

Nëse Qeveria e emëron një drejtor të përkohshëm sipas këtij paragrafi, Qeveria menjëherë do të filloj procesin e identifikimit të kandidatëve dhe propozimin e tyre e përcjell në Kuvend, gjë që nuk ka ndodhur.

Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk e ka iniciuar emërimin e drejtorit sipas kërkesave të ligjit dhe nuk e ka respektuar procedurën e zgjedhjes së drejtorit ekzekutiv, duke e anashkaluar plotësisht Kuvendin dhe në mënyrë krejtësisht kundërligjore e ka mbajtur këtë pozitë me ushtrues detyre.

Tash së fundi, duke e parë se kësaj Qeveria po i vjen fundi dhe me qëllim që të vendosen militantët në pozita kyçe, kjo Qeveri e ka iniciuar procesin e zgjedhjes së drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Qendrore të Prokurimit nëpërmjet konkursit, përkatësisht Këshillit për Emërime të Larta, ashtu siç po bën edhe në shumë agjenci dhe institucione tjera.

Zoti kryetar,

Po e tërheq edhe një herë vërejtjen: shkelje të shumta të ligjit që e ka miratuar ky Kuvend janë bërë me këtë rast. Pas gjashtë vjetësh, po e përsëris, të mbajtjes në detyrë ‘ushtrues detyre’, e që ka pasur të drejtë vetëm gjashtë muaj, tash ka shpallur konkurs. Do të thotë, kjo dukuri është jashtëzakonisht shqetësuese dhe për këtë dikush do të duhej të jepte përgjegjësi.

Dhe, kemi shumë raste nëpër seancat tona, tash kur po na vijnë propozime të tilla, absolutisht pa mbulesë edhe të paarsyeshme, me të vetmin qëllim që t’i vendosin njerëzit e vetë jashtë çdo kriteri. Këtu ka bazë për të hetuar se çfarë ka ndodhur në këtë Agjenci të Prokurimit Publik dhe ky shqetësim yni është shqetësim ligjor. Është shkelur ligji që është miratuar nga ky Kuvendi, zoti kryetar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Realisht, kjo është për pyetje parlamentare, ose çështje për komisionin përkatës, se janë komisionet që i mbikëqyrin agjencitë. Po unë po të adresoj se kjo çështje është e komisioneve përkatëse. Ti mirë e pate po adresimi është për tjetërkund.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Faton Topalli, në emër të Grupit.

FATON TOPALLI: Të nderur deputetë,

Në qoftë se në Kosovë ka një sektor, i cili e ka potencialin më të madh për krijimin e vendeve të reja të punës, nuk ka dyshim që ky është sektori i bujqësisë, respektivisht i prodhimit të ushqimit dhe agrobiznesit. Qeveria e Kosovës konsideron që numri i ekonomive bujqësore të jetë rreth 180 000. Të dhënat e sakta mungojnë për arsye se regjistrimi i fundit është bërë menjëherë pas luftës.

Ajo që dihet është që fermerët e Kosovës janë shumë të interesuar dhe të motivuar që këtë sektor ta zhvillojnë, modernizojnë dhe afirmojnë. Dhe ata kanë të drejtë, por thjesht u mungon përkrahja e mirëfilltë institucionale.

Kryeministri i Kosovës në fushatën e tij parazgjedhore ka premtuar që brenda 4 vjetëve të ardhshme në sektorin e bujqësisë do t'i investojë 500 milionë euro, që i bie për çdo vit nga 125 milionë.

Por, shikojeni ju lutem buxhetin që vetë kryeministri i Kosovës e ka planifikuar për vitin e ardhshëm. Ky buxhet tregon që vetëm 29 milionë euro janë planifikuar për bujqësinë. Pra, ku janë 125 milionë të tjerë? Edhe për vitin 2016, kryeministri nuk ka planifikuar asnjë cent më shumë se 29 milionë.

Kush vihet në dyshim për t'i besuar shkopit magjik të kryeministrit, apo fakteve të "Vetëvendosjes", le ta konsultojë Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014. Nëse del që unë po e them një të pavërtetë, jam i gatshëm që qysh nesër të jap dorëheqjen nga detyra e deputetit të Kuvendit të Kosovës.

E keqja e madhe është që edhe ky buxhet që ne kemi, gjithsej 27 milionë euro për këtë vit, po keqpërdoret nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Fermerët e Kosovës dhe tani nuk po flas në emrin tim, por në emrin e tyre, janë të indinjuar dhe të dëshpëruar me mungesën e transparencës në ndarjen e granteve qeveritare, por edhe ndarjes së tyre sipas kriterit partiak, familjar, afërsisë rajonale dhe lartësisë së përqindjes së ndarë për mitë.

Edhe ata që përfitojnë i marrin grantet me vonesë, detyrohen të paguajnë mitë, detyrohen t'i blejnë mjetet aty ku i urdhërojnë zyrtarët, ose i marrin në kohën kur kalojnë mbjelljet.

Kemi shumë përfitues të granteve që akoma nuk i kanë marrë ato, apo që i kanë marrë vetëm pjesërisht, edhe pse kanë kaluar më shumë se 3 muaj nga viti 2013.

Pse nuk ka transparencë?

Nuk ka transparencë, sepse Ministria e Bujqësisë nuk do të arrinte ndryshe t'i fshihte keqpërdorimet e buxhetit të Kosovës në Ministrinë e Bujqësisë.

Jo më larg se më 4 shkurt 2014, kryetari i Federatës së Sindikale të Bujqve të Kosovës, z. Tahir Tahiri, ka kërkuar me shkrim regjistrat e përfituesve të subvencioneve dhe granteve nga Ministria e Bujqësisë.

Lista e përfituesve të subvencioneve është publikuar, ndërsa ajo e granteve jo. Edhe pse kanë kaluar më shumë se dy muaj dhe në kundërshtim me Ligin për qasje në dokumentet publike, Ministria e Bujqësisë nuk ka dhënë asnjë përgjigje. Kjo është shumë e kuptueshme, sepse publikimi i listës së përfituesve do t'i nxirrte në shesh të gjitha malverzimet e Ministrisë karshi atyre fermerëve të ndershëm që kanë shumë nevojë për mbështetje, që janë të gatshëm të punojnë dhe të investojnë, por që nuk përfitojnë.

Edhe nëpër komuna gjendja nuk është fare e mirë. Ashtu si Ministria edhe drejtuesit komunalë sikur harrojnë që puna në bujqësi është stinore, pra ka afate kohore që kërkojnë planifikim dhe menaxhim të mirë, përndryshe investimet në bujqësi shkojnë kot.

Fermerëve të Ferizajt, pasi u është ndërprerë shpërndarja e herbicideve, të cilat i morën 4 vjet me radhë, u është premtuar se këtë vit se do ta marrin farën e misrit. Por, mbjelljet e misrit kanë filluar, ndërsa Drejtoria Komunale për Bujqësi është akoma në procedurën e tenderimit. Duke pas parasysh procedurat e tenderimit, pritjet për ankesa, kohën e shpërndarjes së farës, del që fermerët e Ferizajt do ta marrin farën e misrit atëherë kur afati i mbjelljeve të ketë përfunduar, ashtu siç i marrin shumë përfitues në Kosovë subvencionet dhe grantet me vonesë.

Vitin e kaluar kanë aplikuar mbi 5000 fermerë me projekte të ndryshme për grante investive, ndërsa vlera e paraparë vetëm për 3 000 projektet e para e ka kaluar shifrën prej 104 milionëve. Kjo tregon që fermerët janë shumë të interesuar të investojnë.

Buxheti i ndarë për grante ka qenë 14 milion euro, edhe pse këto para nuk janë dhënë të gjitha. Ka dyshime se një pjesë të kësaj shume i është ndërruar destinimi.

Sidoqoftë, shumë fermerë të cilët kanë lidhur kontratë me Ministrinë dhe i kanë përfunduar investimet, ende nuk i kanë marrë paratë e tyre. Për realizimin e investimit ata kanë marrë kredi me kamata të larta...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Unë flas në emër tim, jo në emër të grupit, dhe do ta ngre një çështje në lidhje me Radiotelevizionin e Kosovës. Ky medium publik, i cili është i formuar dhe nga Kuvendi i

Kosovës e ka për obligim që të mbajë një pasqyrim të mirë, një pasqyrim të vërtetë, edhe në lajme, edhe për të gjitha komunitetet.

Unë dua të them që Radiotelevizioni i Kosovës, edhe pse e ka pasuruar programin me RTK - 1, 2, 3, 4, të ju them të drejtën për komunitetin egjiptian nuk është kurrfarë fitimi në këtë drejtim, për arsye se e kemi një pasqyrim jo të mirë nga ky medium. Përveç që nuk kemi hapësirë në këtë medium, unë edhe një herë kam thënë dhe po them - nuk kam nevojë që të kem informacione në gjuhën time, se në gjuhën time amtare që po e flas kam informacione të mjaftueshme, por ndonjëherë është mirë që për shumë ngjarje, për ndonjë tryezë, për ndonjë gjë që e bën subjekti politik dhe e bën komuniteti, të na e pasqyrojë drejt.

Ndërsa më 8 prill, në lajmet e Radiotelevizionit të Kosovës ndodh që unë flas për banime joformale dhe Televizioni i Kosovës më nxjerr përfaqësues nuk e di të sa komuniteteve në Kosovë. Unë dua t'i them Radiotelevizionit të Kosovës se jam përfaqësues i komunitetit egjiptian dhe jam përfaqësues në të gjitha legjislaturat e Kosovës, e nuk jam përfaqësues i komunitetit RAE. Në këtë Kuvend janë bërë edhe rekomandimet që nuk ka komunitet RAE, e Televizioni i Kosovës, edhe mediet, edhe elektronike, edhe të shkruara, duhet t'i shqiptojnë mirë komunitetet ashtu siç janë në Kushtetutën e Kosovës.

Unë e di që aty ka gazetarë me 5 ose 6 muaj kurs, por nëse nuk dinë, është mirë që ta ftojnë zotin profesor Bajrami që t'ju shpjegojë për Kushtetutën dhe t'ju tregojë cilat komunitete jetojnë dhe veprojnë në Kosovës. Është mirë, është një e arritur, është edhe një aftësim për ata gazetarë dhe kështu nuk do të bëjnë gabime gjatë emetimeve të lajmeve.

Unë dua të theksoj që ky televizion, nëse ka ndonjë alergji ndaj meje, në vend që kur unë kur të flas, mund ta shfaqë Tunën duke kënduar ndonjë pikë muzikore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ky mandat qeveritar është afër përfundimit të tij dhe sa i përket sektorit të shëndetësisë gjatë kësaj periudhe, pa asnjë dilemë mund të them se ky sektor nuk ka pasur përparim, të paktën jo në praktikë.

Është e vërtetë se infrastruktura ligjore ka ndryshuar, por frytet e saj nuk kanë arritur të hetohen as përafërsisht. Institucionet publike e shëndetësore të nivelit sekondar dhe terciar vazhdojnë të jenë në gjendje shumë të rëndë: mungesa enorme e barnave dhe e materialit shpenzues, të cilat duhet të sigurohen nga vetë pacientët; mosfunksionimi i aparaturës që gjendet në spitale, për shembull aparati i CT-së në Radiologji, endoskopët gastroenterologjik e tjerë e tjerë; mungesa e aparaturës bashkëkohore, laboratorit biokimik jashtëzakonisht i varfër; mungesa e reagensëve elementarë dhe të domosdoshëm për diagnostifikim të sëmundjeve, por edhe për orientim të trajtimit të mëtutjeshëm të pacientëve dhe këto nuk janë të gjitha problemet. Ato janë shumë më të mëdha.

Këtë e ndiejmë për çdo ditë ne që e mbajmë mantelin e bardhë, por këto probleme përjetohen shumëfish më rëndë nga qytetarët, të cilët kërkojnë shërbime shëndetësore nëpër këto institucione. Ta zëmë se disa prej këtyre mungesave janë pasojë e buxhetit modest që posedon Ministria e Shëndetësisë, por shumë mangësi janë edhe pasojë e menaxhimit të dobët . Kur jemi te menaxhimi, vetë menaxherët apo drejtorët e klinikave, gjatë gjithë këtij mandati ishin në cilësinë e ushtruesve të detyrës. A është dashur buxhet edhe për zgjedhjen e drejtorëve, apo është thjesht në pyetje insuficienca shumë e rëndë menaxheriale e Ministrisë së Shëndetësisë. Për mua, maja e dështimit të kësaj ministrie është krijimi i Klinikës fantome të Kardiokirurgjisë. Promovimi ishte pompoz, rezultati zero.

Nëse janë bërë në fillim disa intervenime simbolike kardiokirurgjike, përderisa kërkesa është e vazhdueshme dhe shumë e madhe për intervenime të tilla dhe për të cilët pacientët tanë duhet të kërkojnë vazhdimisht ndihmë jashtë klinikës, sepse nuk mund të realizohen brenda, atëherë rezultati nuk mund të jetë më shumë se zero.

Nuk mund të besoj se ministri nuk e sheh këtë realitet, por ndiej keqardhje për mashtrimin që ka tentuar t'i bëjë popullatës, apo e ka harruar etikën, duke dashur t'i bëjë promovim politik vetes dhe subjektit të tij politik. Është logjikë e thjeshtë, një projekt i tillë si kardiokirurgjia nuk mund të realizohet kur i mungon komponenti kryesor, pra operatorët. Për ta plotësuar formën, kjo ministri ka ndarë edhe specializime nga kjo lëmi, por çka dhe nga kush të mësojnë këta specializantë që ta zotërojnë profesionin e tyre. Klinika fantome...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Edhe 5 sekonda, pasi je pa grup.

AURORA BAKALLI: ...është shembulli më i mirë që e ilustron këtë ministri, fjalë të mëdha dhe shumë, ndërsa vepra të prekshme pak. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do ta ngre edhe një herë çështjen të cilën e ngreha në seancën e kaluar, çështjen e Spitalit Regjional të Ferizaj, përkatësisht ndërrimin e lokacionit për ndërtimin e atij spitali.

Unë i kam dy dokumente këtu, e kam një kërkesë të drejtorit të spitalit që ia ka bërë kryetarit të Komunës, zotit Muharrem Svarça, dhe kryesuesit të Asamblesë komunale, zotëri Milazim Halitit, dhe njëkohësisht e kam një deklaratë për opinion të pothuajse mbi 90% të punonjësve të Spitalit Regjional të Ferizajt, përkatësisht të mjekëve specialistë.

Thotë: Spitali Regjional në Ferizaj

Për opinionin publik dhe institucional të komunës së Ferizajt nga menaxhmenti dhe mjekët specialistë të Spitalit regjional të Ferizajt,
Datë 4. 4.2014

D e k l a r a t ë

Në lidhje me vendimin e Asamblesë komunale për ndërrimin e lokacionit të paraparë për ndërtimin e spitalit të ri, më 31.3.2014, me arsyetim se kjo bëhet në mbështetje të kërkesës së Bordit Drejtues dhe personelit specialist në këtë institucion, ju njoftomë se:

1. Në këtë institucion nuk ka pasur debat të organizuar për këtë problematikë.
2. Në këtë institucion nuk ka pasur deklaram grupor për këtë problematikë, dhe
3. Kërkesa për ndërrimin, si duket, është bërë nga drejtori i Spitalit.

Të nënshkruhet në lidhje me këtë problematikë ekzistuese janë: nga Bordi menaxhues që i ka 5 anëtarë, 3 veta e kanë nënshkruar dhe janë me emër e mbiemër, me numër të telefonit dhe me e-mail adresë. Ndërsa nga 44 specialistë, mjekë specialistë, e kanë nënshkruar 37 mjekë specialistë. Do të thotë, vetëm 5 prej tyre nuk e kanë nënshkruar dhe unë nuk po e kuptoj se në emër të kujt është bërë kërkesa për ndërrimin e lokacionit.

Dhe, së fundi, të nënshkruarit këtu e kanë edhe një kërkesë dhe në mbështetje të saj, thonë: “Ne të deklaruarit me shkrim nuk ndihemi përgjegjës për vendimin e marrë nga Asambleja komunale dhe pasojat eventuale të këtij vendimi. Ne të deklaruarit me shkrim e njoftojmë opinionin publik dhe institucional se në institucionin tonë nuk ka pasur kërkesë për debat në lidhje me këtë problematikë të nxitur, qoftë nga menaxhmenti i Spitalit, qoftë nga strukturat komunale apo ministrore për ndërrim të parcelës dhe çdo deklaram nga cilado strukturë në emrin tonë e konsiderojmë si manipulim të opinionit publik”.

Dëshiroj për fund të them, meqë ende lokacioni është ku është përcaktuar me vendim të Asamblesë komunale, është shumë i diskutueshëm. Këtë e tha edhe ministri i Forcës së Sigurisë, e thonë edhe të gjithë. Është një vend ku për vite të tëra, përveç që është afër kazermës, janë hedhur mbeturina...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Vitin e kaluar në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Ministria e Arsimit është zotuar që nga shtatori i vitit 2013 do të fillojë me zbatimin e lehtësimit të peshës së librave për nxënësit e shkollës fillore.

Sa i përket kësaj çështjeje, edhe ministrit në seancat plenare disa herë i është ngritur kjo çështje, por asnjëherë nuk ka marrë as një veprim në lidhje me këtë. Unë i them ministrit që është dashur që të bëhen politikat serioze në lidhje me këtë çështje, por ai vazhdimisht, sa herë është përgjigjur, është përgjigjur vetëm për disa dollapë që do të duhej të çoheshin në shkollë, ndërsa unë i them atij që është dashur të bëjë ndryshim në planprogramin mësimor për shkollat fillore, sepse ka raste që për një lëndë të caktuar në shkollën fillore në ciklin e ulët, nxënësit i mbajnë 4 libra për një lëndë të caktuar, ndërsa vetëm njërën e përdorin për mësim.

Unë konsideroj që ky është një shqetësim jashtëzakonisht i madh për prindërit tanë dhe të cilat vazhdimisht po e ngrenë këtë çështje, e nuk po gjejnë përgjigje. Andaj i bëjë thirrje kësaj Qeverie që ta marrë më seriozisht këtë çështje, edhe pse nuk i ka mbetur shumë kohë, mirëpo le ta dijë mirë se këtë premtim të cilin ua kanë dhënë nxënësve, po ashtu edhe deputetëve e prindërve të tyre, që nuk e ka zbatuar dhe nuk e ka realizuar, e kjo lë të kuptohet se kjo gjendja i ka konvencuar dikujt, sepse ato 4 libra janë shtypur nga 4 autorë të ndryshëm dhe kjo lë të kuptohet se dikush ka përfituar nga këta tenderë, të cilët Ministria e Arsimit i ka hapur dhe i kanë keqpërdorur fondet për librat të cilët pothuajse ndahen falas për nxënësit e shkollës fillore.

Andaj, edhe një herë ia bëjë të ditur Ministrisë së Arsimit, që premtimin të cilin e ka dhënë tre vjet me radhë, nuk ka arritur as të interesohet për këtë problem, e lëre më ta zgjidhë atë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Duke shprehur konsideratën më të lartë për vendimin e kryeministrit të Kosovës për ndarjen e 5 milionë eurove për shërimin e fëmijëve të sëmurë nga leukimia dhe duke e vlerësuar përkrahjen e vazhdueshme që kryeministri dhe Qeveria kanë dhënë për shëndetësinë, duke e rritur dukshëm buxhetin për Ministrinë e Shëndetësisë, duke e përkrahur këtë ministri si dhe këto investime, ashtu edhe në rritje të buxhetit për barnat e listës esenciale, trajtimet jashtë vendeve tjera, edhe ne si Kuvend e kemi dhënë mbështetjen e duhur për këtë dikaster, duke i trajtuar seriozisht ligjet e kësaj sfere dhe duke i miratuar ato.

Por, megjithëkëtë, gjendja në shëndetësinë tonë mbetet e rëndë dhe atë jo për shkak të mungesës së mbështetjes nga institucionet e lartcekura, por për shkak të paaftësisë së ministrit Agani për ta menaxhuar këtë dikaster.

Të gjithë ata që në fillim kanë menduar se Ferid Agani ishte një zgjedhje e mirë, sot që të gjithë janë të zhgënjyer me të, sepse ai kishte premtuar reforma në këtë sektor dhe nuk arriti as t'i fillojë ato. Lëre që nuk ka ndonjë reformë në sektorin e Shëndetësisë, por mund të themi që nuk ka kurrfarë përmirësimi, me gjithë rritjen e buxhetit për barnat e listës esenciale, apo ato sërish mungojnë dhe premtimi i Aganit për këtë ka dështuar në

tërësi. Me gjithë investimet milionëshe në kardiokirurgji, ministri Agani nuk arriti apo nuk dëshiroi ta funksionojë atë, edhe pse donatorët kishin lënë në dispozicion mbi 5 milionë euro për material shpenzues dhe gjëra tjera për këtë dikaster. Ai para një jave a dy tha që për këtë nga këto para ka shpenzuar vetëm 180 000 euro, ndërsa nga buxheti i shtetit ka vazhduar të paguajë miliona euro për intervenime kardiokirurgjike.

Për dy vjet nuk arriti ta funksionalizojë një CT në aparatin e Emergjencës dhe pacientët për diagnostifikim duhet të transportohen nga reparti i Emergjencës në atë të Neurologjisë për t'i kryer ekzaminimet e nevojshme, me gjithë miratimin e ligjit të odave të profesionistëve shëndetësorë, ai nuk arriti ta funksionalizojë asnjërin nga ato. E ka zgjedhur vetëm kryetarin dhe Kryesinë e Odës së Mjekëve, ndërsa ende nuk ka filluar puna për zgjedhjen e Odës së stomatologëve, farmacistëve, fizioterapeutistëve, mamive dhe infermierëve dhe shih për këtë mjekët sot, për punën e tyre profesionale trajtohen nga inspektoratet tjera, e nga ligjet tjera, jo nga ligji bazik i Odës së Mjekëve.

Mosarritja e themelimit apo funksionalizimit të Spitalit Rajonal të Prishtinës dhe keqmenaxhimi apo injorimi i spitaleve tjera rajonale është një dështim tjetër i radhës i ministrit Agani dhe për këtë një dështim tjetër që i faturohet drejtpërdrejt ministrit Agani është se të gjithë drejtorët e klinikave tani e tre vjet vazhdojnë të funksionojnë me ushtrues detyre.

Vendosja në pozita kyçe e njerëzve të gjeneratës së tij dhe të profesionit të ngushtë të tij është një çështje në vete që e do një studim edhe më të veçantë. Sekretarin permanent e ka neuropsikiatër, kryetarin e...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Pa dyshim që u fol shumë për shëndetësinë sot. Edhe mua më takon të flas për shëndetësinë, ashtu siç edhe e kishim në plan. Gjendja në shëndetësi, unë them që nuk është shumë e mirë, por dukshëm më e mirë se në të kaluarën se në të kaluarën sikur të ishte një interesim për shëndetësinë sikur që sot u ngrit këtu, do t'i kishim punët më mirë. Asnjë qeveri, po flas partive të mëdha konkretisht prej deputetëve që e ngritën fjalën kurrë nuk i kanë vendos prioritet shëndetësinë, ua kanë lënë partive tjera. Ndërsa, ne dimë implikimet dhe interferimin e tyre brenda vetë institucioneve shëndetësore, në veçanti në Qendrën Klinike Universitare.

Atë çka mund ta kemi parasysh është se në një popullsi dhe me një buxhet për Ministrinë e Shëndetësisë, që është 100 milionë euro, në 2 milionë banorë sa i ka Kosova, nuk mund të presim ndryshime të mëdha në praktikë, vetëm të marrim krahasim me Slloveninë e cila ka një buxhet me banorë të njëjtë sa i ka Kosova 2 milionë banorë, ndërsa ka 3

miliardë euro buxhet vetëm për shëndetësinë, por prapëseprapë nuk është e kënaqur me qëllimet e tyre.

Por, në anën tjetër atë çka mund të themi sa është arritur në këtë rast nga ministri aktual i Shëndetësisë, në këtë legjislaturë mund të themi se kushdo që do të vjen pas tij do ta ketë të gatshme punën ngase ka lënë një infrastrukturë ligjore që askush deri më tash nuk i ka lënë, ka arritur t'i punësojë të gjithë specialistët në Republikën e Kosovës, ka arritur ta ndalë fluksin e mjekëve specialistë jashtë Kosovës fatkeqësisht kohë të fundit janë larguar shumë nga Kosova, ndërsa për gjendjen e rëndë në Klinikën Universitare edhe Kardiokirurgji, edhe në klinikat tjera unë mendoj që përgjegjësi i takon vetë deputetëve, ngase nuk deshën ta parandalonin krimin e organizuar që zhvillohet.

Pra, nuk deshën që mjekëve tjerë t'i japin rrugë për avancime, nuk deshën që mjeku, i cili sot punon në kushte shumë të vështira në Klinikën Universitare dhe në klinikat tjera të ketë përveç pagesës bazë të ketë edhe pagesën bazë të performansës, nuk ia lejuan këtë, por e dërguan ligjin në Gjykatë Kushtetuese vetëm e vetëm për interesat e disa grupeve të caktuara edhe sot dashur e pa dashur e kemi edhe një situatë të tillë kur përderisa në dy vjetët e kaluara ka qenë kërkesa enorme për një klinikë kardiokirurgjie, sot kur hapet kritikohet pse është hapur.

Është e vërtetë duhet kritikojmë vetveten tonë pse ne nuk kemi specialistë kardiokirurgë, kjo a është përgjegjësi e ministrit të Shëndetësisë i cili që dy vjet është ministër apo e vetë kardiologëve, të cilët nuk e kanë specializuar kardiokirurgjinë, ndërsa tërë Kosova është mbështetur në dy kardiokirurgë dhe sot e kemi aktualisht vetëm një kardiokirurg i cili punon në atë Klinikë dhe prapë akuzat mbesin te Ministria e Shëndetësisë.

Unë mendoj që është bërë mjaftë edhe në sistemin e infrastrukturës ligjore është bërë mjaftë edhe në praktikë, por vetë përgjegjësia mbetet te ne deputetët ngase nuk kemi dashur një zhvillim të mirë të shëndetësisë. Është dërguar ligji në Gjykatë Kushtetuese, është penguar reforma për të cilën u fol këtu se nuk ka realizuar reformë. Reformë sot kemi, sot mjekë të mjaftueshëm në gjithë nivelin shëndetësor, kemi një decentralizim zë sistemit shëndetësor edhe në spitale rajonale edhe në Klinikën Universitare, e kemi një ligj...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Është harxhuar koha për deklarime jashtë rendit të ditës, për deputetët pasi e keni apostrofuar ministrin, ai është i gatshëm të përgjigjet.

E ka kërkuar fjalën për deklarime edhe ky jashtë rendit të ditës.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kuvendarë,

Deputetë,

Është e qartë që keni hyrë në periudhën e fushatës parazgjedhore dhe deputetët po i shprehin qëndrimet e tyre në funksion të ngritjes së rejtingut politik, por nuk po i kuptoj disa prej pozitës parlamentare qartë t'ju them të drejtën se po krijohet njëfarë lloj konfuzioni politik edhe në opinion.

Vetëm të them shkurt atë që Ministria e Shëndetësisë e ka bërë në këtë tre vjet në sektorin e shëndetësisë, unë mund të them se kjo Qeveri mund të krenohet, se a janë bërë ndryshime apo jo dhe a jemi në rrugë të ndara apo jo, do ta thoni edhe vetë gjatë kësaj seance parlamentare kur t'i ngrini duart dhe të votoni për Ligjin për sigurimet shëndetësore që kjo Ministri ua ka përpunuar, ua ka bërë gati dhe e keni para jush për ta votuar.

Se a janë, a është Klinika e Kardiokirurgjisë fantome, është mirë për t'i pyetur ata 36 pacientë që janë operuar në këtë Klinikë. Në qoftë se janë për ju e nderuara zonja daktoreshë, fantomë ata pacientë, atëherë keni një problem në raportin etik të juajin me pacientët, se vetëm një me u pas operuar me sukses kishte me qenë mjaftë e lëre më 36.

Se qysh themelohet një klinikë dhe qysh niset një shërbim i avancuar është mirë t'i pyesni profesorët e juaj, të cilët e kanë themeluar Fakultetin e Mjekësisë, bashkë me kolegët e tjerë që kanë ardhur nga Shqipëria edhe nga shtetet e tjera, besa, se nuk fillohet asnjë shërbim i avancuar me forcat vetjake, nuk është e mundur, njëjtë edhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës kur është formuar.

Prandaj, unë t'ua shpjegoj juve këto gjëra është e tepërt, por më detyroni dhe po i them. Ndërsa, sa i përket aftësive profesionale është mirë të pyeteni edhe ju si kardiologe në Klinikën e Kardiologjisë si është e mundur që 15 vjet pas luftës, mbi 30 kardiologë të punësuar të deklarojnë se nuk janë në gjendje që të intervenojnë me intervenime të kardiologjisë invazive në rastet e infarktut akut. Pse ende dërgohen, referohen pacientët jashtë QKUK-së si raste urgjente pas orës 3:00 se nuk jemi në gjendje të intervenojnë në këtë situatë?

Ministria e Shëndetësisë iu ka krijuar të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar intervenime, unë pres punë. Detyra e Ministrisë është për t'i krijuar kushtet për punë. Sa i përket deputetit Haxhiu, unë vetëm një fjalë e kam, vetë fakti se referohet në një spital rajonal që unë kurrë se kam pasur parasysh dhe askund nuk shkruan, as në programin e Partisë së Drejtësisë, as në programin e Qeverisë së Kosovës se do të themelohet, vetë ky fakt flet për atë se është duke polemizuar me konstatimet që janë shpikur në mendjen e tij dhe qëllimin e vetëm e kanë për ta denigruar atë që është arritur.

Natyrisht, vështirësi ka shumë, probleme ka shumë, por përfundimisht është shtruar një rrugë ligjore, një bazë e fuqishme ligjore për ndryshimin e gjendjes në shëndetësinë kosovare dhe do t'i shohim shpejt, në periudhën e ardhshme kohore rezultatet e kësaj pune. Faleminderit!

KRYETARI: Aurora Bakalli i ka 3 minuta, Bekim Haxhiu gjithashtu kanë reaguar. E keni fjalën edhe ju veç me radhë. Aurora së pari.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër nga t'ia filloj, më akuzuat se po i quaj "fantome", sepse qenkan kryer 36 raste.

Premtimet e juaja kur u hap kjo klinikë ishin shumë më të mëdha dhe e tejkalonin shumë këtë numër, edhe pse unë edhe atëherë kisha kritikuar se numri të cilin ju e thoshit që ishte diku rreth 1 pacientë më ditë, është shumë i vogël. Dhe tani kanë kaluar më shumë se një vjet që është hapur ky repart, apo kjo klinikë dhe gjithsej janë të operuar vetëm 36 pacientë, si mund ta quani sukses.

Ndërkaq, nëse ju më quani mua se nuk kam etikë, unë pikërisht për shkak të etikës mjekësore po e ngris këtë çështje, sepse pikërisht me këta pacientë ballafaqohem për çdo ditë. Kam pacientë të shtrirë në klinikë, të cilët kanë nevojë për intervenim kardiokirurgjik, bëjmë kërkesën që këto intervenime të kryhen në Klinikën Kardiokirurgjike që keni themeluar ju, por nuk kanë mundësi të kryhen.

Arsyet na i tregoni ju të lutem. Ata nuk kanë kohë të presin shumë, pastaj drejtohen në Ministrinë e juaj, pastaj ju bëni investime shumëfish më të mëdha që ata t'i kryejnë ato intervenime kardiokirurgjike jashtë klinikës. Mua kjo nuk më duket në rregull, nëse e kemi klinikën brenda pse nuk mund të funksionalizohet?

E dyta, unë nuk kam qenë në asnjë pozitë menaxheriale në kardiologji, por gjithsesi ju më bëtë një pyetje se pse nuk funksionon si duhet apo sipas kërkesave të popullatës, do t'ju përgjigjem. Aktualisht, aty punojnë 6 kardiologë me dijen time, të cilët punojnë ekskluzivisht në Repartin e Kardiologjisë Invazive. Dhe, aktualisht në kardiologji ndarja është bërë në reparte të caktuara dhe mjekët, të cilët punojnë në një repart, punojnë ekskluzivisht në atë repart.

Një kohë edhe unë vetë kam punuar në atë repart, kam kryer procedura të kardiologjisë invazive, por për arsye personale jam tërhequr prej aty. Mua askush nuk më ka pyetur se ju thatë që i kemi pyetur a janë në gjendje të punojnë, mua konkretisht që punoj aty askush nuk më ka pyetur se a jam në gjendje të punoj apo jo. Kështu që nuk mund të flas për tjerët, sepse nuk kam informata.

Përndryshe, puna aty kryhet me mungesë të shumtë të materialit. Nuk mund të prisni që të hyhet në... me një numër aq të vogël të materialit, stenteve konkretisht që ju posedoni, po ministër, nevojitet llojllojshmëri e madhe, sepse arteriet koronare siç e dini edhe ju edhe po më vjen keq që po duhet kaq profesionalisht tash të flasim se për opinionin këto janë të tepërta, nuk kanë të gjitha dimensionet e njëjta si të individë të ndryshëm, por edhe vetë ato mund të jenë të dimensioneve të ndryshme varësisht prej lokacionit. Kështu që ofroni material të bollshëm dhe ata njerëz, të cilët sot po janë në gjendje t'i kryejnë këto punë mund t'i kryejnë edhe pasdite. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu tani ministri ju përgjigjet. Jo, jo ju përgjigjesh dyve. Mirë, urdhëro, Bekim prit pak t'i përgjigjet deputetes, pastaj të përgjigjet edhe ty.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuar zonja deputete,
Edhe ju si zoti Haxhiu të njëjtin problem e keni, po polemizoni në bazë të konstatimeve që po i shpikni në mendjen e juaj.

Në këtë Kuvend unë kam deklaruar në fillim kur kam qenë i pyetur sa intervenime mund të kryhen në këtë Repart të Kardiokirurgjisë, fillimisht nuk është Klinikë e Kardiokirurgjisë, por është shërbim kardiokirurgjik, kjo nën një.

Pra, ta keni të qartë referoheni ashtu si duhet se automatikisht në fillim e keni konceptin e gabuar, unë kam thënë një pacient në javë jo një pacientë në ditë. Merreni stenogramet dhe shikoni, atëherë e kuptoni, sepse në qoftë se një se niseni me atë bindje se unë kam thënë një pacientë në ditë, atëherë ju e keni huq komplet argumentimin, kjo një.

E dyta, mendimi se nuk është në gjendje Klinika e Kardiokirurgjisë Invazive të intervenojë në infarkt akute është mendim i shkruar dhe i nënshkruar nga kolegët e juaj në tavolinën time, dokument.

E treta, çështja e materialit s'ka material të bollshëm. Sipas informatave të drejtorit të Klinikës, asnjë pacient nuk është në listë pritjes për koronografi në Klinikën e Kardiologjisë që sikur të mos kishte material harxhues, me siguri se...

Prandaj, këto janë fakte unë po ju them këto janë fakte, të cilat nuk është mirë për t'i mohuar edhe është mirë për të ndërtuar vetëbesim dhe siguri dhe për të qar mesazh pozitiv në opinion, te qytetarët e vendit se në Klinikën e Kardiologjisë dhe në shërbimin kardiokirurgjik po ndërtohen kapacitetet nga dita në ditë. Dhe që shumë shpejtë Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka me qenë në gjendje për t'u përgjigjur nevojave të qytetarëve, ekskluzivisht vetëm në kuadrin e saj, e të mos ketë nevojë për të ardhur ekspertë nga jashtë.

E mos harroni se vetëm në gjashtë javët e fundit në klinikën, në Shërbimin e kardiokirurgjisë, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës kanë operuar emra eminentë të kardiokirurgjisë botërore.

Nga spitali 'San Donato' në Milano, nga Klinika e Kardiokirurgjisë të Qendrës Klinike Universitare të Lubjanës, nga spitali i Gylen në Turqi, në Ankara. Prandaj, mendoj se është e panevojshme dhe mos të përdori kualifikime të tjera për të përcjell mesazhe të nihilizmit kur arritjet janë evidente.

KRYETARI: Një minutë.

AURORA BAKALLI: Edhe nëse qenka një në javë që është prapë një numër shumë i vogël, është krejt simbolike ju lutem zoti ministër këtë duhet ta pranoni, as atëherë nuk mbërrihet shifra prej 36 matematikë e thjeshtë.

Edhe ju duhet disa koncepte t'i keni të qarta, unë thashë nuk ka material për stente, jo për koronarografi dhe këto të dyja dallojnë shumë mes veti. Në anën tjetër pse nuk ka listë të

pritjes, nuk ka listë të pritjes pikërisht për shkak të atyre kardiologëve që pak më parë i kritikuat, sepse ata janë duke e bërë punën e tyre mirë, janë duke arritur që mos të ketë listë të pritjes. Shpresoj që edhe kardiokirurgjia të arrijë të njëjtën, sepse lista e pritjes aty është tepër e gjatë.

Përditë kemi pacientë që kanë kërkesa shumë të mëdha për kardiokirurgji dhe nuk mund të kryhen në këtë repart, sepse aty po kryeka një në javë sipas juve e as aq. E tregoi edhe vetë shifra juaj. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Mendoj debatet janë me të vërtetë të paarsyeshme kur bisedohet për çështje të cilat nuk ka argumente.

Kur unë them se në Klinikën e Kardiologjisë ka material harxhues, ka stenta, ka material për koronografi, kur unë e them me përgjegjësi të plotë publike ju them juve që ka, ju thoni nuk ka. Unë ju them që ka, dhe e vetmja arsye pse nuk ofrohen është ai fakti që e përmenda që nuk po doni të reflektoni.

Në gjendje të infarktut akut nuk po intervenohet në Klinikën e Kardiologjisë, është premtuar se do të fillojë ndërrimi i dytë pas orës 15:00, nuk po arrijmë që të organizohet për shkak të mungesës së kompetencës profesionale. Prandaj, duhet për ta parë problemin ashtu si është e jo për të provuar për ta maskuar e për ta bartur problemin, e për ta parë problemin të kardiokirurgjia.

Shërbimi i Kardiokirurgjisë do të zhvillohet, unë do ta shfrytëzoj rastin kam edhe pyetje parlamentare më vonë edhe me detaje, të mos hyj në detaje tash, lidhur me Shërbimin e Kardiokirurgjisë, jap edhe informata të tjera. Por ai do të zhvillohet, i pëlqeu kjo dikujt apo jo, sepse ai shërbim praktikisht e konfronton, e ballafaqon si pasqyrë, secilin prej nesh se sa është në gjendje të kontribuojë që të jetë pjesë e një tërësie të shërbimeve shëndetësore në vend apo jo, apo e sheh veten si të izoluar, si një ishull në një tërësi...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Vetëm po dua të tërheq vërejtjen edhe njëherë, ndoshta për teknikën, fjala ime nuk ishte 3 minuta, ishte më e shkurtër, e ndërpre në pak më herët, mirëpo besoj që në të ardhmen teknika nuk do të merret me detaje të tilla.

I nderuar ministër,

Mos ekzistimi i Spitalit rajonal të Prishtinës e ka shndërruar Qendrën Klinike Universitare në institucion dytësor. Këtë e kemi debatuar edhe më herët dhe kur unë kam dhënë idenë që të ndërtohet një qendër e re klinike universitare dhe ju atëherë keni deklaruar se po punohet që të bëhet Spitali Rajonal i Prishtinës.

Keni dalë edhe me një maket në opinion për Qendrën Klinike Universitare dhe Emergjencë, pastaj për të deklaruar se ajo është Emergjencia. Dhe, unë mendoj që qytetarët e Prishtinës, qytetarët e Kosovës, kanë nevojë që të ndërtohet një Spital Rajonal i Prishtinës dhe Qendra Klinike Universitare të ushtrojë funksionin e saj terciar si e ka me ligj dhe jo në formën çfarë është.

E dyta, i nderuar ministër, te aspekti tjetër i shpikjes apo mos shpikjes, ajo le të mbetet në aspektin tuaj profesional deklarimet e tilla, po unë po dua me të thënë një gjë, që për shkak të veprimeve të tyre profesionale, mjekët sot edhe pse kanë ligjin e tyre, Odën e Profesionistëve Shëndetësor, ata sot trajtohen nga Inspektorati i Punës për punë profesionale dhe shihni dënimet e mjekëve për punë profesionale, që bëhen nga një inspektorat, që lidhje me mjekësi as me shëndetësi nuk ka dhe dënon profesorët, si të nderuarin Maxhuni e të tjerë, për veprime profesionale dhe ju nuk keni bërë asnjë reagim, për arsye se keni vendosur në krye të Odës, një kolege tuajën neuropsikiatre dhe e keni vendosur një sekretar permanent, një neuropsikiatër dhe të gjithë kryetarët e komisioneve, pothuajse në tërë Ministrinë i keni vendosur neuropsikiatër kolegët e profesionit tuaj. Prandaj, nuk mundem pa e cituar...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Vazhdoja një minutë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar, për këtë minutë. Nuk mund vetëm një thënie.... kolegut të nderuar, ministër Agani, i cili thotë se për ta trajtuar një pacient me probleme psikike duhet një neuropsikiatër, ndërsa neuropsikiatri ka nevojë për dy e unë po them që Ferid Agani ka nevojë për tre.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar! Oda e Mjekëve të Kosovës është në proces të mirë të konstituimit dhe Ministria e Shëndetësisë është duke e mbështetur fuqishëm. Jemi në procesin e organizimit të zgjedhjeve për Odën e Farmacistëve dhe Stomatologëve të Kosovës.

Po mundohem të ruhem prej terminologjisë profesionale, e t'i kualifikoj pohimet e deputetit Haxhiu, por e kam vështirë, por do të mundohem maksimalisht. Ndoshta, është mirë të na shpjegoj kur më ka parë mua me maketin e Qendrës të re Klinike Universitare, kur e paskam prezantuar atë maket. Ajo është inekzistente.

Fillimisht, unë s'e kam parë atë, ndoshta zotëri Haxhiu po sheh diçka që s'ekziston, e qysh quhet ajo, tash është diçka tjetër.

Në programin qeveritar nuk ekziston askund Spitali Rajonal i Prishtinës. Zotëri Haxhiu, jeni mbështetës dhe jeni pjesë e partisë në pushtet, e cila e mbështet qeverinë e saj. Në atë program askund nuk shkruan "spital rajonal". Gjithmonë ka qenë në programin e

Ministrisë së Shëndetësisë, ngritja e Qendrës Klinike Universitare Emergjente, për çka ka nevojë Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Dhe, këtë do ta ndërtojmë dhe kemi arritur, janë bërë hapat përfundimtarë, jemi duke e futur në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe pavarësisht prej këtyre konstatimeve, që i bëni paushall kështu, pa kurrfarë baze, vetëm pse jeni të motivuar me ndjenja ku ta di unë çfarë, se s'dua të hyj tash t'i analizoj e interpretoj, nuk dua të ndalem në raporte të Inspektoratit të Punës, sepse janë raporte të përcaktuara me ligjin përkatës dhe nuk dua t'i interpretoj ato dimensione të çështjes që ngritët. Por, po ju them se me shëndetësinë që unë e kam gjetur, kur e kam marrë mandatin, me të vërtetë s'ka pasur mundësi kush të merret...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Një minutë ministrit!

MINISTRI FERID AGANI: Fakti se në krye të institucioneve i kemi intelektualët, të cilët e kanë dëshmuar veten me punën e tyre dhe plus kanë edhe kapacitete profesionale të psikiatrisë, vetëm ndihmon në zgjidhjen e problemeve të akumuluar, të cilat kanë edhe dimensione psikologjike e psikiatrike, në mes tjerash .

KRYETARI: Bekim Haxhiu, 1 minutë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Po filloj na kjo e fundit. Gjithsesi, me këto përzgjedhje keni injoruar dhe keni anashkaluar profesionistët e tjerë shëndetësor, që nuk do koment. Dhe, për t'ua kujtuar se kur keni dalë me maketin, do t'ua sjell incizimin në Radiotelevizionin e Kosovës, kur unë u kam bërë fillimisht pyetje parlamentare këtu dhe pastaj kam proklamuar idenë që të ndërtohet Qendra e re klinike universitare dhe Spitali Rajonal i Prishtinës, ju po atë kohë, . e diele ka qenë, keni dalë në Radiotelevizionin e Kosovës dhe keni prezantuar një maket që ka qenë maketi për Qendrën Emergjente, por ju e keni prezantuar se edhe unë e kam idenë, që të bëhet një qendër e re klinike universitare.

Sa i përket aspektit të memories, edhe pse jeni neuropsikiatër me profesion, besoj që aty pak jeni duke ngecur ose qëllimisht jeni duke e bërë. Sido që të jetë, i nderuar ministër, profesionistët shëndetësor, tani e kanë...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Urdhëro ministër, një minutë.

MINISTRI FERID AGANI: Mua me të vërtetë po më vjen keq që po hyjmë në këtë nivel të bisedës dhe po diskutojmë në këtë nivel të bisedës për çështje shumë madhore.

A ka dalë kush me maket a jo, janë fakte që vërtetohen. Në qoftë se s'kam dalë, atëherë kuptohet edhe ai që po i përmend çka do të thotë për të. Dhe, unë i ftoj edhe mediet edhe atë që po ftoni, unë po flas për diçka që është e shkruar në programin qeveritar, zotëri Haxhiu. Nuk kam nevojë unë të dal ditën që ju thoni diçka të dal e t' ju demantoj. Unë e kam shkruar këtë në program qeveritar. Madje, në programin e Partisë së Drejtësisë para 15 vjetëve se jo tash, jo para tri vjetësh, prandaj, këto janë gjëra të cilat janë fakte. Me fakte nuk dua të diskutoj, faktet janë të dhembshme nganjëherë, por duhet të ballafaqoheni me to.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Gëzim Kelmendi, ty s'të ka përmendur kurrkush. Po kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës,

2. Koha për pyetje parlamentare

Lirije Kajtazi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, dëshiron ta bësh pyetjen? S'është këtu më duket. Mirë!

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Desha ta pyes ministrin se premtimi i kryeministrit, zotit Hashim Thaçi, për rritjen e pagave shërbyesve civilë për 25% a është fushatë apo fillim i implementimit të Rregullores për shërbyesit civilë, e cila ka pas të fillojë nga 1 janari i këtij viti?

KRYETARI: Pyetjen, për cilin ministër? Për ju. Urdhëro, ministër pra, veç unë këtu e kam për kryeministrin. Mirë, u bë. E ke fjalën, ministër.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Pyetja është si e kuptoni vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave të shërbyesve civilë për 25%, apo implementimit të Rregullores për shtesa në pagë dhe kompensime të tjera për nëpunësit civilë dhe është pyetje për mua drejtpërdrejt, unë sa e di, sa e kam kuptuar.

Sa i përket vendimit të Qeverisë, unë si ministër i Administratës Publike, atë që i takon Ministrisë së Administratës Publike, vendimin e Qeverisë duhet ta zbatojë dhe ajo është rritja e pagave për nëpunësit civilë për 25%.

Sa i përket komentimit ose kuptimit të Rregullores për pagat dhe shtesat për nëpunësit civilë, Ministria e Administratës Publike në bashkëpunim me institucionet tjera, sidomos me Ministrinë e Financave, përkatësisht Komisionin Ndërmnistror, jemi duke finalizuar

klasifikimin e vendeve të punës, por gjithashtu në projektin e përbashkët me Bankën Botërore jemi duke hartuar edhe katalogun e vendeve të punës sa i përket nëpunësve civilë në Administratën Publike, në nivelin lokal edhe në nivelin qendror, ku do të përfshihen të gjitha vendet e punës dhe do të bëhet gradimi.

Në këtë aspekt, edhe në takimin e Qeverisë unë kam komentuar këto çështje edhe Rregullorja për pagat dhe shtesat e nëpunësve civilë do të vazhdojë në agjendën e vetë dhe shpresojmë, qysh i kemi premtuar që në fund të muajit maj do të përfundojmë klasifikimin, do të përfundojmë katalogun e vendeve të punës dhe të fillojmë me zbatimin e Ligjit për pagat e nëpunësve civilë bashkë me Rregulloren për shtesat dhe kompensimet.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Po, kryetar. Faleminderit!

Fillimisht kërkoj falje, e kam pyetjen edhe për kryeministrin, por është edhe për ministrin.

Ministër, po ju rikujtoj se kjo rregullore është dashur të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2014. Po citoj: Në nenin 24, paragrafi 2 të Ligjit për pagat, kësaj rregulloreje, pra kjo rregullore është dashur të fillojë nga 1 janari i 2014-ës, në pajtim me nenin 18 të Ligjit për shërbyesit civilë, nëpunësve civilë për çdo vit pune në shërbimin civil ose jashtë shërbimit civil, duke përjashtuar vitet e përvojës në punën praktike, nëpunësit civilë do të marrin një shtesë prej 0,5% të pagës bazë.

Që nënkupton, se shërbyesit civilë, në qoftë se paga bazë e një shërbyesi civil është 200 euro çdo shërbyes civil për 10 vjet merr 10 euro. Çdo vit do të thotë, nga 10 euro, që i bie që 100 euro për 10 vjet, në qoftë se një shërbyes civil ka 20 vjet përvojë pune, do të marrë 200 euro...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ministër, mund t'i përgjigjesh.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit edhe për pyetjen shtesë.

Edhe kjo është pjesë e zbatimit të Rregullores për pagat dhe shtesat e nëpunësve civilë. Jemi duke u vonuar, ndoshta do të ishte e nevojshme të bëhet më 1 janar, por është një projekt i përbashkët edhe përmes Bankës Botërore, ku duhet t'i përfundojmë të gjitha përgatitjet që të plotësojmë në tërësi Ligjin për pagat e nëpunësve civilë.

Edhe në pjesën e parë kam shpjeguar që jemi duke hartuar katalogun e vendeve të punës, i cili do të jetë një katalog i përbashkët për nëpunësit civilë para se të bëhet konkursi, ose shpallje për vende të lira do të dihet cila është pozita, sa është grada dhe cilat çështje duhet të përfshihen.

Në anën tjetër, janë në përfundim edhe rregulloret për institucionet sa i përket klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civilë.

Gjithashtu është në përfundim edhe projekti për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe në kompletimin edhe të infrastrukturës teknike dhe përfundimit të rregulloreve nëpër institucione, do të zbatohen të gjitha dispozitat e ligjit në këtë rast edhe pjesa sa i përket përvojës në punë dhe përfshirjes në shtesat dhe kompensimet dhe çështjet tjera.

Besojmë që siç kemi premtuar edhe para grupit të veçantë për Administratën Publike, do t'i përfundojmë draftet përfundimtare deri në fund të muajit maj dhe do të fillohet në pjesën e dytë të këtij viti edhe zbatimi i Rregullores bashkë me këtë nen. Faleminderit!

KRYETARI: Tash e ka fjalën deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Ferid Agani.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Sipas një raportimi të Koha vizionit të datës 31 mars, familja Taholli nga Çadraku i Suharekës, ka kërkuar ndihmë në Ministrinë e Shëndetësisë për shërimin e vajzës pesëvjeçare.

Sipas nënës së vajzës askush nga kjo Ministri nuk ia ka hapur derën. Vajza pesëvjeçare Floriana që vuan nga tumori në stomak, tani është në një spital në Tiranë për t'iu nënshtruar operacionit për herë të tretë. Nëna e vajzës Vlora ka deklaruar se nuk ka lënë vend pa kërkuar ndihmë, ndërsa për operacionin e parë që i kushtoi 3 mijë euro, parat ia siguroi një këngëtare. Pra, as një qindarkë nga shteti.

Pyetja ime për ministrin e Shëndetësisë është kjo: Pse Ministria e Shëndetësisë nuk e ka ndihmuar vajzën e familjes Taholli?

Përse madje e ka injoruar plotësisht dhe as që e kanë pritur në takim nënën e saj?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përgjigjja e thjeshtë është sepse familja nuk është drejtuar me kërkesë për ndihmë për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë, për rastin në fjalë.

Kjo është përgjigje e shkurtër.

Ndërsa, pasi që e kam marrë pyetjen parlamentare ne jemi interesuar në Zyrën për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore ku janë marrë këto të dhëna:

Në vitin 2009 është bërë ratifikimi për trajtimin e pacientes FT, të lindur në vitin 2008, nga Suhareka.

Prindërit e saj janë Vlora dhe Afrimi. Sipas shënimit të Zyrës për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, ajo ka aplikuar për trajtim me 16 mars 2009. Pra, po flasim në moshën e saj njëvjeçare.

Komisioni mjekësor e ka miratuar trajtimin më 24 mars 2009, pra 8 ditë më vonë.

Pas kësaj, familja nuk ka siguruar profaturën e trajtimit jashtë institucioneve publike shëndetësore, për ku ka dashur ta dërgojë fëmijën dhe si rezultat lënda nuk ka dalë për shqyrtim në Bordin ekzekutiv të programit për trajtim jashtë vendit fare, në atë kohë.

Atëherë, lënda klinike ka pasur të bëjë me diagnozën e sindromit nefrotik kongjenital, që nuk ka kurrfarë lidhje me tumorin në stomak i cili është referuar në storien televizive të cilës edhe ju i referoheni në bazë të asaj storie.

Pra, kemi të bëjmë me dy gjendje krejtësisht të ndryshme klinike për të cilën të parën ka aplikuar para 4 vjetëve, ndërsa tash s'ka aplikuar fare. Dhe nuk ka pasur kurrfarë mundësie që të ndihmohet në atë drejtim.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Nuk e di unë e kam vështirë tani kujt t'i besoj, asaj që thoni ju: nuk ka aplikuar, apo lotëve të nënës e cila më duket pak më e besueshme. Ajo në deklaratën e saj ka thënë që ka qëndruar madje me muaj dhe askush nuk ia ka hapur derën as në kryeministri dhe as në Ministrinë e Shëndetësisë.

Tani unë nuk jam marrë konkretisht me llojin e sëmundjes, por mbi bazën e saj çfarë ajo ka deklaruar dhe po e shoh, megjithatë, dhe ju po e pohoni që nuk ka pasur një trajtim adekuat. Mbase ka pacientë a qytetarë që nuk i dinë rregullat, saktësisht se si duhet të aplikohet, prandaj vijnë vetë dhe trokasin dhe kur e gjejnë derën të mbyllur, kjo është përgjigja për ta.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën

MINISTRI FERID AGANI: E nderuar zonja deputete,

Respekti për lotët e nënës është i të gjithë atyre që e kanë parë atë storie. dhe nga ana e ime në veçanti. Natyrisht se bashkë ndjej me ato ndjenja dhe me atë përvojë, por unë po e them prapë, ne po flasim këtu në një institucion shtetëror, flasim në bazë të fakteve. Nuk ka pasur asnjë kërkesë zyrtare në Ministri për të ofruar ndihmë. Ka qenë e njoftuar familja me mundësinë e paraqitjes së kërkesës, sepse të ngjashme e ka bërë 4 vjet më parë. E kanë bërë dhe janë të informuar, çdo palë informohet se çka duhet për të ofruar në Ministrinë e Shëndetësisë, për të realizuar të drejtën e trajtimit jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Ajo profaturë është elementare. Pacientët e zgjedhin mjekun dhe institucionin ku donë ta dërgojnë, në këtë rast fëmijën. Dhe sikur ta kishin pasur një kërkesë të tillë, ne do të kishim reaguar qysh kemi reaguar në rastin e qindra pacientëve të tjerë.

Kjo zyrë i plotëson nevojat e 60% të gjithë aplikuesve për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore në Ministri të Shëndetësisë.

KRYETARI: Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Ministri nuk është këtu. Pyetjen mund ta parashtroni.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Gjatë luftës Serbia ka marrë nga Kosova pjesë nga trashëgimia kulturore me mijëra artefakte, por edhe dokumentacionin e monumenteve të kulturës.

Në arkivat e Institutit të Monumenteve të Kulturës ekziston një dokument, vërtetim të cilin e kam këtu, në të cilin thuhet qartë se kur janë marrë këto dokumente nga ky institucion dhe ku janë dërguar.

Sipas këtij dokumenti që mban datën 9.6. 1999 bartjen e dokumentacionit e ka kryer shoferi i Teatrit Kombëtar të Kosovës, në atë kohë Zoran Mijatoviq nga Çagllavica me kamionin me targa PR-10-6287, në datat 9 dhe 10. 6. 1999.

Pyetja parlamentare për ministrin e Kulturës është kjo: Çfarë ka bërë Ministria e Kulturës në lidhje me kthimin e dokumentacionit nga Serbia, dokumentacion i cili ndodhet në Muzeun e Krushevcit?

E konsideroj jo serioz faktin që ministri nuk ka ardhur për të dhënë përgjigje, mbase sepse nuk ka bërë asgjë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeminstren Edita Tahiri.

(Ndërhyrje)

Deputeti Afrim Hoti, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputet, e ke fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Meqë kryeministri edhe kësaj radhe nuk është këtu, po e lexoj prapë pyetjen. Në një video të publikuar kohëve të fundit shihet qartë kryeministri dhe ish shefi i SHIK-ut Kadri Veseli duke i ndaluar mjekët e komunës së Mitrovicës për të shkuar në vendet e tyre të punës, në spitalin në pjesën matanë Ibrit.

Pyetja kishte me qenë: Kisha dashur të di cili ishte roli i kryeministrit në atë kohë, pse i ndaluan mjekët shqiptarë të shkonin në vendet e tyre të punës? Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Bazuar në një raport të Amnesty International, në këtë raport pra janë hedhur disa dyshime që në Institutin Special në Shtime, ka pasur heqje të mitrave dhe abuzime seksuale me pacientë.

Po ashtu, edhe gazeta 'Koha Ditore' ka shkruar për këtë rast më 27 mars të këtij viti pas një hulumtimi që e kanë bërë.

Hulumtimi tregon se ka pasur keqtrajtim të pacientëve, ngacmime seksuale, shfrytëzime dhe dhunime, andaj pyetja për ju ministër është se çka keni ndërmarrë lidhur me këto raste të dyshimeve?

KRYETARI: Ministër Rashiq, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani kolege ministri,

Dame i gospodo, narodnik poslanici,

Predstavljeni podaci u novinama u saradnji sa građankom su potpuno neistiniti... Sve su demantovane sa argumentima iz kancelarije Ministarstva za rad i socijalne zaštite. Postojeći menadžment u ovom slučaju čak i onaj koji je aktuelni, a i on koji je bi pre toga, nema nikakva saznanja da bi se tako neto desilo posebno u periodu od 99, na ovamo.

Oni su kao navodno iz priča, čuli jednom da se to navodno desilo pre 99 godine, negde 94, mi za to ne možemo da imamo podatke, ne možemo da budemo da proveerimo, li ono što sigurno jeste da je u ovom slučaju podaci čak i svo osoblje sav menadžment je bio decidivan da se tako nešto nikad, opet kažem u periodu od 99 do danas nikada nije desio. Mi smo objavili i demant, nažalost kao što ste i sami rekli Koha Ditore je taj demant nije objavila i ja ne znam zašto. Ali u svakom slučaju mogu da tvrdim podsećam da sam ja pre mesec i po dana bio lično u centar, u specijalni insitut u Štimlji i ono što sam video mislim da je nega prema pacijentima na visokom nivou.

Sad verovatno, bilo ko od tih štićenika ako neki ... novinar na bilo koji način želi da iskoristi verovatno mogu u izjavi koja neće biti dovoljno jasna, ali odgovorno tvrdim da pacijenti odnosno štićenici u tim domovima i to što možda u datom momentu oni kažu treba uzeti sa rezervom ili u najmanju ruku treba možda ispitivati ih sa stručnim osobljem odnosno sa lekarima koji tu mogu verovatno bolje da procene njihov način komunikacije i da li oni pričaju istinu ili ne.

Uglavnom Ministarstvo za rad stoji odgovorno u svakom slučaju za bilo koji takav neki izveštaj ili slučaj da prijavimo policiji kao što se već ranije dešavalo, mi smo imali podsećaću 2010 godine jedan slučaj ne dešavanja nego se desilo jednom od klijenata da je rekao nešto u ovakvoj formi, mi smo odmah obavestili policiju i posle kraće istrage policija je odbacila sve navode koji su bili izašli iz te prijave, prema tome još jednom ponavljam Ministarstvo za rad i specijalni institut za Štimlju stoji kao organ koji će vas

uvek informisati u vezi bilo kojih dešavanja ali s druge strane odgovorno tvrdimo da tako nešto u pogotovo opet naglavašam....

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

ALBULENA GASHI: Zoti ministër, sa i përket trajtimit dhe kushteve në Institutin Special të Shtimes, ne kemi qenë dhe e kemi vizituar këtë Institut dhe kushtet e trajtimit të pacientëve nuk është aspak kështu siç po thoni ju, ndërsa sa i përket datave që ju po i cekni se kur kanë mund të ndodhin këto gjëra, ne e kemi një raport nga Amnesty Internacional ku tregon se organizata 'Mental Disability Rights International' ka pranuar edhe raporte nga KQUK-ja në lidhje me rastet e dhunimeve.

Neve ministër, na intereson të dimë se a keni filluar ose a ka filluar ndonjë hetim lidhur me këto raste, pavarësisht këtyre që po thoni ju, a ka filluar ndonjë hetim lidhur me këto dyshime të bazuara? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala predsedniče!

Evo da naglasim još jednom. Sve prijave koje su bile, dao sam i slučaj 2010. Godine jer policija je istražila i odbacila optužbe. Sad, ja bih vas zamolio, ako ste već bili tamo, ako ste bili u Institutu, pošto sam ja skoro bio pa znamo o čemo pričamo

Ja mislim da institut apsolutno ima dobre uslove za njihov smeštaj i kao što znate u tim prostorijama nisu kao što je jedan od vaših kolega rekao da ih ima po 6 ili po 10 u sobi nego su odvojeni su na ženski i muški sektor, imaju svoje radionice, čak imaju pet radionica, što po mom mišljenju, uz čistoću koju sam tamo video, apsolutno zadovoljava kriterijume.

Meni stvarno žao što imate jedno tako predubedenje. Ja vas pozivam sledeći put, kada budete išli, da pozovete i mene, ili čak evo pozivam ja vas da odemo sledeću nedelju u poseti Štimlju, i šta god budemo tamo ustanovili zajedno, zajedno ćemo to izneti. Ja sigurno garantujem jedno iskrenost i fer tretman, a ako možete dođite sa mnom pa ćemo zajedno da procenimo da li su zadovoljavajući, ili ne. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Afrim Hoti, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredi Kuçi.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Edhe këtë po e lexoj, meqë është prej javës së kaluar. Më 27 janar 2011, Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit e ka miratuar nismën e kryetarit të kësaj komune për të iniciuar padi kundër Serbisë për krimet e kryera nga forcat e saj ushtarake dhe paraushtarake ndaj popullatës civile të kësaj komune gjatë luftës në Kosovë.

Siç e dimë, krimet e luftës nuk parashkruhen. Në takimet që Qeveria juaj ka zhvilluar me kryeministrin e Serbisë, Ivica Dačić, as që e keni përmendur këtë çështje. Pyetja është: Ne e dimë që në këto bisedime ju nuk e keni ngrehur këtë çështje. Më intereson të informohem se a jeni duke përgatitur dokumentacion me dëshmitë dhe faktet për krimet e Serbisë në Kosovë, meqë deri më sot nuk ka asnjë rezultat lidhur me këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Një numër i caktuar pensionistësh, për arsye të ndryshme, nuk arrin ta konfirmojnë muajin tetor se jetojnë, thjesht se janë gjallë. Kjo ka për pasojë ndërprerjen e marrjes së pensionit të pleqërisë.

Duke pasur parasysh kushtet ekonomike që mbretërojnë në Republikën e Kosovës, ndërprerja e pensionit u shkakton atyre vështirësi jashtëzakonisht të mëdha. Shpresoj që e keni parasysh se pensionet e pleqërisë fillojnë prej moshës 65-vjeçare dhe vazhdojnë deri në përfundim të jetës. Pra, fjala është për qytetarët e shtyrë në moshë, që nuk kanë mundësi të lëvizin, që janë shumë të varur prej tjerëve.

Në këtë kuptim, do të doja të pyesja se sa është numri i pensionistëve në Kosovë të cilëve për arsye të tilla u ndërpritet pensioni derisa ata të konfirmojnë që jetojnë. Nuk e kam fjalën për ata pensionistë që kanë vdekur në vitin 2009 dhe që i kanë marrë pensionet deri më tash, por është fjala për pensionistë që jetojnë dhe që pensioni u ndërpritet periodikisht.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Dame i gospodo narodnih poslanici,

Pročitacu deo Zakona, i biću što kraći, da bi bio što jasniji.

Pitanje prijavljivanja penzionera regulisano je administrativnom uputstvom broj 15/213, gde se u članu 8. kaže: “Korisnici osobne penzije su dužni da se prijave lično ili preko ovlašćenog lica najmanje dva puta godišnje u roku od 6. meseci u najbližoj kancelariji Departmana za penzija”.

Opet ponavljam, korisnici osobne penzije su dužni da se prijave lično ili preko ovlašćenog lica najmanje dva puta godišnje u roku od 6. meseci, što znači da u ovom slučaju lično ili preko ovlašćenog lica, što se dešavalo više puta da ljudi jednostavno zbog uslova, koje ste vi rekli, nisu u stanju da sami dođu, oni ovlaste nekog, ali da čak i u slučaju ako su oni u takom teškom stanju da ne mogu ni da ovlaste nekog da daju svoju pismenu izjavu, onda mi imamo našu ekipu koja ide kod njih u posetu, samo treba neko od porodice pre toga da ih prijave da oni nisu u stanju da sami dođu i naša ekipa takođe jednom u 6 meseci obilazi sve te građane, penzionere koji ne mogu sami da dođu.

Što se tiče onog dela pitanja koliko je suspendovano, evo iz marta ove godine je 4 264. Da bi bili jasniji, mi imamo ukupno penzionera, staviću jednu grupaciju, oko 170 hiljada. Ovih 4 264 penzionera u martu je čak bio i dobar. To je negde oko 3%. Dešava se da zbog toga što se ne registruju, automatizmom sistem unutar Departmana za penzije ih isključuje iz plaćanja, ali onog momenta kad se oni vrate, kad se prijave, mi retroaktivno isplaćujemo unutar tih 3-4 ili 6 meseci, koliko je bilo od kad se zadnji put nisu prijavili.

Prema tome, ovaj procenat suspendovanih, ja bi morao da dodam - privremeno suspendovanih, oni naravno uzimaju svoje penzije, s time što u momentu kad se prijave mi retroaktivno u nazad 6 meseci isplaćemo. Hvala!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shitesë?

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Shifra prej 4 264 qytetarëve, të cilëve u ndërpritet pensioni është megjithatë e lartë dhe tregon që ka një problem të sistemit. Një organizim më i mirë i Ministrisë në bashkëpunim me institucionet tjera, kur personi që vdes i lajmërohet menjëherë ministrisë, do ta hiqte nevojën për të paraqitur dy herë në vit.

Ministria duhet të sigurojë mekanizma nëpërmjet të cilëve ajo mund të vërtetojë nëse një qytetar jeton apo jo, por jo t'ua bartë këtë detyrë qytetarëve që të shkojnë çdo herë. Të keni parasysh se fjala është për njerëz të moshuar, të shtyrë në moshë, ndonjëherë shumë të varur prej tjerëve dhe të tjerët nuk i kryejnë detyrat ashtu siç dëshirojnë ata.

Në anën tjetër, shtyrja e pagesës së pensionit, duke i pasur parasysh kushtet e rënda ekonomike të ne, qoftë ajo shtyrje një muaj, dy muaj, tre muaj, është problem...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Faleminderit, kryetar!

Poçecu od ovog zadnjeg dela, koje ste rekli, gde su ljudi kako kažete izbačeni zbog tog tehničkog sistema, zbog grešku sistemu, svega mora da znamo svi da postoji jedan deo odgovornosti prema institucijama, bilo da je to od strane bilo kog individualaca, radnika, a treba da bude i penzionera. U ovom slučaju oni imaju obavezu jednom u šest meseci da bi mogli da proverimo da li su živi.

Ono što ste rekli, da se napravi sistem koji može da utvrdi da li su oni u životu ili ne, jednostavno nije moguće napraviti u ovom momentu.

Ja sam od 2009. pokušavao i preko opština, i preko islamske zajednice, i preko bilo koji institucija da nađemo neki sistem koji bi mogao da kupi sve informacije. Ja do dana današnjeg taj sistem nisam mogao da nađem zbog toga što nekoresponduju ili ne komuniciraju jedno sa drugom, svaka individualno za sebe.

Ministarstvo, odnosno Departman za penzije jednostavno nema kapaciteta da može u jednoj opštini da kontroliše sva sela, da vidi da li su svi oni penzioneri živi, ili ne.

Prema tome u ovom momentu tehnički je neizvodljivo. Ja sam o tome razmišljao dugo, ali stvarno nismo našli način.

Opet se vraćam na ovaj procenat, i broj koji je od 4 264, podsećam još jednom da je 170 hiljade penzionera, što znači da je ovaj procenat negde 3%. Smatram lično da je procenat dobar, ako može da se kaže tako da je dobar, zbog toga što ipak 3 procenta u odnosu na taj veliki broj ljudi jeste vrlo mali.

I na kraju, da budem iskren, vi pričate o tome da je mnogo bitno ukoliko zakasnimo za jedan mesec ili dva meseca penziju. Ja mislim da su ovih procenti su bili mnogo veći kad smo počeli da funkcionišemo po ovom zakonu, i kad smo mogli da utvrdimo ko se od njih prijavio, a ko ne. Ovo je sistem automatski koji ih izbacuje, ali naravno automatskih ih vraća kada se prijave...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Një shpjegim ministër, veç po zgjatesh pak shumë. Urdhëro, e ke fjalën!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Faleminderit, kryetar!

Način kako bi moglo biti rešeno je naš predlog unutar zakona o penzijama sad da se svakom umrlom, odnosno porodici isplaće 100 evra za nadoknadu troškova sahrane. Prema tome, ako to bude onaj metod koji mi možemo da na neki način ljude privolimo da oni prijave svoj drage, a koji su umrli, onda bi to verovatno u datom periodu usvajanja Zakona o penzijama mogli biti rešiv. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Milivoje Stojanović, pyetje për zëvendëskryeminstirin Hajredin Kuçi. Deputeti nuk është këtu. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeminstirin Thaçi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pyetja është e javës së kaluar, por, megjithatë, meqë kryeministri po heziton t’u përgjigjet deputetëve në pyetjet parlamentare, unë po e parashtroj dhe shpresoj që ndonjëherë nga kjo fushatë boshe e kryeministrit të përfitojnë, apo më thjesht të kuptojnë qytetarët se çka do të thotë kryeministri.

Në mbledhjen e Qeverisë, të mbajtur më 13 mars të këtij viti, kryeministri me Qeverinë i shpall komunën e Gjakovës dhe komunën e Mitrovicës zona të lira ekonomike, bazuar në një koncept-plan.

Unë dua të di nga kryeministri, por edhe qytetarët e komunës së Gjakovës, në veçanti, se çka është ky koncept-plan, në fakt çka përmban ky koncept-plan, apo thënë më mirë - ku mund ta gjejnë ata këtë koncept plan për ta ditur se çka ka planifikuar në këtë fushatë, meqë a po vazhdon edhe sot e kësaj dite me fushatën e tij boshe, por më mirë t’u thuhet qytetarëve se kryeministri nuk po i zbaton as ligjet që është i obliguar t’i zbatojë Qeveria

dhe po i them edhe një herë, tash po e shfrytëzoj rastin, ministrit të Administratës, se më mirë është që të fillojë zbatimi i asaj rregulloreje, sesa 25% që është premtuar nga kryeministri Hashim Thaçi.

Pra, qytetarët, nëpunësit civilë më shumë do të përfitonin nëse zbatohet rregullorja, e cila ka hyrë në fuqi që nga 1 janari 2014, por kjo fushatë e Qeverisë nuk e di deri kur do të zgjasë. Qytetarët janë ngopur më me këto premtime boshe.

KRYETARI: Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Ferid Agani.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Agani,

Në Ligjin e shëndetësisë, në nenin 71 të tij, paragrafi 5, thuhet: “Pas licencimit, profesionisti shëndetësor që përcaktohet për të punuar në ambulancat e mjekësisë familjare në viset rurale do të punësohet menjëherë në kuadër të mjekësisë familjare për periudhën prej dy vjetëve”.

Pyetja ime për ju është: Kur mendoni që do të mund të fillojë implementimi i këtij neni për mjekët e posadiplomuar?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kuvendarë,

E nderuara zonja deputete,

Ju e dini se në periudhën para se ta marrë mandatin gjatë dy vjetëve nuk ka qenë i ndarë asnjë specializim për mjekët. Dhe, ne kemi qenë të ballafaquar me situatën që shumë mjekë që kanë qenë të licencuar kanë qenë në pritje edhe të shkollimit specialistik.

Këtë dispozitë ligjore të nenit 71 të Ligjit për shëndetësinë e kemi zbatuar në periudhën transitore duke angazhuar dhe duke i punësuar 263 mjekë të licencuar, të cilët e kanë filluar në ndërkohë programin e shkollimit specialistik me vetëfinancim dhe në masën më të madhe të mundshme u jemi përgjigjur kërkesave dhe një pjesë të shkollimit të tyre specialistik, pra të kohës që kalojnë gjatë shkollimit specialistik ata e kalojnë në mjediset e kujdesit parësor shëndetësor.

Ngel obligim i Ministrisë së Shëndetësisë që ata mjekë që përcaktohen vetë, pra që deklarohen, jo vetëm mjekë, por edhe stomatologë, punë tjerë shëndetësorë të licencuar që të përcaktohen vetë, të deklarohen se dëshirojnë të punojnë pas licencimit tash edhe tutje në mjedisin e kujdesit paqësor shëndetësor që t'i punësojmë në bazë të dispozitave ligjore, të cilat i kemi në fuqi.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, ministër!

Është shumë punë e madhe ajo që është bërë, që i keni specializantët që kanë qenë me vetëfinancim. Tani ata paguhën nga Ministria e Shëndetësisë. Është shumë e mirë, sepse ata gjatë shkollimit specialistik nuk do të kenë obligim të angazhohen në një punë shtesë, por do t'i përkushtohen specializimit. Por, kjo që unë po them në zbatimin e këtij neni është pikërisht me profesionistët shëndetësorë, me mjekët e rinj të posadiplomuar, në mënyrë që ata të mos i ndjekin më kurset e gjuhës gjermane, sepse me përfundimin e fakultetit, ata po fillojnë t'i përcjellin ato.

Dhe, pyetja ime është pikërisht prej shumë mjekëve që më janë drejtuar mua, kam obligim të ju drejtohem Ju, në mënyrë që ata sot ta kuptojnë a keni ndonjë plan, përveç asaj pune të mirë që keni bërë me specializantët. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zonja deputete!

Kjo që thatë është fakt. Ne është dashur të merremi me problemin, me masën dhe me cilësinë, e cila ka qenë e pranishme. Do të thotë, kanë qenë me qindra prej tyre që e kanë kryer fakultetin, janë licencuar dhe kanë qenë mandej me vetëfinancim në procesin e shkollimit specialistik. Ne sapo e kemi përfunduar edhe konkursin e ri për shkollimin specialistik, në të cilin janë pranuar 305 mjekë dhe stomatologë e farmacistë në specializime. Me këtë e kemi ngritur numrin e profesionistëve shëndetësorë në shkollim specialistik në 1 074.

Pra, do të vazhdojmë që tash e tutje, të gjithë mjekët që licencohen dhe paraqiten me vullnet për të punuar në mjedisin e kujdesit paqësor shëndetësor në viset rurale që t'ua sigurojmë kushtet ligjore për të punuar dhe këtë do ta bëjmë duke ndarë buxhetin për drejtoritë përkatëse komunale të shëndetësisë, ku ata duhet të punësohen në qendrën kryesore të mjekësisë familjare.

KRYETARI: Deputetit Sahip Muja, pyetje për ministrin Agani.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj që e kemi mbajtur në kondicion sot ministrin, por shpresoj që edhe të mos i harroj ato çka deklarojmë, çka prononcohemi dhe çka obligohemi.

Ministër, çështja është se para disa ditësh dhe në vazhdimësi kardiokirurgjia, por edhe sot, e shohim nëpër medie, përmendet për keqmenaxhim nga Ministria e Shëndetësisë.

Kisha pasur dëshirë ta di kush menaxhon, cili institucion menaxhon me këtë projekt dhe sa ka financa të paimplementuara nga Qeveria italiane dhe pse nuk implementohen dhe nga kreditimet e miratuara nga ky parlament a mundeni që së paku dy arsye objektive t'i paraqitni, që edhe pas katër vjetëve tuaja, ky sistem nuk po funksionon.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuar zoti deputet,

Unë nuk e kam fort vështirë, kondicionin e bëjmë dhe e kemi formuar në Ministrinë e Shëndetësisë në këta tre vjet me punën e përditshme. Prandaj, kjo është vetëm një lloj paraqitjeje publike e kapaciteteve.

Fillimisht, besoj se pajtoheni me mua, nuk bëhet fjalë për sistem, bëhet fjalë për shërbim të kardiokirurgjisë, të cilin e kemi themeluar për herë të parë dhe e kemi paraparë edhe me statutin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për herë të parë gjatë mandatit tim. Ju vetë personalisht keni qenë i kyçur në këto procese dhe në përpjekje që të themelohet ky shërbim që nga viti 2004, në kohën sa keni qenë këshilltar i kryeministrit, dhe e dini mirë se për çka po flasim.

Të kishte qenë e lehtë e kishit krijuar më herët, do të ishte krijuar shumë më herët, e jo në vitin 2013. Pra, është një proces shumë kompleks, tejet serioz, i cili kërkon realizim në shumë dimensionë njëkohësisht.

Projekti i kardiokirurgjisë, zhvillimet e kardiokirurgjisë zbatohen në bashkëpunim me Qeverinë italiane. Është pjesë e një projekti, mbështetës donator i cili për kardiokirurgji e ka ndarë një vlerë prej 1,8 milion euro.

Dhe, ky projekt ka filluar mjaft mirë të zhvillohet qysh nga marsi i vitit të kaluar, pra e ka shënuar një vit tani më prej kur ka filluar të zhvillohet dhe ka pasur ngecje në zbatimin e tij për shkaqe, të cilat në radhë të parë kanë qenë të lidhura me funksionimin e agjencisë italiane për bashkëpunim, e cila selinë për Kosovë e ka pasur në Beograd.

Dhe, vështirësitë në funksionimin e kësaj agjencie ka kushtëzuar që një pjesë e madhe e fondeve të parapara për shpenzim në Ministrinë e Shëndetësisë gjatë vitit të kaluar nuk kanë mundur të dorëzohen me kohë.

Konkretisht, në vitin 2013-2014 ka qenë e paraparë të shpenzohen, po flas për vitin e parë të punës, 1,1 milion euro, prej të cilave janë shpenzuar 350 mijë euro dhe kanë ngelur për t'u shpenzuar edhe 750 mijë euro në aparatura, në pajisje, në trajnime të domosdoshme e të tjera.

Projekti udhëhiqet nga Këshilli Drejtues. Këshillin Drejtues e përbën ambasadori i Republikës së Italisë në Kosovë, ministri i Shëndetësisë, drejtori i Shërbimit Kardiokirurgjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe drejtori i Zyrës Ndërlidhëse të Agjencisë Italiane për Bashkëpunim.

Sipas fjalëve të ambasadorit italian nga takimi i fundit, që është mbajtur para dy javësh, Agjencia italiane është rifunksionalizuar, selia e saj është vendosur në Tiranë dhe presim alokimin e mjeteve brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Ajo që dua të theksoj është se e kemi planin që projekti të mbështetet në vazhdimësi në të ardhmen, në bashkëpunim të drejtpërdrejtë të Shërbimit Kardiokirurgjik dhe Qendrës Klinike Universitare të Kosovës me spitalin...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë? A do ta bësh pyetjen e dytë?

SHAIP MUJA: Ministri mbeti pa u përgjigjur, sigurisht për shkak të kohës. Mirëpo, unë mendoj që nëse ky shërbim nuk funksionalizohet, i dëgjuam edhe replikat pak më parë, faji është në menaxhmentin e lartë, nuk është te profesionistët direkt, është te planifikimi, te operacionaliteti i kohës për resurset humane. Mjete ke të mjaftueshme për ta implementuar. Unë ju pashë edhe me doktorëshën kur replikuat. Ne mund t'i sfidojmë të gjitha ato probleme, të cilat na paraqiten, nëse organizohemi më mirë dhe ato varen nga Ministria e Shëndetësisë.

Ne e dimë që 1 000 persona në vit kërkojnë shërbime për kardiokirurgjinë. Midis tyre janë 300 fëmijë, nëse mesatarja e tyre është 10 000 mijë euro, janë 10 milionë euro që dalin nga shërbimi publik, e shkojnë ose në privat, ose jashtë Republikës së Kosovës si minimum, por kjo vlerë është edhe më e madhe, sipas disa analizave.

Prandaj, ekonomistët dhe këta që mbajnë numrat, mund të na akuzojnë edhe si shëndetësi për evazion fiskal, meqë lejojmë...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYETARI: Ministër, nëse mundesh si shkurt!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

M'u ndal koha, nuk munda të përgjigjem në pjesën e dytë të pyetjes të deputetit. Te çështja e kreditimit, pasi e përmendët, me siguri aludoni në huan të ashtuquajtur të butë nga Qeveria e Austrisë, ku Ministria e Shëndetësisë ka aplikuar për projektin e kardiokirurgjisë dhe ku jemi në rrugë të mirë të realizimit të këtij projekti, i cili do të mundësojë instalimin e dhomës operative të tipit 'hibrid' në Shërbimin e Kardiokirurgjisë të QKUK-së, në vlerë prej 4,6 milionë euro.

Kjo vlerë ka qenë në vitin 2011, tash me siguri do të jetë më e ulët, pas negocimit që do të bëjë Ministria e Financave në periudhën e ardhshme kohore, pas identifikimit të operatorit ekonomik nga Qeveria, ose autoriteteve përkatëse financiare të Austrisë.

Edhe një herë po e theksoj, po të kishte qenë aq lehtë të themelohej kardiokirurgjia, ajo do të ishte themeluar deri në vitin 2013, por mu duke i tejkaluar ato vështirësi menaxheriale që i përmendët me të drejtë, sepse gjithmonë ka hapësirë për t'u punuar më mirë, edhe të ketë menaxhim më të mirë, ne kemi arritur që ta funksionalizojmë këtë shërbim, ta vëmë në kornizë ligjore, t'i dërgojmë katër specialistë të kardiokirurgjisë për trajnim gjatë këtij muaji jashtë vendit dhe atë në periudhë më gjatë kohore se një vit.

Dy specializantë për kardioanestezeologji dhe tetë infermiere posaçërisht për kardiokirurgjinë pediatrike.

Pra, është duke u punuar, ka hapësirë për përmirësime, por rezultatet nuk mund të mohohen në asnjë mënyrë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja, pyetje për ministrin Agani.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër, në media keni deklaruar se sigurimet shëndetësore që do të fillojnë në janar të vitit 2015, domethënë do të jenë funksionale.

Shtrohet pyetja kësisoj: Kur do të jetë funksional sistemi i informimit shëndetësor nga Qeveria e Luksemburgut, kur dihet që zyrtarisht ky projekt nga Luksemburgu do të dorëzohet në dhjetor të vitit 2015. Në çka jeni bazuar që do të jetë funksional ky prononcim që keni bërë në media? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuari zoti deputet,

Fillimisht jam bazuar në faktin se gjatë muajit prill do të miratohet Ligji për sigurime shëndetësore, së pari, dhe shpresoj që do ta kalojmë sot në seancën parlamentare, që do ta krijojë bazën ligjore për fillimin e funksionimit të sistemit të sigurimeve shëndetësore.

E dyta, jam bazuar në ndërtimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Agjencisë të financimit të shëndetësisë, me projektin mbështetës të Bankës Botërore, në vlerë prej 25,6 milionë dollarë për 5 vjetët e ardhshme, e cila kontratë është negociuar ndërmjet Bankës Botërore dhe Ministrisë Financave. Pritet edhe miratimi në Bordin Drejtues të Bankës Botërore, në maj, në Uashington. E kam bazuar në faktin se sistemi i informimit shëndetësor, që nuk është duke u zhvilluar vetëm me mbështetjen e Qeverisë të Luksemburgut, duhet theksuar këtë se në tre vjetët e fundit Qeveria e Kosovës nëpërmjet buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë i ka investuar dhe do t'i investojë 3,8 milionë euro nga buxheti i saj në këtë projekt, por edhe Qeveria e Luksemburgut e ka pasur pjesën tjetër të investimit dhe ky projekt i sistemit të informimit shëndetësor, i cili përshin zonën pilot, e cila përfshin Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, me Spitalin Rajonal të Prizrenit dhe qendrën kryesore të mjekësisë familjare, përfshirë të gjitha qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulancat familjare në rajonin e Prishtinës dhe të Prizrenit, duhet të jetë funksional në fillim të janarit të vitit 2015, e jo në fund të vitit 2015.

Për më tepër, atë prononcim e kam bazuar edhe në projektin për databazën e fundit të sigurimeve shëndetësore, të cilën e kemi paraqitur për financim nga projekti huamarrës i Qeverisë austriake dhe ky projekt parasheh që gjatë vitit 2014 ta themelojë konstruktin themelor dhe t'i krijojë predispozitat, në mënyrë që të regjistrohen të gjithë të siguruarit që japin, pra që paguajnë premiumet e sigurimit shëndetësor dhe që ta përcjellin me

sukses zbatimin e kontratave ndërmjet Fondit të Sigurimit Shëndetësor dhe institucionet shëndetësore me të cilat do të lidhen këto kontrata në sektorin publik dhe privat.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Muja, pyetje shtesë?

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti ministër,

Siç e di unë situatën, është pak më ndryshe. Mekanizmi për implementimin e sigurimeve shëndetësore nuk varet krejt prej sot, kur do ta miratojmë ligjin, prandaj duhet ta njoftojmë opinionin qartë se sigurimet shëndetësore do të jenë problem serioz dhe nuk do të pritët që në vitin 2014 do të jetë funksional, se po krijohet përshtypja se do të jetë funksional, ndërsa unë e kam kritikuar vetë kur ka qenë ky projekt nga Qeveria e Luksemburgut për një kohë kaq shumë të gjatë, sepse Kosova është një rajon shumë i vogël dhe kjo bashkëfinansohet me Qeverinë e Kosovës nga viti 2008-2009, në vlerë 8 milionë euro, dhe sot të pritët 7 vjet për t'u implementuar siguri shëndetësor, ju duhet t'i adresoni dhe nuk mund t'i merrni fajet komplet, por t'i identifikoni problemet nga resurset humane, nga çështja e operacionalitetit dhe nga të gjitha me radhë.

Prandaj, unë nuk mund t'u them qytetarëve që siguri shëndetësore do të ketë në janar, por mund ndoshta diku nga viti 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Mendoj se secili ka të drejtë t'i ketë projeksionet e veta, vlerësimet e veta. Unë po flas në bazë të fakteve. Sipas dinamikës, të cilën e kemi para nesh dhe programeve që jemi duke i zbatuar, thashë edhe një herë, të mbështetur nga Banka Botërore, të mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut, e cila edhe për katër vjetët e ardhshme veç i ka ndarë fondet e nevojshme për mbështetjen e reformës të sistemit shëndetësor, ku pjesa më e rëndësishme shkon për sistemin e informimit shëndetësor në vlerë prej 6 milionë euro, dhe në bazë të aktiviteteve që janë duke u zhvilluar në Agjencinë e financimit të shëndetësisë, po ashtu edhe të projektit që e përmenda të financimit të databazës së sistemit të informimit shëndetësor të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, sepse edhe këtë ta them, edhe keni të drejtë plotësisht, unë kur e kam marrë mandatin, sistemi i informimit shëndetësor në vend nuk e ka përfshirë fare sistemin e sigurimeve shëndetësore.

Komponenti financiar e këtij sistemi ka qenë plotësisht i mangët. Është dashur të zhvillohet një softuer krejtësisht i ri, i cili duhet të prokurohet gjatë këtij viti dhe të implementohet, në mënyrë që më 1 janar 2015 të jemi në gjendje që ta regjistrojmë çdo pagesë të sigurimeve dhe ta identifikojmë çdonjërin prej tyre në institucionet shëndetësore të kontraktuara. Unë jam i bindur që në qoftë se vazhdojmë me dinamikën të cilën e kemi filluar, me një punë mjaft të madhe, në periudhën e ardhshme kohore është e mundur që premiumet e para të fillojnë të paguhën në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore më 1 janar 2015 dhe që ligji të zbatohet në tërësi prej asaj date.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli, pyetje për ministrin Stavilevci. Ministri nuk është këtu, e keni fjalën zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Kryeministri Thaçi në fushatën parazgjedhore ka premtuar 500 milionë euro për bujqësi, ndërsa për vitin e ardhshëm i ka planifikuar vetëm 29 milionë. Gjithashtu, edhe për vitin 2016, 29 milionë. Fermerët e Kosovës janë të shqetësuar edhe për mënyrën e ndarjes së granteve dhe keqpërdorimet që po bëhen në këtë drejtim, meqë ministri i Bujqësisë nuk qenka këtu, ndoshta kryeministri mund të na shpjegojë edhe sa i përket keqpërdorimit të granteve, edhe sa i përket 500-milionëshit, të cilin ai e premtton vazhdimisht, që i bie në vitin e ardhshëm, nëse njëri prej 4 vjetëve të ardhshme është edhe viti i ardhshëm, kur ka planifikuar vetëm 29 milionë, pra jo 125 milionë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri nuk është këtu. Zoti kryeministër dëshiron që t'jua jap përgjigjen.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit shumë deputet i nderuar për pyetjen!

Po, ne jemi zotuar që të ndajmë 500 milionë euro për investime në bujqësi, investime këto që do të sjellin modernizimin e sektorit të bujqësisë, krijimin e vendeve të reja të punës. Për çdo vit do të ndahen, duke filluar nga viti i ardhshëm, 120 milionë euro në vit, ndërsa tash me rishikim përsëri do të rriten. Pra, investimet për 4 vjetët e ardhshme do të jenë 500 milionë euro, ndërsa gjithashtu jemi zotuar dhe tash fillon edhe implementimi i vendimit tonë, nga muaji maj për çdo hektar që qytetarët e mbjellin me vreshta, do të paguhen nga 1 000 euro dhe pagesa fillon nga muaji maj, ndërsa për të gjithë qytetarët që e punojnë tokën, për çdo hektar të punuar do t'i kenë nga 300 euro. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Topalli?

FATON TOPALLI: Sigurisht që do të dëshiroja që të ishin 125 milionë për vit, por çështja qëndron që në buxhet i keni planifikuar vetëm 29 milionë për vitin 2015. Shikojeni buxhetin, e dini, ndërsa për vitin 2016 asnjë cent më shumë se sa për vitin 2015, kështu që shumë kundërthënëse ky 125-milionëshi me atë që e thoni, dhe atë që e buxhetoni në Buxhetin e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Disa elemente shtesë sa i përket buxhetit do t'i prezantojë edhe ministri i Financave, por dëshiroj ta sqaroj edhe një çështje që juve ju intereson, gjithashtu. Atë që e thashë, ajo edhe do të bëhet, buxhetin e bëjmë ne, e jo të tjerët. Ndërsa, desha të sqaroj edhe preokupimin që u prezantua sa i përket vendimit për studentët e Universitetit të Prishtinës. Dëshiroj edhe një herë të sqaroj para të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe ju deputetë të nderuar, se të gjithë studentët e universiteteve publike, rreth 60 000 sish, do të jenë të liruar nga pagesa e semestrave për 50%. Këtu përfshihen studentët, bachelor, master dhe kandidatët për doktoratë.

Gjithashtu 50% do të ketë zbritje për studentët që banojnë në konvikte dhe ushqimi në mensë.

Nëse një familje ka më tepër se një student, do të paguajë vetëm për një student, e jo për të tjerët. Për të tjerët do të jetë gratis, ndërsa për brucoshët, maturanët aktual, regjistrimi i tyre dhe shkollimi i tyre në vitin e parë do të jetë krejtësisht gratis. Në të njëjtën kohë, dëshiroj të theksoj se ne kemi vendosur, meqë deri tani aktualisht kanë qenë 1 000 bursistë në universitetet publike, ndërsa tani e tutje do të jenë 1 500 bursistë studentë. Përfitues do të jenë rreth 60 000 studentë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj dëshiron ta plotësojë kryeministrin, meqenëse ka të bëjë me buxhetin, lidhur me pyetjen e shtruar.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet,

Korniza afatmesme e shpenzimeve është në proces e sipër. Tanimë kanë filluar konsultimet e detajuara me të gjitha organizatat buxhetore. Në bazë të ligjeve pozitive në Republikën e Kosovës, KASH-i do të prezantohet deri në fund të këtij muaji, pra deri me 30 prill. Ne i kemi ftuar të gjitha organizatat buxhetore dhe unë do t'ju them që vendimet të cilat janë marrë do të reflektohen në buxhet dhe për vitin e ardhshëm së paku do të jenë 100 milionë euro për bujqësi, duke përfshirë edhe buxhetin, por edhe mjetet të cilat janë të parapara nga donacionet dhe nga fondi. Faleminderit!

KRYESUESI: Meqenëse folën të dytë, kryeministri dhe një ministër, e drejta për replikë i takon zotit Topalli, për ministrin, jo për kryeministrin.

FATON TOPALLI: Në fakt, nuk po habitem që Qeveria e Kosovës, por edhe Ministria për Financa, planifikimin e bën sot për nesër. Në qoftë se ka qenë i planifikuar buxheti për vitin 2014, e janë paraparë edhe mjetet për vitin 2015 dhe 2016, nuk janë 125 milionë, por janë thjesht më pak se 29 milionë dhe më shumë se 28 milionë për vitin 2015. Për vitin 2016 janë 29 milionë, sa e keni paraparë.

Por, sidoqoftë kjo i bie që ne mund të fillojmë tek prej vitit të ardhshëm, deri tash nuk kemi jetuar. Ky planifikim që ju e bëni, nuk u ndihmon as bujqve, nuk i ndihmon as Kosovës, nuk u ndihmon as qytetarëve të Kosovës. Edhe ky është një prej fakteve të shumta që Qeveria ka huq sa i përket menaxhimit, sa i përket administrimit dhe thjesht qytetarët e Kosovës nuk i besojnë magjisë. Ju mund ta përdorni sa të doni shkopin magjik, por kjo çështje ka përfunduar.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Beqaj.

MINISTRI BEQIR BEQAJ: Sigurisht që çështja e buxhetit është çështje pak më e ndërlikuar, jo krejt sipërfaqësore, siç po prezantohet këtu. Dua t'i informoj qytetarët e

Republikës së Kosovës që luftimi i ekonomisë informale po jep rezultate të jashtëzakonshme. Ne vetëm 3 muaj në këtë vit, në krahasim me vitin paraprak, kemi mbledhur 20 milionë euro më shumë nga Dogana, që në mënyrë të drejtpërdrejtë nënkupton që buxheti mund të bëhet me kornizë afatmesme të shpenzimeve dhe ndryshime në të.

Unë po ju them që korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument zyrtar, i cili bazohet në bazë të prioritetëve të organizatave buxhetore dhe ato mjete do të reflektohen dhe, përveç kësaj, i nderuari deputet, korniza afatmesme është orientim dhe deklaratë e prioritetëve të Qeverisë dhe pastaj mbi deklaratën e prioritetëve, ndërtohet KASH-i (korniza afatmesme e shpenzimeve), dhe deri në fund të këtij viti do të silllet buxheti, prandaj nuk është masë kjo që po thoni që as në vitin 2015, as në vitin 2016. Ajo që është shumë e rëndësishme është që stabiliteti fiskal i vendit...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Më lejoni që publikisht t'i ftoj deputetët që janë në zyrat e Parlamentit të vijnë në sallë, meqenëse kemi dy pika të rendit të ditës të cilat kërkojnë 80 deputetë në sallë për të votuar dhe i lus edhe kryetarët e grupeve parlamentare që të komunikojnë me deputetët për të qenë në sallë.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Ju pyes, të nderuar deputetë, nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës së mbajtur më 27 mars 2014. Nëse nuk ka, atëherë konstatoj që Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 27 e 28 mars dhe 3 prill 2014.

Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës të seancës paraprake që nuk është votuar për shkak të kuorumit. Edhe kjo pikë e rendit të ditës i kërkon 80 deputetë në sallë. Ne po fillojmë që ta shqyrtojmë, të debatojmë rreth kësaj, por dua t'ju njoftoj që në sallë janë 76 deputetë dhe duhen edhe 4 deputetë të paktën të jenë në sallë për t'u miratuar.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit” dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Besim Beqaj, ministër i Financave, si propozues i çështjes, që ta marrë fjalën për të na sqaruar lidhur me projektligjin.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Financave tani më e ka nënshkruar Marrëveshjen financiare me Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit” dhe e ka përfituar një kredi prej 4 931 000 euro, e cila mbulon koston totale të projektit.

Siç e dimë, marrëveshja kornizë është nënshkruar dhe është aprovuar edhe më herët edhe nga Kuvendi dhe kjo marrëveshje është hapi i parë i konkretizimit të marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë të Austrisë, marrëveshje e cila ia siguron një kredi të butë Republikës së Kosovës prej 20 milionë eurosh.

Kredia e siguruar nga kjo marrëveshje ka kushte të favorshme. Norma e interesit është 0%, tarifë-garancia 1,1% në baza vjetore, ndërsa maturiteti është 18 vjet, përfshirë dhe grejs-periudhën prej 8,5 vjetësh. Kjo marrëveshje synon krijimin e sistemit qendror të edukimit, ofrimin e softuerit për kushte trajnuese në teknologjinë informative, ofrimin e softuerit për kushtet trajnuese në aftësi biznesore, ofrimin e softuerit për kurse në sistemin e autorizimit, si dhe ofrimin e sistemit digjital për testin shtetëror të maturës.

Të gjitha këto aktivitete dëshmojnë përkushtimin e Qeverisë në fushën e arsimit, e cila përcaktohet si prioritet i lartë në deklaratën e prioriteteve afatmesme të Republikës së Kosovës. Sigurisht për detajet sa i përket projektet dhe komponentëve të projektit, këtu është ministri i Arsimit, i cili do të ju njoftojë, por nga unë si agent fiskal i Qeverisë së Republikës së Kosovës, pra Ministria e Financave propozon që të marrim vendime dhe normalisht të fillojë procedura për fillimin e implementimit të këtij projekti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, zonja Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka bërë shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”, në pajtim me nenin 18, paragrafi 1.4 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 10 të Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare, kështu që kjo marrëveshje ka ardhur në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Komisioni e ka shqyrtuar dhe unanimisht e ka miratuar.

Në komision kanë qenë të ftuar ministri i Financave dhe ministri i Arsimit. Deputetët kanë kërkuar sqarime në lidhje me këtë marrëveshje dhe pas sqarimeve të duhura nga ministri i Financave dhe nga ai i Arsimit, unanimisht e ka përkrahur këtë marrëveshje.

Projektligji po ashtu e ka përmbajtur në vete edhe autorizimin e Presidentes të Kosovës, që në bazë të nenit 7, paragrafi 1.8, dhe 9 të Ligjit numër 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar në zyrën e Presidentes më 27 shkurt 2014, dhe autorizimin që Ministria e Financave t'i kryejë veprimet e nevojshme në lidhje me këtë marrëveshje. Meqenëse ministri i Financave i dha sqarimet rreth përmbajtjes së kësaj marrëveshje, nuk e shoh të arsyeshme që të futem në detajet tjera të saj. Komisioni për Buxhet unanimisht e ka përkrahur, prandaj i kisha ftuar deputetët që ta përkrahin këtë marrëveshje, e cila ka të bëjë me e-edukimin dhe është një projekt shumë i favorshëm që i jep përparësi zhvillimit më efektiv të arsimit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të partive politike, respektivisht kryetarëve, ose ata që janë të ngarkuar. Nuk është paraqitur askush për ta marrë fjalën lidhur me ligjin. Në sallë janë 79 deputetë.

(Ndërprerje e incizimit.)

Në sallë tani janë 82 deputetë.

E votojmë në fillim pikën, e cila ka mbetur nga seanca e kaluar, që është: *Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.*

Votojmë tash!

Nuk kalon, 75 vota për. Tani jemi në proces të votimit, e harroni të votoni! Kjo është papërgjegjësi totale. E përsëritim edhe një herë votimin.

A është edhe dikush tjetër që nuk ka kartelë, e do të votojë për?

(Debat në sallë.)

Zonja Bytyçi nuk ka kartelë, zoti Halit Krasniqi nuk ka kartelë, votojnë për. Detyra jote është ta rregullosh, nuk është imja.

Atëherë, e përsëritim votimin. Votojmë tani!

Janë 78 vota me elektronikë, 2 janë pa kartelë, zonja Bytyçi dhe zoti Krasniqi, bëjnë 80 vota për, një është abstenim. Konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

E votojmë tani pikën të cilën e paraqiti ministri i Financave dhe kryetarja e komisionit, *Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”*.

Në sallë tani janë 83 deputetë. Votojmë tash!

Faleminderit! I kemi 78 vota me elektronikë për, 2 pa kartelë zonja Bytyçi dhe zoti Krasniqi. Një abstenim. Konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin nr. 04/L-266 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”.

Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Arsimit zotin Ramë Buja, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Buja e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë,

Projektligji për arsimin e lartë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bazë të legjislacionit në fuqi ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara për procedimin dhe miratimin e Projektligjit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, ku për disa muaj janë mbajtur konsultime paraprake dhe diskutime publike me të gjithë aktorët e paraparë për pjesëmarrje në këto diskutime.

Janë pranuar komente dhe sugjerime të cilat besojmë se e kanë përplotësuar dhe do ta bëjnë më të zbatueshëm në praktikë këtë projektligj që nesër do të bëhet ligj ose sot ose pas leximit të dytë. Projektligji i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës ka për qëllim të rregullojë bazën ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë për zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

Ndryshimet dhe plotësimet që janë bërë në këtë projektligj janë si në vijim: emërtimi i bartësve privat është ndryshuar është bartës jo publik. Te kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e arsimit të lartë është shtuar kompetencat si ndërmarrje e veprimeve për menaxhimin e situatave, të cilat pengojnë dhe rrezikojnë funksionalitetin e institucioneve të arsimit të lartë.

Te themelimi, shkrirja dhe shuarja e bartësve publik të arsimit të lartë është bërë ndryshim plotësimi ku thuhet se themelohen me vendim të Ministrisë i cili duhet të

aprovohet në Kuvend. Në rast se Ministria konstaton se është në interesin e përgjithshëm shkrirja apo mbyllja e një bartësi publik të arsimit të lartë, i propozon Qeverisë për të marrë një vendim të tillë, i cili duhet të miratohet gjithsesi në Kuvend dhe do t'i bëjë të njohura publikisht arsyet e vendimit të saj.

Para marrjes së vendimit për shkrirjen apo shuarjen e një bartësi të arsimit të lartë Ministria publikon një dokument diskutimi dhe konsultohet me organin drejtues të të gjithë bartësve tek të cilët ndikon ky vendim, si dhe me Agjencionin Kosovar të Akreditimit. Vendimi i Ministrisë për të mbyllur apo shuar një institucion të tillë duhet të ... patjetër në Kuvend.

Te titujt dhe gradat e personelit është si në vijim: stafi akademik i angazhuar në pozitat menaxheriale në nivel të njësive akademike apo në nivel institucioni nuk mund t'u nënshtrohet procedurave të avancimit akademik për periudhën kohore sa e mban pozitën menaxheriale.

Te përgjegjësitë e Këshillit Drejtues të universiteteve publike është shtuar se ndarja e detyrave dhe përgjegjësiave sa i përket çështjeve akademike të jetë e precizuar në statut të Universitetit. Janë shtuar nenet për konferencën e rektorëve, asociacionin e bartësve jopublik, Unionin Nacional të Studentëve. Kjo e fundit është edhe kërkesë që del procesi i Bolonjës. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë projektligj nuk kanë kosto shtesë buxhetore, që do të thotë se ligji ka po të njëjtën kosto që ka pasur edhe më herët në miratim në vitin 2011.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, kërkoj nga ju që të miratoni këtë projektligj dhe të jepni kontributin tuaj profesional për ta bërë më të mirë se që ishte.

Në takime që kam pasur unë dhe përfaqësuesit e Ministrisë në universitetet e ndryshme publike në Kosovë, kanë dalë edhe propozimet e tjera përplotësuese që besoj edhe në diskutimin publik që do ta mbajë komisioni përgjegjës dhe gjegjës do të përplotësohen siç është: halli apo tendenca apo kërkesa që njësitë akademike të kenë autonomi më të madhe se sa që kanë sot, kërkesa që përse të jetë rektori edhe kryesenator ku ka arsye dhe mundësi të jetë kryesenatori i veçantë dhe rektori po kështu i veçantë.

Dhe, gjithsesi është shtuar me shumë dilemë përse të jetë mosha e caktuar kur është çështja e avancimeve dhe zgjedhjeve që bëhet në universitet publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, zotit Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur, më 2 prill 2014 shqyrtoi në parim Projektligjin për arsimin e lartë

në Republikën e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin, të miratohet në parim Projektligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës nr. 04 / L – 268.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të Projektligjit 04/L-268 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, vlerëson se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores dhe ftojme të gjithë kolegët deputetë që të votojnë në parim këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ne, Grupi Parlamentar i PDK-së kemi shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës për faktin se e konsiderojmë të një rëndësi të veçantë për fushën të cilën e rregullon.

Unë do të përmend propozimet për amendamentimin e ligjit sipas radhës që vijnë nenet në këtë ligj.

Ne, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mendojmë që duhet të rregullohet mirë emërimi i anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe ka vend që të diskutohet për rritjen e numrit të këtyre anëtarëve.

Kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim duhet të bëhen të qarta, të ndara prej Ministrisë së Arsimit dhe duhet të theksohet se vendimin për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë e lëshon Ministria e Arsimit duke u mbështetur në vendimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Pastaj, duhet të diskutohen kushtet dhe kriteret të cilat duhet t'i plotësojnë institucionet private të arsimit të lartë për të fituar emrin Universitet. Ne i kemi disa vërejte si komision, vërejtje me shkrim prej institucioneve private të arsimit të lartë dhe ato do të shqyrtohen detajisht në grupin punues që e ka formuar Komisioni për Arsim.

Anëtarët e Këshillit Drejtues të universiteteve mendojmë që mund të propozohen prej Ministrisë së Arsimit, ndërsa ka vend të diskutohet që a duhet ata anëtarë të bordit apo Këshillit Drejtues të Universitetit të bëhet si me thënë miratimi i tyre në Kuvendin e Kosovës.

Është vetëm frikë që për shkak të polarizimeve nuk mund të mblidhen vota të mjaftueshme dhe mund të mbesin pa bord, mirëpo ky variant duhet të shqyrtohet më detajisht në grupin punues të komisionit tonë, Komisionit për Arsim.

Kemi po ashtu propozime, në mënyrë që të evitohet ndikimi i politikës në përzgjedhjen e rektorit duhet të shqyrtohet mundësia që rektori të emërohet nga Senati i Universitetit apo të votohet drejtpërdrejt nga i gjithë stafi akademik i Universitetit.

Këto janë mundësitë të cilat i kanë dhe shtetet tjera, për shembull mund të votohet drejtpërdrejt për gjithë stafin, ndërsa mundësia që të përzgjidhet edhe të votohet apo të emërohet nga senati ka qenë disa vite më herët edhe këtu. Gjithsesi ne do ta mbështesim variantin që është i pranueshëm për të gjithë dhe bën zgjidhje afatgjate për zgjedhjen e menaxhmentit të universiteteve tona publike.

Ne mendojmë që Senati i Universitetit duhet të udhëhiqet nga kryesuesi i Senatit e jo nga rektori. Po ashtu, pjesë e Senatit nuk mund të jenë dekanët e njësive akademike për të mund të ndarë pushtetin menaxherial nga çështjet akademike dhe njëherit kjo ngrit më tepër varshmërinë dhe bashkëpunimin mes njëri-tjetrit të këtyre dy organeve të universiteteve.

Pikë tjetër është mënyra dhe kushtet e pranimi dhe avancimit të stafit akademik, se a duhet të pranohen apo të avancohen me publikimet e tyre në revista me impakt faktorë apo në revista me recension ndërkombëtar.

Ne e dimë me impakt faktorë automatikisht nënkupton kualitetin e lartë të punimit, sepse revista që ka impakt faktorë nuk publikon gjithçka. Ndërsa, këto me recension ndërkombëtar mund t'i marrim ne, ndërkombëtar është edhe nëse shkojmë në shtetet afër Maqedoni, Shqipëri, Mal të Zi, Bosnje e kështu me radhë. Prandaj, ne mendojmë që gjithsesi sido që të mbetet edhe me impakt faktorë edhe me revista me recension ndërkombëtar se ka disa fusha që nuk mund të publikojnë në revista me impakt faktorë, ne mendojmë që gjithsesi të bëhet një listë e revistave sipas fushave e cila do të aprovohet nga Senati i Universitetit apo senatet e universiteteve dhe kjo listë të ketë aprovimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Do të merren të pranueshme për publikim të artikujve të gjithë atyre që pretendojnë të pranohen apo të avancohen në tituj akademik, do të krahasohen a i kanë publikimet në këto revista që janë të pranueshme prej Senatit, apo që validohen prej Senatit dhe Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.

Është një pikë shumë e ndjeshme që është edhe mendim i grupit, por unë mendoj që personalisht edhe nga kontaktet me stafin akademik, unë e kam një propozim konkret që është edhe në emër të grupit, ne jemi që të caktohet me këtë ligj mosha e pensionimit të stafit akademik të Universitetit dhe kjo moshë të bëhet në 68 vjet.

Pasi që stafi akademik i universiteteve nuk janë shërbyes civil, janë kategori e veçantë e punëtorëve të Republikës së Kosovës, po ashtu edhe punonjësit e ndryshëm shkencorë të cilët bëjnë punë hulumtuese shkencore dhe akademike, mendojmë që duhet të rregullohet edhe mosha e pensionimit me Ligjin për arsimin e lartë.

Kjo ka arsyeshmërinë në nevojën e domosdoshme të kuadrit të lartë shkencor i cili i nevojitet të gjitha universiteteve publike në Republikën e Kosovës dhe ky kuadër është i pamjaftueshëm bile edhe për Universitetin e Prishtinës si universitet më i vjetër te ne.

Prandaj, mbarëvajtja e punës në universitetet tona ka ende nevojë të madhe për eksperiencën e profesorëve tanë që kanë arritur gati moshën e pensionimit, pra janë afër 65 vjet. Ne mendojmë që duhet ta shtyjme në 68 vjet, me mundësi pastaj të modaliteteve që mund të rregullohen me udhëzim administrativ për raste të veçanta që të mund të shtyhet ose deri 70 ose të zgjidhet mënyra e pranimi, angazhimit të profesorëve duke i dhënë tituj profesor meritues.

Pra, ne kemi ende nevojë për eksperiencën e profesorëve, të cilët njëherësh kanë qenë edhe prej themelimit të Universitetit të Prishtinës dhe këtë përvojë që e kanë bërë gjatë këtyre 40 e më shumë vjetëve duhet t'ua përcjellin ende gjeneratave të reja.

Pra, mosha 68 vjet është e aplikueshme edhe në disa vende tjera të rajonit, pra nuk do të jemi të vetëm që ne mund të kërkojmë për rregullimin e moshës së profesorëve të Universitetit apo avancimin deri në 68 vjet të kalimit në pension. Kur bëhet fjalë për pranimin e studentëve mendojmë që duhet me ligj të caktohet edhe kuota e pranimi të studentëve të huaj duke filluar prej vendeve fqinje e më larg.

Pranimi i shtetasve të huaj është praktikë e të gjitha universiteteve të botës dhe kjo rrit vlerën e universiteteve tona, diversitetin e kulturave dhe përmes studentëve të huaj ne mund të shpërndajmë kulturën dhe vlerat tona nëpër botë.

I përshëndesim edhe ato që i tha ministri, në të vërtetë unë nuk kam marrë raste të cilat në ligj janë vlerësuar që janë shumë të vlefshme, për shembull është edhe ide e jona që njerëzit që janë në pozita menaxheriale duke filluar, rektori, prorektorët, dekanët, që të mos të avancohen gjatë pozitës së tyre në këtë funksion ose mund ta rregullojnë që dekanët edhe i gjithë stafi menaxherial nëpër njësitë akademike të jenë të rangut të profesorit të rregullt që të mos kenë konflikt interesi pastaj gjatë ushtrimit të detyrës ose të arrihet avancimi apo stagnimi në avancimin e tyre në gradë akademike.

Unë do të përfundoj me kaq, pra ne si Grup Parlamentar do ta votojmë në parim Projektligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit të tij në komisionin përkatës.

Njëherësh ftojme edhe kolegët tjerë të kontribuojnë me komentet e tyre dhe i ftojme që ta votojnë në parim. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua t'ju njoftoj për një lapsus jo, por për një gabim timin që e kam shpallur pikën 4, Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria. Kjo marrëveshje nuk ka kaluar sot për shkak se janë 79 vota që kanë votuar për të.

Unë e kam lajmëruar zonjën Bytyçi që është pa kartelë, ajo e kishte pasur kartelën, kështu që kjo marrëveshje nuk kalon me votimin që është bërë. Shpresoj që Qeveria do ta ri sjell për ta votuar. Faleminderit!

Halitit, tash ju ka ndezur ajo kartela po nuk ka votuar Haliti me kartelë, pa kartelë ka votuar. Në atë votimin e mëhershëm që ka qenë, kanë qenë në rregull edhe zonja Bytyçi edhe zoti Krasniqi s'i kanë pasur kartelat. Në votimin e dytë, zonja Bytyçi e ka pasur kartelën, po unë nuk e kam ditur që e ka fut kartelën e dëgjova që diçka po flet, por këtu unë s'e kam dëgjuar. Kështu që dua t'ju informoj që kjo është gjendja dhe besoj që e shqyrtojmë ose në Kryesi ose Qeveria duhet ta risjell, varësisht nga vendimi i Kryesisë.

Vazhdojmë me diskutimet lidhur me shqyrtimin e Ligjit për arsimin e lartë.

Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kush e ka fjalën? Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Edhe gjatë diskutimeve në Komisionin Funkcional, por edhe me kolegët e Grupit Parlamentar, e mirëpresim iniciativën që të iniciohet Ligji për arsimin e lartë. Të them të drejtën flas në emër timin, kam pritur më shumë, sepse edhe një pikë tjetër që e kemi që Komisioni Funkcional e ka bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë sikur të kishte qenë një pikë më herët dhe pastaj të diskutohet për Universitetin, do të kishim mundur edhe më mirë për ta kuptuar se cilat janë shqetësimet dhe cilat janë pritjet në raport me këtë ligj.

Unë e di se nuk është pengesë që në mes të dy leximeve të amandamentohen dhe të futen ide të mira, por realisht unë kam pritur që njerëzit profesional çfarë i ka Ministria, në bashkëpunim edhe me njësitë e arsimit të lartë, do të jenë shumë konkretë për të përmbushur ato ambicie.

Sido që të jetë, unë do t'ju them disa prej asaj çka unë pres nga vetë ligji, ngase kjo edhe ka qenë motivi pse është iniciuar hartimi dhe dorëzimi i këtij projektligji në Parlament.

E para, unë mendoj se institucionet e arsimit të lartë kanë arritur pjekurinë dhe unë mendoj se tani duhet të depolitizohet. Mendoj se nuk ka nevojë më që ajo, atë ta mbajë Ministria, sepse konsiderojmë që është arritur një pjekuri. Edhe tani kur po diskutojmë secili po besoj prej neve 90% kur flasim për universitetet publike mendojmë në Universitetin e Prishtinës, që po diskutojmë se tani a është pjekur dhe a mund t'ju kryhet autonomi e plotë.

Ndërkohë ne kemi krijuar universitet anëmbanë Kosovës dhe tani shtrohet pyetja cili do të jetë kriteri, t'ju vlerësojmë universitetet sikur janë universitete të Prishtinës me këtë traditë apo ta kemi qasjen në universitete të reja që akoma nuk i kanë bërë dy vjet dhe ne gjatë monitorimit të Ligjit për arsimin e lartë kemi parë që ata akoma janë në zhvillim e sipër, janë fare në hapat e parë.

Sido që të jetë, unë mendoj se duhet të depolitizohen, do të thotë institucionet e arsimit të lartë, këtë rast flas posaçërisht për universitetet dhe se duhet të fuqizohet më shumë autonomia e funksionimit të Universitetit, pastaj ndarja e pushteteve. Unë mendoj se duhet të fuqizohet më tepër roli i senatit në llogari të Këshillit të Universitetit, pastaj duhet me ligj të definohen edhe njëherë mirë dhe diskutohet me institucionet e arsimit të lartë çështja e avancimeve, ngase ne e dimë se sa kanë qenë të diskutueshme kriteret dhe jo vetëm se tani së fundi janë zbuluar se kemi edhe publikime të punimeve shkencore jomeritore, po shtrohet pyetja se a ka qenë momenti që të futen ato kriteret apo nuk ka qenë momenti?

Tash është edhe njëherë edhe një mundësi që të dëgjohen pra njerëzit nëpër institucione të arsimit të lartë, se a duhet të ekzistojë ai kriter apo jo. Ose nëse ekzistojnë ato kriteret sa i përket publikimeve me apo pa impakt faktorë, atëherë shtetit duhet të bëjë diçka, meqenëse kemi ndarë edhe fondin për hulumtime dhe për shkencë, atëherë duhet medoemos që ne t'u krijojmë mundësitë që ata të mos kërkojnë India, e Pakistana, e Afganistana po të kenë mundësi këtu nëpër botime tona që ato t'i adresojnë. Dhe, varësisht nga ajo nëse ka punime dhe më kualitative shkencore ato edhe të botohen me impakt faktor në nivelin ndërkombëtar.

Pastaj, duhet edhe me këtë ligj edhe më mirë të precizohet çështja e institucioneve private, ngase duhet t'i ndihmojmë institucioneve private në monitorimin e funksionimit të tyre dhe të shtrohet pyetja se sa janë konkurrense kualifikimet, gjegjësisht diplomat dhe a janë të gjitha institucionet private në të njëjtën kategori që mendoj se nuk janë edhe aty shteti duhet të bëjë shumë, ngase një i diplomuar kur konkurron sipas ligjeve tona në fuqi, nuk dallon se ku e ka marrë atë diplomë dhe kjo nuk është e drejtë.

Mandej, duhet edhe me ligj të definohen dhe duhet të praktikohet shumë dëgjimet publike me studentë. Nëse ne po e krijojmë autonominë universiteteve, atëherë çështja e përfaqësimit pra të vullnetit në senat në rend të parë, por edhe me trupat e emëruara, mirëpo janë mësimdhënësit, janë studentët ata që tani e marrin përsipër funksionimin. Prandaj, studenti duhet të jetë faktor më i madh, së paku nëpër dëgjimet publike të dëgjojnë se cilat janë shqetësimet e studentëve dhe pastaj ato të kthehen aty ku duhet të merren vendimet, në rend të parë në senat po edhe në këshill edhe në menaxhment.

Çështja e fundit mënyra e financimit. Meqë është ideja që të krijohet një autonomi e plotë e universiteteve që në start duhet edhe të definohet mënyra e financimit që ata të mos varen edhe mos t'ua definojmë ne, t'ua parapërcaktojmë shpërndarjen e buxhetit para fushatave, pas fushatave dhe sipas dëshirave tona. Sepse, të merret vendimi në mënyrë jo kompetente se kur rriten pagat, pra jashtë institucioneve të cilat janë autonome dhe kjo po ndodh edhe me Universitetin edhe me ndërmarrjet publike që nuk është në rregull, që nga as kryeministri, as ministri, as në Parlament të shpallë rritje të pagave dhe ndryshimi i buxheteve në krahasim me institucionet që ligji ua ka garantuar autonominë.

Prandaj, edhe çështje tjera ka që u diskutuan dhe që mund të diskutohet dhe unë mendoj që tani meqë e kemi në dorë, është pikëpyetje se a do të mund ta votojmë në leximin e dytë, kjo përbërje së paku unë nga këndi i projeksioneve të Lidhjes Demokratike kam

dilema se a do të mund ta përfundojmë ligjin në lexim të dytë, por unë jam ithtar që të mos ngutemi që në momentin kur votojmë ligj me këtë përbërje apo në përbërjen tjetër, ai ligj t'i përmbushë të gjitha nevojat, të gjitha kërkesat, por edhe ambiciet që i kemi në mënyrë që me ligj ne të krijojmë parakushtet në mënyrë që arsimit të konsolidohet, sepse konsideroj se ajo është në njëfarë forme udhërrëfyes edhe për institucionet tjera, pastaj edhe të arsimit të mesëm, të arsimit fillor, por sigurisht edhe do t'i ndihmojë në përgjithësi zhvillimit të shoqërisë tonë në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit! I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Personalisht edhe unë pajtohem që raporti i Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë, është dashur ndoshta që të diskutohet para projektligjit, që aktualisht po e diskutojmë në parim dhe, jo në këtë mënyrë se si janë renditur këtu në seancë plenare për diskutim, sepse në këtë mënyrë të krijohet përshtypja sikur është prishur, në njëfarë mënyre, është prishur logjika e rendit të gjërave.

Por sidoqoftë, tash e kemi për diskutim Projektligjin për arsimin e lartë dhe po japim opinionet tona lidhur me përmbajtjen e këtij projektligji.

Kriza e cila e pat përfshirë tash e sa kohë në vendin tonë sferën e arsimit të lartë, natyrisht se e bën të domosdoshme edhe rishikimin e legjislacionit që mbulon këtë sferë. Për më tepër, vetë ngjarjet e fundit që e patën kapluar Universitetin e Prishtinës e ku mund të veçohet kryesisht rezistenca e studentëve ndaj ish strukturave drejtuese të këtij institucioni, tregoi qartë mbi nevojën urgjente që ka shoqëria jonë për të intervenuar në korrigjimin e disa prej defekteve kryesore nga të cilat lëngojnë institucionet tona akademike.

Përgjithësisht kjo krizë tregoi se pjesa më e madhe e saj buron nga hegjemonia politike e pushtetit mbi bartësit publikë të arsimit të lartë, dhe se ky raport i subordinimit të institucioneve të edukimit nga strukturat politike në masë të madhe ka derivuar edhe nga normat ligjore që e normativizojnë këtë sferë.

Prandaj, ndryshimi i legjislacionit në sferën e arsimit të lartë është nevojë qenësore për të tejkaluar këtë gjendje. Po shtrohet pyetja se ky projektligj që aktualisht jemi duke e diskutuar në parim, a arrin që t'i adresojë shumicën e sfidave me të cilat është duke u ballafaquar sfera e arsimit të lartë në vendin tonë.

Dhe, duke gjykuar në bazë të përmbajtjes së dispozitave të tij, padyshim se si i tillë ai nuk ofron zgjidhje adekuate për shtegdalje nga gjendja ku ndodhet ky nivel i edukimit.

Fillimisht, më duhet të them se një pjesë e madhe e disa nga neneve të këtij projektligji paraqesin më tepër fraza abstrakte, sikurse të marrim shembull, nenin 5 paragrafin 1, ku

thuhet se në arsimin e lartë, që ofrohet nga bartësit e licencuar të arsimit të lartë në Kosovë do të kenë qasje të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës.

Konsiderojmë se ky formulim është më tepër, ndoshta i karakterit formalo-juridik, por shfrytëzimi përmbajtjesor i këtij neni dhe e drejta për të pasur qasje të plotë në sferën e arsimit të lartë, për të gjithë ata persona që dëshirojnë ta realizojnë këtë të drejtë, varet në masë të madhe edhe nga gjendja ekonomike dhe sociale, si e tyre ashtu edhe e familjeve të tyre.

Madje, lirisht mund të thuhet se sfera e arsimit në Kosovë ka karakter regresiv. Çdo të thotë kjo, karakter regresiv?

Financimi i bartësve publikë të arsimit të lartë është bërë dhe bëhet nga taksat e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Pra, këto taksa i paguajnë si të pasurit ashtu edhe të varfrit. E dihet se mundësitë për edukim i kanë vetëm ata që janë në gjendje më të qëndrueshme ekonomike. Rrjedhimisht, kjo i bie që të varfrit deri më tani paguajnë për shkollimin e të pasurve.

Këtu është karakteri regresiv dhe paradoksal i sistemit të edukimit të lartë në sferën e arsimit.

Po ashtu, neni 6, pika 1.2 te kompetencat e Ministrisë, thuhet se Ministria e Arsimit e bën rregullimin e statusit të bartësve publikë dhe privatë të arsimit të lartë dhe miratimin e statuteve të tyre, me ç'rast thuhet se statutet e të gjithë universiteteve dhe cilido aplikues për... universitet duhet të ratifikohet nga Kuvendi. Konsiderojmë se që të jetë kuptimplotë ky projektligj, Kuvendi duhet t'i miratojë edhe statutet e bartësve privatë, jo vetëm atyre publikë.

Neve kemi vërejtje edhe sa i përket nenit 7, i cili mbulon veprimtarinë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Konsiderojmë se është jetike që ky mekanizëm që merret me vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e bartësve të arsimit të lartë, si të atyre publikë ashtu edhe të atyre privatë, duhet të derivohet drejtpërdrejt nga Kuvendi i Kosovës dhe jo nga Ministria e Arsimit, siç është tani.

Po ashtu, edhe mënyra e emërimit të anëtarëve të saj është e domosdoshme që të ndryshojë. Duhet që Kuvendi ta bëjë drejtpërdrejt konstituimin e këtij bordi, nëpërmjet konkursit që do ta hapë dhe zgjedhjes së anëtarëve të AK-së me anë të seancës plenare.

Te neni 8, ku bëhet fjalë për bartësit publikë të arsimit të lartë, paragrafi 1 thotë se bartësit publikë të arsimit të lartë janë Universiteti dhe institucionet tjera të arsimit të lartë, konsiderojmë se është e nevojshme dhe e domosdoshme që të definohet me ligj, të gjitha ato institucionet të tjera, me çka nënkuptohet se janë bartës të arsimit të lartë publikë.

Me qëllim të krijimit të një pasqyre sa më të saktë të funksionimit të arsimit të lartë, është e nevojshme që krahas bartësve publikë, që themelohen nga Kuvendi, siç e parasheh ligji

në fuqi, duhet që me këtë projektligj këtë të drejtë Kuvendi ta ketë edhe sa i përket bartësve privatë. Pra, të gjithë ata bartës privatë, që pretendojnë ta marrin emrin “universitet”, në njëfarë mënyre duhet të themelohen nga Kuvendi i Kosovës.

Konsiderojmë se po ashtu ajo që është e papranueshme në këtë projektligj mbetet mënyra e njëjtë dhe e pandryshuar, që ka mbetur që nga ligji, që aktualisht është në fuqi dhe që ka të bëjë me strukturat qeverisëse të bartësve të arsimit të lartë publikë, sikurse janë Këshilli Drejtues.

Këta mekanizma, në mënyrën se si kanë qenë dhe si propozohet të jenë ende, është dëshmuar se nuk kanë qenë asgjë tjetër, pos organe që kanë bërë të mundur ushtrimin e ndikimit politik nga Qeveria. Prandaj, me qëllim të demokratizimit të raporteve brenda këtyre institucioneve dhe respektimit të kritereve akademike, është e domosdoshme që të ndryshohet rrënjësisht ky nen në favor të eliminimit politik qeveritar mbi Universitetin.

Për më tepër, irracionaliteti politik ka tejkaluar kufijtë e absurdit, pikërisht me këto borde. Raportet e medieeve, ku tregohet se si emërimi në kuadër të këtyre personave, në kuadër të këtyre bordeve i personave, sikurse Ramadan Muja apo Avni Kastrati në Universitetin e Prizrenit, përkatësisht të Mitrovicës, qoftë edhe përkohësisht siç janë arsyetimet banale të Ministrisë, e tejkalon çdo normë dhe standard, si jetik ashtu edhe juridik.

Ky akt përbën në njëfarë mënyre një intervenim brutal, që mund t’i bëhet një institucioni që pretendon të quhet akademik.

Sa i përket pjesës tjetër të autoriteteve menaxhuese, sikurse është rektori, po ashtu duhet të bëhen ndryshime të domosdoshme edhe në këtë nen. Është e rëndësishme, që çdokush që pretendon të konkurrojë për këtë post, duhet të mos ketë qenë dy-tre vjetët e fundit në asnjë post të lartë politik drejtues, qoftë në formacione politike apo institucione qeveritare.

Nëse këtë parim e kemi zbatuar për shumë borde, sikurse ata të KPM-së, RTK-së e tjera, atëherë është më se e domosdoshme, që si i tillë të aplikohet edhe në pozitat drejtuese të Universitetit.

E tek neni 22, ku përmenden kushtet e financimit, në paragrafin 6, e konsiderojmë joadekuat formulimin, ku thuhet se Ministria mund të anulojë fonde, për të cilat mendon se janë keqpërdorur. Një veprim i tillë, konsiderojmë se nuk mund të merret vetëm mbi bazën e supozimeve, por vetëm pasi Ministria të ketë fakte të plota se kanë ndodhur abuzime të tilla financiare në këtë drejtim, sepse nëse e lëmë kështu siç është, mund të krijohen rrethana dhe mundësi, që cilido ministër, jo vetëm ky aktual, por edhe ata që do të vijnë, mund ta përdorin këtë formulim ligjor për persekutim politik ndaj drejtuesve të caktuar të fakulteteve.

Ekzistojnë edhe shumë çështje të tjera, që duhet të ndryshohen, që nga mënyra se si përshkruhen titujt akademikë e deri tek mënyra se si bëhet caktimi i profesorëve meritues.

Por, për të mos ju marrë më shumë kohë, këto çështje do t'i procedoj për amendamentim në Komisionin Parlamentar, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje".

Ky projektligj në këtë formë si ka ardhur për diskutim, padyshim se i ka disa përmirësime të vogla, që nuk bën të mohohen, sikurse neni 6, pika 1.14 apo edhe neni 26, pika 3, ku parashihet që stafi akademik i angazhuar në nivel të njësive akademike apo në nivel institucional nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të avancimit akademik derisa mban pozitë drejtuese.

Por, me gjithë këto përmirësime, konsiderojmë se ai nuk arrin të përmirësojë substancialisht krizën në të cilën ndodhet sfera e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk dua ta përsëris, por e do logjika që si pikë e rendit të ditës, Kryesia e Kuvendit ka gabuar në renditjen e kësaj pike. Përpara është dashur të renditet monitorimi, pra raporti i monitorimit të Ligjit të arsimit të lartë, pastaj të jetë në diskutim edhe ndryshimi i këtij ligji.

Por megjithatë, ne si grup parlamentar do t'i japim përkrahjen në parim këtij projektligji. Kemi shumë vërejtje e sugjerime. Unë do të filloj disa nga ato sugjerime, që ne i kemi menduar, për të treguar edhe njëherë sepse ka shumëçka që ka mbetur pra, thjeshtë një hapësirë shumë e madhe në këtë projektligj.

Integriteti dhe etika akademike nuk përmenden askund në ligj, edhe pse këtu ka qenë dhe është problemi i cili e ka sjell situatën në të cilën po ndryshohet ligji.

Integriteti dhe etika akademike duhet të përmenden, të paktën tek neni 2, pra tek parimet. Këshilli drejtues duhet të jetë vetëm këshill mbikëqyrës, anëtarët e Këshillit drejtues duhet të jenë përgjegjës, jo vetëm kolektivisht, por edhe individualisht, pra tek neni 23.

Tek neni 26 nuk e parashih titullin e ligjëruesit, ligjëruesit të lartë ose ligjëruesit universitar për universitete publike, por vetëm për ato private, pra jo publike.

Kjo s'ka logjikë dhe për më shumë e thyen principin e deklaruar edhe po në këtë ligj, pra në nenin 2, pika 1.2, që flet për barazinë para ligjit për gjithë bartësit e arsimit të lartë.

Për pozitën e ligjëruesit duhet të kërkohet magjistraturë shkencore për së paku një vit të studimeve të doktoraturës dhe tri vjet përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë, ose titullin e masterit, së paku dy vjet, pra 4 semestra të përfunduara të studimeve të doktoraturës dhe së paku 3 vjet përvojë pune në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë.

Ligji duhet të bëjë dallimin në mes dy llojeve të studimeve, atyre profesionale dhe atyre shkencore, duke marrë për model pra, për shembull skemën e studimeve nga Republika e Kroacisë.

Në ligj duhet të precizohen kriteret e qarta kur mundet një bartës jo publik ose publik të organizojë studime shkencore profesionale. Ligji nuk duhet të shërbehet me nocionin “shkollim”, por “studim”.

Duhet të vendosen kriteret sa më rigorozë, që do t’u pamundësonin bartësve privatë të përfshihen si OJQ, sepse mund të jetë paravan për shmangien e tatimeve, gëzimin e privilegjeve, e tjerë, krejt me qëllim që të nxjerrin përfitimet edhe më të mëdha se sa të ishin të definuar si bartës privatë.

Shkurtesat, akronimet, e tjerë duhet të përdoren në mënyrë konsistente, për shembull, ndryshimet e bëra tek arsimit i lartë, në AL. Megjithatë, ndoshta më mirë është pra të lehet arsimit i lartë, se sa të përdoret shkurtesa AL. Mirëpo, forma për të cilën vendoset duhet të përdoret edhe në mënyrë konsistente.

Megjithatë, më lejoni, për të mos ju humbur shumë kohë edhe deputetëve, të përmend vetëm nenin 39 tek dispozitat kalimtare, ministri e tha që nuk ka do të thotë, kosto shtesë buxhetore. Unë po e përmend që në nenin 39 te dispozitat kalimtare janë 8 nene me disa paragrafë, të cilat në fund thuhet: “Mund të hyjë në fuqi nga viti akademik 2015/ 2016, po qe se krijohen kushte financiare dhe pas një vlerësimi ekzakt të koston financiare të periudhës vijuese”.

Më lejoni të përmend vetëm disa anomali, që ne i kemi hasur. Tek neni 2, tek parimet, paragrafi 1.3, që është në dispozitën kalimtare, pra që e përmenda pak më herët, thotë: “Mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë, pa diskriminim,” çka nënkupton, le të ma thotë dikush, se në qoftë se ky paragraf hyn në fuqi në vitin akademik 2015/16 dhe po qe se ka buxhet, do të thotë në këtë periudhë nuk do të ketë mundësi të barabarta. Pra, thjeshtë do të ketë diskriminim. Kështu është e paraparë në këtë paragraf.

Për të vazhduar tek, prapë po i përmend të gjitha këto që po i përmend janë në dispozitat kalimtare, pra që e përmenda më herët, tek neni katër, gjithashtu objektivat dhe organizimi i arsimit të lartë.

Paragrafi 1.3, ofrimi i mundësive për të gjithë banorët e Kosovës, që janë të aftë për të përfituar nga ky arsimim dhe për t’i kontribuar shoqërisë dhe vendit të tyre gjatë gjithë jetës. Edhe kjo pra, në qoftë se ka kosto shtesë, u morëm vesh kur pas vitit akademik 2015/16 apo nëse bëhet një analizë me e thukhtë financiare.

Gjithashtu, tek neni që është prapë në dispozitën kalimtare, më duhet ta përmend te neni 6, paragrafi 1.9. promovimin e lidhjeve midis bartësve publikë të arsimit të lartë në Kosovë, bartësve privatë të arsimit dhe aftësisë, industrisë dhe tregtisë, si dhe inkurajimin e zhvillimit të ndërmarrësisë.

Po e përmend edhe një çështje, se janë shumë të tjera, por po e përmend pikën 1.11, licencimin e bartësve të arsimit të lartë.

Nuk e di ministër se çka nënkupton kjo pikë, pra ky paragraf, që të hyri në dispozitat kalimtare, a nënkupton kjo që nuk duhet të bëhet licencimi deri pra, në atë periudhën kur e përmende më herët.

Më duhet me përmend, që nga periudha 2008-2012 nuk ka pasur asnjë licencë. Më duket, në mos gabofsha, në 2013 janë disa, por nuk e di pse me qenë kjo në dispozitat kalimtare.

Pastaj, është pika 1.12, sigurimin e ndihmesës në përputhje me këtë ligj për bartësit e akredituar të arsimit të lartë dhe studentëve të regjistruar aty. Gjithsesi edhe kjo në dispozitën kalimtare pra, në periudhën që përmenda më herët.

Tek neni 7, gjithashtu është te përgjegjësitë e Agjencisë për Akreditim, që është dashur më mirë me raportua nga monitorimi i ligjit, por megjithatë, po e përmend edhe këtu. Prapë edhe kjo në dispozitën kalimtare, thotë pika 2.3, “Kryerjen e kontrolleve” pra, “tek përgjegjësitë e Agjencisë”, “kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditim apo riakreditimin e tyre, duke përfshirë të drejtën për dhënien e titujve dhe diplomave”.

Mos të harrojmë, se Agjencia asnjëherë nuk i ka raportuar Kuvendit, çka e ka do të thotë, e ka me ligj obligim. Asnjëherë kjo agjenci edhe pse do ta diskutoj në monitorimin, pra në raportin e monitorimit më në detaje.

Tek pika 4, ku është përbërja e këtij këshilli, po ndalem në një pjesë, kah fundi atje, thotë: “anëtarët,” pra, “anëtarët që janë ekspertë ndërkombëtarë, nuk duhet të jenë të punësuar” thotë: “nga asnjë bartës i arsimit të lartë në Kosovë”, çka nënkupton që anëtarët tjerë që janë në këtë Agjenci mund të jenë.

Unë konsideroj, që të gjithë anëtarët e kësaj agjencie, përfshirë këtu edhe zotin Hamiti, përfshirë kryetarin e zonjën Fetije Zhushi, pastaj edhe anëtarët tjerë, janë të gjithë anëtarë të këtij Këshilli njëkohësisht që të gjithë punojnë edhe në institucione të arsimit të lartë, pra në njësitë akademike, çka unë nuk e kam të qartë, a mundet që një anëtar ose një grup anëtarësh, që janë 4 apo 5, të cilët punojnë dhe i akreditojnë programet, të cilat i ligjërojnë vetë. Unë nuk e kam të qartë, këtu ndoshta është mirë të ma sqaroj ministri.

Pra, me një fjalë, tek neni që është gjithashtu tek parimet kryesore të financimit të bartësve të arsimit të lartë, thotë prapë dispozitë kalimtare, në pikën 1.2. “Pagesa për shkollimin dhe pagesa të tjera që bëjnë studentët”.

Gjithashtu, për të mos i mashtruar studentët, kjo në këtë ligj është si dispozitë kalimtare, u morëm vesh, mos ta përsëris, në periudhën kur e përmenda pra, në qoftë se ka buxhet, pas vitit akademik 2015/16.

Megjithatë, edhe shumë vërejtje të tjera, ne prapë do ta japim kontributin tonë në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Problemet që ishin paraqitur pra, në kohën e fundit në Universitetin e Prishtinës paraqitën nevojën për ndryshime ligjore, sa i përket Projektligjit për të evidentuar lëshimet, por edhe për të avancuar dispozitat ligjore, sa i përket rregullimit të kësaj fushe.

Në këtë projektligj, të cilin po e trajtojmë tani, janë bërë disa përmirësime, por mendoj se ligji ka nevojë edhe për disa ndryshime të tjera, të cilat do t'i shqyrtojmë në Komisionin Funksional.

Unë nuk do të ndalem shumë për të marrë kohë, sepse shumë vërejtje u përmendën edhe nga kolegët deputetë, mirëpo do të ndalem në pikën e projektligjit, konkretisht te neni 2, tek parimet ku pika 1.2, thotë se barazia para ligjit për të gjithë bartësit e arsimit të lartë. Dhe, mendoj se në nenin 10.2 nuk kemi harmoni me nenin, pra konkretisht me pikën 1.2 të po këtij neni, tek kapitulli pra tek parimet.

Konsideroj, që në tregun e edukimit nuk ka një konkurrencë fer, e cila do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe avancimin e nivelit të arsimit, sa i përket sektorit publik dhe privat. Sektori privat është ballafaquar me shumë vështirësi, sa i përket dispozitave ligjore të ligjit të kaluar dhe mendoj, se dallimet në emërimin “kolegj” dhe “universitet”, atyre u ka shkaktuar shumë vështirësi. Marrja apo mosmarrja e emërimit universitet, ka bërë që të jenë në një pozicion jo konkurrues në krahasim me universitetet publike në vend, por edhe të atyre të rajonit, për shkak të perceptimeve të opinionit.

Unë mendoj që shumë nga vërejtjet të cilat u përmendën nga kolegët deputetë, duhet t'i ketë parasysh Komisioni Funksional, duke filluar nga Këshilli Drejtues, por edhe te dispozitat kalimtare, por edhe të vërejtjet tjera.

Unë tani nuk do ta zgjas më shumë, por se kontributin tonë konkret do ta japim në Komisionin Funksional, duke prurë edhe amendamente konkrete për ta avancuar sa më shumë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

MUFERA SHINIK: Teşekkür ederim

Yüksek eğitim yasa tasarısını görüşüldüğünde var olan yüksek eğitim yasasının ekleme ve tamamlamalarında daha fazla çalışılması gerektiği ortaya çıkmaktadır. Yasa Tasarısının Kosovadaki yüksek öğrenimin Avrupa standartlarına ve Avrupa Yüksek

Eğitim Kurumlarıyla işbirliği olanağının daha iyi yapılabilmesi için olanak sağlayacağı görülmektedir. Ancak Yasa tasarısının 6. maddesinin 1.6 paragrafındaki resmi dillerin belirtildiği şekiline itirazımız vardır. Üniversite kurumlarında eğitim dillerinde farklı olduğu ve eğitim dilleri arasında Türkçenin de olduğunu unutmamak gerek. Çünkü burada üniversite kurumlarında eğitim dilleri dendiğinde sadece resmi diller diye geçmektedir. Bundandır resmi dilelir yerine eğitim dillerinin yazılması gerekmektedir. Bunu da Komisyonda sunacağımız katkılarla değiştirmeye çalışacağız.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit, Fjalën e ka kërkuar zoti kryeministër, Hashim Thaçi. Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues Haliti!

Përsëri po dal që përkundër dëshirës sime të bëj një sqarim në raport me qytetarët e Kosovës, ndaj pretendimit dezinformues të ish-ministrit Ferati dhe deputetit që foli në emër të LDK-së, zotit Sadri Ferati.

Unë nuk e kuptoj, në mënyrën më të shqetësuese të mundshme, megjithëse do të kisha pasur dëshirë që të jetë këtu zoti Ferati, por është me siguri zoti Hamiti, zoti Kryeziu e të tjerë, që mund të kyçen në debatin apo në qartësimet, nëse s'jemi kuptuar drejt.

E para, unë mendoj se në asnjë rrethanë, as zoti Sadri Ferati, deputeti i nderuar, e as vetë Lidhja Demokratike e Kosovës, nuk duhet të jetë e shqetësuar në shqetësimin që po prezanton vazhdimisht, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë, por sot që e diskutoi se a ka të drejtë kryeministri apo jo për vendimin që ka marrë për rritjen e pagave për punëtorët e arsimit?

Unë dëshiroj edhe njëherë të qartësoj, se rritja e pagave për 30 mijë punëtorët e arsimit, tash po i përmend vetëm këto, do të ndodhë nga 1 maji i këtij viti. Pra, për të gjitha kategoritë, edhe për punëtorët universitarë, edhe për punëtorët e shkollave të mesme, fillore, duke përfshirë edhe Akademinë e Shkencave dhe të gjitha institutet shkencore.

Prandaj, edhe njëherë vetëm desha ta sqaroj zotit Ferati dhe Lidhjen Demokratike në pozicionimin e tyre, që kanë marrë kundër këtij qëndrimi dhe vendimi të Qeverisë së Kosovës, që vazhdimisht publikisht pretendojnë për ta kontestuar.

Pra, këtë vendim nuk do të mund ta kontestojë askush. Është vendim që do të implementohet për të gjitha kategoritë, por edhe për mësimdhënësit e të gjitha kategorive, rritja për 25% nga 1 maji i këtij viti. Pra, nuk është premtim, është vendim.

Në anën tjetër, s'e kuptoj përsëri qëndrimin kundër edhe nënshkrimit të Kontratës Kolektive të Qeverisë së Kosovës me punëtorët kosovarë. Janë plotësisht qëndrime të pakuptueshme. Edhe punëtorët nuk janë të një partie. Unë mendoj se keni kapacitet për të ndihmuar për ta implementuar sa më shpejt këtë kontratë kolektive.

Gjithashtu, u përmend nga zoti Ferati edhe çështja se po merr kryeministri vendim edhe për rritjen e pagave edhe në KEK. Po, është e vërtetë, unë kam propozuar dhe e falënderoj menaxhmentin e Korporatës Energjetike që ka marrë vendim për rritjen e pagave për të gjithë punëtorët e Korporatës Energjetike për 120 euro.

Dhe, dëshiroj t'ju konfirmoj se të gjithë punëtorët e KEK-ut, të Korporatës Energjetike të Kosovës, mbi 5 mijë, me rritje prej 120 eurosh për pagat e tyre do t'i marrin jo më larg se data 15 prill. E ritheksoj 15 prill, do të thotë janë një pesë-gjashtë ditë. Nëse nuk besoni, mund të shkoni, t'i verifikoni, t'i vizitoni ndonjëherë, por jo me marrë pozicionim kështu kundër.

Gjithashtu e ritheksoj edhe një herë, edhe dilemat sa i përket punëtorëve të Fabrikës së Tubave edhe ajo punë është e kryer dhe atë dilemë dhe atë kontestim hiqeni nga mendja.

Ndërsa, gjithashtu ajo çka më erdhi më së keqi dhe u ndjeva keq për vetë Sadriun, është pozicionimi i tij apo pretendimi i kontestimit për rritjen e pagave për minatorët dhe që punojnë dhe pensionistët minatorë.

Mendoj se edhe ky pozicionim është jo i drejtë, i paqëndrueshëm, jo parimor, në veçanti kur ai vetë vjen prej asaj treve të Shalës dhe të Mitrovicës.

Mirë de, po edhe kundër ligjit për veteranë keni qenë dhe unë s'po ju them që jeni, unë s'po them që jeni, vetë keni votuar kundër, keni dalë, s'keni votuar për. Urdhëroni, faktet janë kush ka votuar për kush kundër, ju keni dalë nga salla për Ligjin për veteranët.

OK. Është e drejtë demokratike, është e drejtë demokratike e juaja, keni votuar kundër veteranëve, OK.

Ndërsa sa i përket studentëve, unë ua dhashë përgjigjen më herët, edhe juve edhe të tjerëve, ajo punë është e kryer edhe për studentë, edhe për profesorë, edhe për pagesa, edhe për konvikte, edhe për mensë, edhe për bursa, edhe për brucoshë në shkollimin gratis. Vetëm desha t'ju qartësoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Radha është e deputetëve, ose e diskutuesve....

(Ndërhyrje)

Ju keni të drejtë në replikë, në qoftë se dëshiron dikush, zonja Bajrami e ka fjalën për replikë, paraqituni për replikë, unë nuk mund t'ia imponoj askujt fjalët që i thotë në sallë. Zonja Bajrami e ka fjalën për replikë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht ju bëj vërejtje. Jemi në një pikë të rendit të ditës ku po diskutojmë Ligjin për arsimin e lartë. Ajo çka foli kryeministri aspak nuk ka të bëjë me këtë pikë të rendit të ditës, asnjë fjalë e kryeministrit nuk lidhet me fjalimin e Sadri Feratit. Po mundohet

sigurisht që ta hedhë komplet në kontekst tjetër, por nuk mundet, LDK-ja asnjëherë nuk ka qenë kundër rritjes së pagave.

Ne kemi kërkuar rritje prej 43%, kemi kërkuar rritje të pagave çdo vit dhe jo rritje të pagave në kohë fushate. Asnjëherë nuk kemi qenë, ndërsa ai duhet të përgjigjet në pyetjet konkrete. Ne tani po e diskutojmë Ligjin për arsimin e lartë, ju lutem shumë, Kuvendi i Kosovës është i 120 deputetëve që janë përfaqësues të popullit dhe nuk është i Partisë Demokratike të Kosovës.

Mund të shkoni kryeministër në selinë e PDK-së dhe të bëni një fushatë të tillë, por jo assesi në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Kam përshtypjen se duhet me ia përsëritur edhe ato që i ka thënë Sadria, që ta kuptoni edhe më drejt.

Ndërsa rreth asaj se kjo shyqyr që është fat që kemi Parlamentin dhe mund të flasim, mund të shprehemi lirë. Parlamenti është i deputetëve, është i Qeverisë, Qeveria jep llogari në Parlament dhe natyrisht lexo Kushtetutën dhe ligjin dhe Rregulloren e Kuvendit, bile, bile zoti Haliti e bëri një shkelje të Rregullores se s'iu përmend emri hiç Hykmetes, se ju e dini që në këtë debat të zhurmshëm me ju nuk e parapëlqej fort, por si do që të jetë edhe sa i përket qëndrimit tuaj që e ke për studentë, duhet të bëj një sqarim, këtu.

Studentët tjerë nuk i kanë paret që i kanë fëmijët e juaj këtu që i keni 5 – 6 rroga disa prej juve. Dhe duhet pasur parasysh këtë, prandaj ke mirëkuptim.

Sa i përket qëndrimit të LDK-së për rroga, ju e dini çfarë zotimi keni pasur gjithmonë, 8 vjet e keni udhëhequr këtë vend, i keni rritur për 7 euro rrogat. Vetëm aq, 8 vjet qeverisje i keni fituar zgjedhjet se e keni dorëzuar pushtetin... por 8 vjet keni qeverisur, keni qenë partia numër 1, i keni rritur rrogat 7 euro.

Ky është realiteti i partisë tuaj, Hykmete që ke ardhur vonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arsim Bajrami. Unë nuk e di, ne kemi gabuar që bëmë zhurmë për rritjen e rrogave të deputetëve, mbetën pa rroga.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Fillimisht mendoj se ardhja në diskutim e këtij ligji është një moment i rëndësishëm në Kuvendin e Kosovës, sepse kemi një rast të mirë për ta shikuar ligjin ekzistues dhe për të avancuar legjislacionin në sferën e arsimit të lartë.

Unë do të ndalem në disa momente, është leximi i parë, në disa momente që mund të jenë bazë për amendamentim gjatë leximit të dytë. Momenti i parë, definimi i mirë i interesit publik në sferën e arsimit të lartë dhe mendoj që ligji ka një bazë të mirë me të cilën

mbrohet interesi shtetëror apo interesi publik në sferën e arsimit të lartë dhe në këtë drejtim është në pajtim plotësisht edhe me trendët evropiane sa i përket arsimit të lartë.

Çështja e dytë, ligji ka legalizuar do të thosha decentralizimin e arsimit të lartë me vetë faktin që kemi themeluar disa bartës të arsimit të lartë, por ky proces i decentralizimit duhet të shkojë edhe brendapërbrenda bartësve të arsimit të lartë, duhet të jetë një parim i organizimit të bartësve privat apo universiteteve të arsimit të lartë në mënyrë që decentralizimi të mundësojë një vetëqeverisje të institucioneve të arsimit të lartë.

Ajo çka ne duhet të definojmë dhe që fatkeqësisht ligji s'i ka definuar krejtësisht, është definimi i qartë i autonomisë së bartësve të arsimit të lartë.

Është e vërtet se ligji promovon parimin e autonomisë akademike, por ne duhet të punojmë edhe më tepër për të promovuar edhe autonominë e plotë qeverisëse dhe autonominë financiare të bartësve të arsimit të lartë, sepse mendoj që ky është një trend, një trend për t'i bërë shumë më përgjegjëse institucionet e arsimit të lartë.

I nderuar ministër, një çështje që duhet të fokusohemi në leximin e dytë është çështja e mobilitetit, çështja e mobilitetit që është një nga parimet e sistemit të Bolonjës. Ligji nisat nga parimi i mobilitetit, por ne duhet të krijojmë mekanizma ligjorë që ky mobilitet brenda hapësirës kombëtare të jetë plotësisht i liberalizuar, gjithashtu edhe mobiliteti në aspektin e transferit të kredive në aspektin ndërkombëtar.

Janë bërë hapa të rëndësishëm me akte nënligjore që ka miratuar Ministria, por mendoj që parimi i mobilitetit të titujve, të programeve të akredituara, të studentëve, të stafit akademik duhet me qenë parim bazë i liberalizimit të zonës së arsimit të lartë.

Një çështje që fatkeqësisht ligji nuk e ka definuar, ka mbetur pezull, edhe përkundër debateve që kemi pasur para dy-tre muajve, ka mbetur çështja e balancës apo e ekuilibrit midis interesit shtetëror, interesit qeveritar, interesit publik në proceset e zgjedhjes, në proceset e emërimeve në arsimin e lartë. Dhe, unë kam vërejtje serioze në këtë drejtim, sepse sinqerisht kam pritur zgjidhje shumë më të thella, shumë më substanciale në raportet e brendshme, përkatësisht në raportet midis Këshillit drejtues si autoritet siç e quan ligji qeverisë dhe rektorit, përkatësisht dekanëve si autoritete menaxhuese.

Mendoj se këto gjëra duhet t'i rishikojmë, personalisht do të përgatis një pako të amendamenteve për t'i propozuar Parlamentit një rishikim më substancial, jo vetëm formal, sepse të gjithë jemi pajtuar në konkluzionet që i kemi miratuar me rastin e diskutimeve të mëhershme që neve na duhet një rishikim, sepse përvoja e zgjedhjes së rektorit dhe dekanëve përmes Këshillit drejtues është një përvojë e dështuar, është një përvojë që ne duhet ta braktisim dhe duhet të rikthehem te modeli që rektori, dekanët duhet të zgjidhen plotësisht me mekanizma të brendshëm të Universitetit. Ka disa mundësi, është mundësia që të bëhen përmes këshillave të fakultetit dhe përfundimisht senatit, ose edhe mundësia e zgjedhjes së drejtpërdrejtë të rektorit që aplikohet në Republikën e Shqipërisë dhe që është një model jashtëzakonisht i mirë.

Mendoj se në këtë drejtim ligji s'ka bërë asgjë, përkundrazi do të thosha ka mbetur në kornizat e vjetra, sepse tani e keni një dispozitë ku thuhet se rektori para se të zgjidhet duhet të intervistohet para Këshillit drejtues, thuaja se rektori do të jetë një nëpunës i Këshillit drejtues dhe plotësisht duhet t'i rregullojmë balancat dhe ekuilibrat tjerë midis Këshillit drejtues dhe rektorit. Këshilli drejtues duhet të kthehet në një organ konsultativ, në një organ që më tepër do të merret me sjelljen e donacioneve Universitetit, jo një organ që bën politika ditore në Universitet, sepse problemet nga paslufta vijnë pikërisht për shkak të kësaj balance jo të mirë ndërmjet Këshillit Drejtues dhe rektorit dhe ne në këtë drejtim e kemi rastin e mirë që të sigurojmë stabilitet afatgjatë Universitetit duke rregulluar qartazi kompetencat e Këshillit drejtues si një organ do të thosha mbështetës i Universitetit, i rektorit.

Rektori është autoriteti qeverisës dhe autoriteti menaxhues, një organ i cili do të kujdeset për fondet, do të kujdeset për zhvillimin strategjik të Universitetit, por jo një organ i cili për çdo ditë bie vendime, bie vendime edhe sa i përket qeverisjes, por shpeshherë edhe sa u përket aspekteve akademike dhe ne nuk duhet të na mjaftojë vetëm një amendament, por disa amendamente. Dhe, unë ftoj të gjithë profesorët e Universitetit që janë deputetë, sidomos ata që kanë një përvojë më të gjatë të punës që të jenë më aktivë te ky ligj, sepse të gjithë kemi obligim që të kontribuojmë në përmirësimin e dukshëm të kornizës ligjore të këtij ligji.

Gjithashtu ne duhet t'ia rikthejmë autonominë fakulteteve. Unë e di që UP është një personalitet unik juridik, unë e di që trendi ligjor është ky që Universiteti i Prishtinës është tërësi unike, por rikthimi i autoritetit të fakulteteve veç çka do ta forcojë UP-në dhe karakterin akademik të Universitetit. Dhe, mendoj se ne duhet të rikthejmë të drejtën e gjithë stafit akademik që ata ta zgjedhin dekanin. Dekani mos të vjen gjithmonë si rezultat i mbivotimeve jo parimore që bëhen nganjëherë në institucione dhe sidomos unë mendoj se duhet ta zhveshim plotësisht Këshillin drejtues nga kompetencat për të zgjedhur dhe për të shkarkuar udhëheqës të universiteteve.

Gjithashtu mendoj se duhet ta ndërrojmë substancialisht strukturën dhe konceptin e Këshillit drejtues. Personalisht mendoj se njerëzit që do të zgjedhën në Këshill drejtues duhet të jenë personalitete me autoritet të pakontestueshëm publik, njohës të shkëlqyeshëm të aspekteve financiare, menaxheriale, njohës të shkëlqyeshëm të zonës së arsimit të lartë, jo njerëz të thjeshtë, jo njerëz të pa përvojë, jo njerëz që ndoshta punën e parë e kanë pikërisht të qenët në bord, nëse mund të eksperimentojnë me borde tjera, nuk lejohet të eksperimentohet me këtë këshill drejtues, sepse ky këshill drejtues prek interesat e 100 mijë studentëve dhe afër 3-4 mijë punonjësve të Universitetit, kështu që të kthehemi te praktikat e mira. Kemi edhe në rajon praktika të mira, ministri e din shumë mirë një Universitet i Evropës Juglindore, që ka qenë një donacion evropian në Tetovë, ku Këshilli drejtues ka sjell fonde, nuk është marrë me zgjedhje të rektorëve dhe dekanëve, por ka sjell fonde dhe ka ndërtuar një kampus të shkëlqyeshëm. Ne duhet të kthehemi te këto praktika të mira në mënyrë që vërtet Universiteti të ketë autonominë e vet, të ketë cilësinë akademike dhe t'i rikthehet misionit primar.

Më lejoni të ndalem pak te një çështje, çështja e kriterëve, çështja e punimeve, çështja e rizgjedhjeve, e keqpërdorimit të pozitës për t'u rizgjedhur. Unë mendoj se ne duhet t'i ashpërsojmë kriteret për zgjedhje akademike, duhet t'i rikthejmë zgjidhjet e mëparshme siç kanë bërë problem që për rektor, për dekan duhet të jetë profesor i kryer, jo profesori që duhet të shkollohet hala, jo profesori që duhet të bëjë punime. Duhet të jenë profesorë të pjekur, profesorë me thirrje të profesorit inordinar, në mënyrë që ata mos të kenë asnjë konflikt interesi gjatë udhëheqjes së fakultetit apo universitetit, mos të detyrohen të bëjnë punime ndoshta edhe të kontestuara, t'i rikthehemi domethënë këtij koncepti që dekanët dhe rektorët duhet me qenë profesorë të kompletuar, me karrierë complete akademike në mënyrë që ata gjatë kohës sa janë menaxherë dhe udhëheqës të merren me qeverisje e jo të merren edhe me agjendat e veta akademike, ngritje apo avancime në thirrje që shpeshherë edhe mund të kontestohen.

Së fundi, unë angazhohem që rreth këtij ligji vërtet të ndihmojmë edhe Ministrinë edhe Komisionin për Arsim, të fokusohemi pak më tepër dhe të bëjmë përpjekje të bëjmë një reformë më të thellë legjislative në mënyrë që miratimi i këtij ligji njëkohësisht të jetë edhe një moment shumë i rëndësishëm për stabilizimin e zonës së arsimit të lartë, për shkak se stabilizimi i bartësve të arsimit të lartë është një kusht shumë i rëndësishëm edhe për integritet tona brenda procesit të Bolonjës i cili për shkak të pengesave politike, për shkak të problemeve juridike që kemi në praktikisht ende nuk ka mundur të përfshirjen e Kosovës në zonën e arsimit të lartë.

Kështu që unë pres që në leximin e dytë jo vetëm Parlamenti, por edhe ndoshta gjatë dëgjimit publik që do të organizohet te Komisioni për Arsim, të kemi një debat substancial dhe të provojmë të bëjmë vërtet një reformë rrënjësore, sepse ashtu siç është propozuar ligji, nuk është një reformë e premtuar dhe një reformë e pritur. Pres që vërtet përmes amendamentimit ne të bëjmë një ligj të mirë për arsimin e lartë, ligj i cili edhe do të promovojë konkurrencën, lirinë akademike po njëkohësisht do të mundësojë stabilitetin akademik të bartësve të arsimit të lartë që është shumë i rëndësishëm për stabilitetin e përgjithshëm të rrjedhave në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Albert Kinolli.)

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar koleg! Më lejoni pasi që jam për herë të parë në cilësinë e kryesuesit t'ju përshëndes të gjithëve.

Tani për fjalë është lajmëruar deputeti Haki Demolli, nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Urdhëroni, koleg i nderuar.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sot para vetes kemi Draftligjin për arsimin e lartë, të cilin e ka sjellë Qeveria si pasojë e zhvillimeve të kohëve të fundit në Universitetin e Prishtinës, që u përcollën me afëra korruptive, protesta të studentëve dhe debatin që në këtë Kuvend, me iniciativën e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbajtëm.

Mirëpo, kur analizohet ky draftligj dhe krahasohet me ligjin në fuqi, atëherë shihet se në esencë nuk ka ndryshime të mëdha dhe nuk përmban ndryshimet e duhura që do të ndryshonin gjendjen në arsimin e lartë konform rekomandimeve të aprovuara pas debatit në Kuvend.

Për këtë arsye vlerësoj se ky dokument nuk është dashur të konsiderohet si draftligj i ri për arsimin e lartë, por si draftligj me të cilin ndryshohet dhe plotësohet në mënyrë kozmetike ligji në fuqi, që domethënë një draftligj siç thotë populli sa për sy e faqe, apo për t'i hedhur hi syve opinionit të gjerë, e sidomos studentëve dhe intelektualëve se kinse kjo Qeveri po reagon ndaj kërkesave të tyre për arsimin e lartë duke i inkorporuar ato në formë të dispozitave ligjore.

Më tutje, dua të them se as që kam pritur ndonjë ligj më cilësor për arsimin e lartë nga Qeveria e cila arsimin e lartë e ka shndërruar në një monedhë të kusuritjeve për nevoja dhe interesa politike, nga një Qeveri e cila themelon dhe hap universitete duke cenuar ligjet në fuqi e cila themelimin e tyre e bën vetëm për votë politike e jo si një veprim të ndonjë plani strategjik për ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Përndryshe, është notore se cilësia e këtij arsimi dita ditës është duke u rrënuar, kurse gradat dhe diplomat e tij janë duke u bërë të krahasueshme me dëftesat dhe diplomat e shkollave të mesme dhe të ashtuquajturave "shkolla të natës" të viteve 70-80 të shekullit të kaluar.

Me veprime të këtilla universitetet e reja publike janë shndërruar në strehimore të militantëve të Partisë politike në pushtet, ndërsa institucionet private të arsimit të lartë në biznese për prodhimin e certifikatave dhe diplomave universitare.

Për këto arsye sot kemi shumë institucione të tilla ku angazhohet personeli jo kompetent dhe jo profesional, ku mungojnë kushtet elementare për studim të mirëfilltë bashkëkohor, ku regjistrimi i studentëve bëhet pa kriteret përkatëse, ku cilësia e studimit dhe notimit është nën çdo nivel të mundshëm akademiko shkencor, ku qëllim i vetëm të atyre që kinse studiojnë është që për një kohë sa më të shkurtër të sigurojnë dhe të pajisen me një diplomë të bachelor-it për të vazhduar pa pushuar fare me ritëm të tillë në studime të nivelit të masterit e pse jo edhe të doktoraturës.

Gjendja e krijuar në arsimin e lartë lirisht mund të thuhet se ne si shoqëri për këto vite të fundit ia kemi dalë që seriozisht ta dëmtojmë për të mos thënë rrënojmë një shtyllë të rëndësishme të veprimtarisë shoqërore që quhet arsimi i lartë, duke krijuar infrastrukturë ligjore dhe kushte për studim që siç thotë populli "me rënie të lirë", të cilat jo rrallë po shfrytëzohen edhe nga personat e jetës publike dhe politike dhe familjarët e tyre duke u bërë brenda natës jo vetëm doktorë të shkencave, por edhe profesorë dhe menaxhues të fakulteteve dhe universiteteve që po funksionojnë sipas draftligjeve të kësaj natyre.

Përveç dobësive dhe lëshimeve të lartë theksuara fatkeqësisht opinionin ynë i gjerë e ka parë se arsimi i lartë është i përcjell edhe me dukurinë e korrupsionit dhe dukuri të tjera devijante të cilat janë të theksuara sidomos gjatë pranimit dhe regjistrimit të studentëve si

dhe gjatë vlerësimit të tyre, që deri më tani përgjegjësit kryesorë të këtyre veprimeve nuk janë ndëshkuar, por vetëm disa asistentë dhe ndërmjetësues të tyre.

Sa i përket këtij draftligji unë do të theksoja se disa prej vërejtjeve që i kam në dispozitat, respektivisht nenet konkrete. Kështu në nenin 9, pika 1, respektivisht nenit 3, paragrafi 1, pika 14 thuhet se bartësit publik të arsimit të lartë themelohen me vendim të Ministrisë i cili duhet të aprovohet nga Kuvendi.

Pasur parasysh lojërat politike që mund t'i bëjnë qeveritë përmes themelimit dhe mbylljes së këtyre institucioneve, mendoj se vendimi mbi themelimin e tyre duhet të jetë kompetencë vetëm e Kuvendit dhe askujt tjetër.

Më tutje në nenin 6. paragrafi 1 pikë 2, si kompetencë e Ministrisë konsiderohet edhe miratimi i statuteve të bartësve publikë të arsimit të lartë, e cila sipas mendimit tim duhet të jetë kompetencë e Kuvendit.

Një kompetencë tjetër e Ministrisë sipas këtij drafti është krijimi i Këshillit shtetëror por arsimin e lartë, që do ta këshillonte ministrin. Unë mendoj se ministri ka mjaft këshilltarë andaj nuk ka nevojë për një këshill të tillë dhe duplikim të këshilltarëve.

Po ashtu edhe kompetenca e Ministrisë që të ndërmarrë veprime për menaxhimin e situatave që pengojnë dhe rrezikojnë funksionalitetin e institucioneve, më duket si kompetencë problematike, me të cilën mund të cenohet autonomia e Universitetit, andaj duhet shikuar mirë ky propozim, kurse zgjedhja duhet gjetur brenda vetë universiteteve.

Te neni 10 kur flitet për emërtimin universitet dhe koleg universitar si kriter merret ofrimi i studimeve të doktoratës, në së paku tri fusha studimi. Vlerësoj se një kriter i tillë nuk është përmbushur nga të gjitha universitetet e reja publike që tregojnë për lojërat dhe manipulimet e kësaj Qeverie me arsimin e lartë në Kosovë.

Po ashtu, në këtë nen, apo edhe diku tjetër në ligj duhet paraparë sanksionet për institucionet që në mënyrë të kundërligjshme përdorin emrin universitet dhe koleg universitar.

Mjaft diskutabil është edhe neni 11, paragrafi 2 ku thuhet se kompanitë private, fondacionet dhe trustet mund të themelojnë institucione të arsimit të lartë. Mendoj se duhet një herë të analizohet gjendja dhe numri i këtyre institucioneve, i cili sipas mendimit tim edhe ashtu është tejte i lartë, e pastaj të inkorporohet një dispozitë e tillë në ligj.

Të diskutueshme për mua janë edhe paragrafët 1, 3 dhe 4 të nenit 16, ku në të parin thuhet se për çështjen e dokumenteve, të gradave dhe diplomave, rregullohet me udhëzimin administrativ, kurse unë mendoj se çështjet e tilla për shkak të rëndësisë dhe mundësisë së keqpërdorimit, duhet rregulluar me ligj.

Kurse, në paragrafët 3, 4 të nenit 16, përcaktohet që studimet për kualifikim për mësimdhënës të kenë vetëm bartësit publik e jo edhe ata privatë, gjë që mendoj se është dispozitë diskriminuese ndaj institucioneve private.

Neni 17, paragrafi 1 që trajton statutet e bartëseve publike të arsimit të lartë duhet të rishqyrtohet dhe harmonizohet, ashtu që miratimi i tyre të bëhet nga Kuvendi pa ndërhyrje të Ministrisë.

Vërejtja ime tjetër ka të bëjë me këshillat drejtues të bartësve publikë, sepse rregullimi i paraparë në nenin 18 nuk dallon esencialisht nga ai i paraparë me ligjin në fuqi, andaj propozoj që kjo çështje të shqyrtohet edhe një herë, që këto këshilla ose të fshihen fare ose anëtarët e saj të jenë nga vetë Universiteti e jo siç parashihet me paragrafin 2 që të jenë nga radhët jashtë universitetit e pastaj ata të shfrytëzojnë pozitën në këshill për të magjistruar, doktoruar, apo edhe për t'u angazhuar si personel në Universitet.

Edhe në nenin 19 paragrafi 1 duhet ndryshuar, ashtu që rektori të zgjidhet nga personeli i njësive apo nga këshillat e njësive akademike apo fakulteteve e jo nga Këshilli Drejtues, sepse përvojat kanë treguar se zgjedhja e këtillë e rektorit po politizohet skajshmërisht, andaj mirë është që njësive akademike t'u jepet mundësia që t'i zgjedhin menaxherët që i dëshirojnë vetë, e jo rektori dhe dekanët t'ua zgjedhin ata që nuk janë pjesë e Universitetit.

Vërejtje serioze kam edhe për nenin 26 ku trajtohen titujt dhe gradat e personelit. Zgjedhjet e ofruara në paragrafin 2, 3 të nenit 26, krijojnë një laramani sa u përket titujve akademikë në universitete dhe kolegje, sepse me të lejohej që personeli madje edhe me diplomë masteri në disa institucione të emërtohet profesor, andaj propozoj që ky nen të shqyrtohet edhe një herë dhe të precizohen saktësisht kriteret për titujt e profesorëve ligjërues dhe asistentëve.

Paragrafi 3.4, theksohet se bartësi publik ka të drejtë për t'ia propozuar ministrisë taksat, tarifën dhe gjatësinë për miratim.

Kjo dispozitë zbulon lojërat që Qeveria po i bën me taksat për studentë, vetëm sa për t'i joshur për votë dhe atë duke i shkelur dispozitat ligjore që i propozon vetë dhe i aprovon ky Kuvend.

Në fund, do të propozoja që me këtë ligj të rregullohet edhe çështja e studimit të personelit administrativ dhe angazhimit të tyre si personel akademik.

Mirë është që të definohet se a mund që në të njëjtën kohë të jenë personel administrativ, studentë dhe mësimdhënës në universitetet tona publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar koleg deputet! Ndërsa tani, sipas radhës, fjalën e ka zonja Donika Kadaj-Bujupi nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kryeministri shkoi se desha ta pyes atë ditë kur me kamera në shpinë u nis për në mensën e studentëve t'i kallëzojë krejt popullit që do të hajë fasule ose gullash, s'po di, tash na tregon, pse e rrahu studentin, i cili pati qëndrim ndryshe? Kjo nuk është demokratike, nuk është me ligj, nuk duhet të ndodhë në një demokraci parlamentare, të shkojë kryeministri të tregojë që po do të solidarizohet me mensën e studentëve një herë në 7-8 vjet, në fund të mandatit të vet, dhe mandej roja e tij ta rrahë studentin. Prandaj, jemi të shqetësuar të dimë se çka po ndodh, ku është ai student dhe pse e rrahën.

Po i kthehem ligjit. Problemi kryesor, i shfaqur gjatë këtyre viteve, ka qenë politizimi i skajshëm i UP-së, duke filluar prej stafit akademik, i cili në shumicën dërmuese i takon partisë në pushtet, pastaj menaxhmenti dhe pastaj të gjitha trupat tjera udhëheqës.

U pa që u provua të bëhet një ndryshim, por, i cili, në fakt, ka sjellë fare pak ndryshim, ose veç ndryshime kozmetike.

Më kujtohet në vitin 2007, në një fushatë parazgjedhore si kjo që sot po ndodh, i njëjti kryeministër pati thënë 'në Qeverinë time nuk do të ketë ministra me nga dy punë' dhe 'nuk do të ketë ministra profesorë'.

Si duket, ministrat nuk e kanë dëgjuar dhe i mbajnë nga pesë punë, edhe atë më së shumti në UP. Prandaj, e lënë punën keq në ministri dhe e lënë punën keq në UP, edhe mbaruan studentët duke vrapuar pas një nënshkrimi, sepse ministri kurrë nuk është në ligjërata dhe nuk duhet të jetë në fakt në ligjërata.

Kjo është cekur edhe në Raportin e Progresit, i cili thotë që në një situatë kur Kosova e ka një papunësi kaq të lartë, kur shumë kuadro profesionale të cilat kanë studiuar edhe jashtë vendit, edhe në vend, janë pa punë, ministra dhe deputetë i marrin nga 5-6, e deri në 8 rroga. Prandaj, për ta evituar, këtë Grupi Parlamentar i Aleancës do ta sponsorizojë amendamentin, i cili do të propozojë që ministrat dhe deputetët të qëndrojnë larg UP-së derisa kanë mandat politik.

Kjo është mënyra e vetme që UP-ja të çlirohet nga politikanët, të cilët me forma të ndryshme nëpërmjet konfliktit të interesit mbërrijnë të bëhen ligjërues në ditën që mbërrijnë me partinë në pushtet dhe pastaj e keqpërdorin pozitën e tyre prej ligjëruesi për të përfituar politikisht. Që kjo të marrë fund ne do ta sponsorizojmë amendamentin në fjalë dhe do të kërkojmë nga të gjithë, sidomos nga deputetët, të cilët diskutojnë shumë herë për UP-në dhe në të mirën e UP-së, që ta aprovojnë këtë amendament, i cili do t'i mbajë larg politikanët gjatë mandatit të tyre politik në cilindo institucion.

Në fund të fundit, UP-ja më së paku ka nevojë të helmohet prej politikanëve, të cilët po shihet që shkolla e tyre nuk po funksionon në ndërtimin e shtetit. Njerëzit të cilët shumica prej tyre janë të korruptuar, pa etikë profesionale, jokredibilë, nuk kanë nevojë të shkojnë dhe ta përcjellin këtë shkollë as në UP, as në institucionet tjera arsimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani për fjalë është lajmëruar deputeti Bekim Haxhiu, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Shumicën e çështjeve i tha edhe profesor Arsim Bajrami, që domethënë e mbështes diskutimin e tij.

Mirëpo, ajo çka unë vërtet do të doja të debatoja sot është konkretisht rreth nenit 4, mbi objektivat e organizimit në arsimin të lartë dhe organizimin të neni 2.1, niveli i parë. Domethënë parashihen studimet 3 edhe 4-vjeçare, kur studenti arrin 180, përkatësisht 240 kredi.

Mirëpo, nuk është paraparë niveli i studimeve 5 dhe 6-vjeçare, që janë adapt për Fakultetin e Mjekësisë dhe në këtë rast është anashkaluar ky nivel i studimeve. Mendoj që këtë vërejtje do të duhej seriozisht ta trajtojmë gjatë amendamentimit të ligjit me çështje konkrete që kanë të bëjnë kryesisht me fushën e arsimit, pa çështje politike. Dhe, mendoj që është edhe momenti i duhur që të debatojmë, kemi debatuar bashkërisht edhe në takimin me struktura të larta të Universitetit Publik “Hasan Prishtina” dhe me menaxhmentin, meqë ka qenë kërkesë edhe e vetë profesorëve dhe mësimeve të Fakultetit të Mjekësisë për disa vite që Fakulteti i Mjekësisë të ndahet dhe të jetë universitet i veçantë, universitet i shkencave biomjekësore, dhe unë mendoj që është koha që tani të punohet në këtë drejtim, që të ndahet me nga pesë drejtime, të cilat mund të jenë fakultete bazë dhe të jetë universiteti i shkencave biomjekësore, e me këtë do të evitoheshin shumë nene në Statutin e Universitetit të Prishtinës, por edhe në Ligjin e arsimit të lartë, i cili për shkak ndoshta të specifikës së Fakultetit të Mjekësisë duhet të adoptojë nene shtesë edhe në kuadër të Statutit, por edhe rregulloreve të caktuara në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

Meqë është një moment i qartë rreth definimit të kësaj çështjeje, kushtet janë, besoj që e kemi edhe nivelin e mjaftueshëm të mësimeve, por edhe nivelin e studentëve, por tani edhe me planifikime për ndërtimin e Dekanatit të ri dhe hapësirave të reja në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë. Mendoj që po vjen momenti që në godinën e re të dalim me universitetin e shkencave biomjekësore.

Gjithashtu sa i përket menaxhimit të Universitetit të Prishtinës dhe zgjedhjes së rektorëve, ky ligj gjithsesi duhet t’i përmbajë kërkesat e mësimeve, e kërkesat e tyre janë që rektori të zgjidhet nga Senati. Mendoj që do të ishte një zgjedhje e drejtpërdrejtë sa i përket zgjedhjes së rektorit dhe sigurisht që kushtet dhe kriteret janë ato të cilat i theksoi edhe profesor Arsim Bajrami, që të jetë një profesor ordinar, i cili nuk ka nevojë që të përfitojë nga pozita.

Gjithsesi, gjatë draftimit apo hartimit të këtij projektligji, ne duhet të kemi kujdes të veçantë që ky ligj të jetë në përputhje me Ligjin e punës dhe gjithsesi të jetë ligj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nuk duhet të jetë ligj diskriminues, përkundrajsaj që dikush këtu tentoi të marrë bajrakë politikë. Mendoj që ky ligj nuk duhet të jetë ligj diskriminues dhe Universiteti i Prishtinës dhe niveli i arsimit të lartë duhet të

jetë i nivelit të tillë të avancimit, edhe të zhvillimit, edhe profesional, edhe arsimor, edhe shkencor, edhe hulumtues, të gjitha të inkorporohen dhe të zgjidhen.

Mendoj që disa çështje të cilat kanë qenë të rregulluara me Statutin e universiteteve tani do të duhej t'i inkorporonim në kuadër të ligjit për arsye se nëse një shkelje është shkelje statutare, nuk është shkelje ligjore. Nganjëherë vërejtja mund të jetë brenda institucionit për shkeljen statutare, por nuk është shkelje ligjore nëpërmjet së cilës mund të ngrihen edhe kallëzimet penale për ata të cilët mund të abuzojnë me këto shkelje ligjore.

Edhe një herë, ministër ju përgëzoj për punën, për angazhimin dhe po shpresojmë që do të kemi kohë që ta draftojmë këtë ligj dhe ta miratojmë sa më shpejt edhe në leximin e dytë.

Biseda edhe me drejtuesin e Universitetit të Prishtinës është një kërkesë e të gjithëve, që besoj se do të vlente më tepër për komisionin të cilit edhe unë i përkas, që një debat të jetë edhe më i gjerë, jo vetëm me strukturën e lartë të Universitetit të Prishtinës, mirëpo të ketë një dëgjim publik edhe më të madh edhe për njësitë akademike, por gjithsesi edhe në universitetet e reja, të cilat janë hapur anekënd Kosovës falë punës dhe angazhimit tuaj, i nderuar ministër, dhe të vetë kryeministrit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar deputet! Tani për fjalë është lajmëruar zonja Lumnije Morina, deputete e Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Draftligji që sot po e shqyrtojmë ka ardhur si rezultat i zhvillimeve të fundit në Universitetin e Prishtinës.

Derisa arsimi i lartë në Republikën e Kosovës është një ndër segmentet më të rëndësishëm, konsideroj se duhet ta shqyrtojmë dhe ta amendantojmë këtë ligj me shumë kujdes. Pra, duhet të punojmë që ta krijojmë një bazë të mirë ligjore për mënyrën e funksionimit, pastaj themelimit, akreditimit, licencimit, financimit, vlerësimin e cilësisë e tjera në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Derisa me ligj u mundësohet të gjithë personave brenda dhe jashtë territorit të Kosovës, pavarësisht moshës, domethënë nuk ka kufizime në moshë për t'u regjistruar dhe për të fituar kualifikim në arsimin e lartë në Kosovë, të njëjtëve nuk u garantohet se nuk do të ketë diskriminim në punësim për shkak të moshës.

Te licencimi i bartësve të arsimit të lartë, me ligj thuhet se licenca u jepet bartësve të arsimit të lartë jo më gjatë se 5 vjet, kjo varësisht nga kohëzgjatja e akreditimit të këtyre në Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Por, te kriteret e licencimit, ndër të tjera, kërkohet një plan biznesi trevjeçar, e që unë konsideroj se ky plan biznesi duhet të jetë pesëvjeçar, konform kohëzgjatjes së licencës.

Gjithashtu, kur një bartës i arsimit të lartë dështon t'i plotësojë kushtet për licencim të vendosura nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, atëherë nuk ka kuptim që me ligj të

parashihet që i njëjti të mund të aplikojë në çdo kohë në ministri për ndryshimin e kushteve në licencën e tij, neni 14, pika 7.

Sa i përket statutit të bartësve të arsimit të lartë dhe kolegjeve private dakordohem me shumicën e kolegëve të mi deputetë. Mendoj se për statutin e tyre duhet ta marrin miratimin e Kuvendit.

Si strukturë drejtuese e arsimit të lartë, konsideroj se ka qenë mirë që Këshilli Drejtues të ketë më shumë se nëntë anëtarë. Unë propozoj t'i ketë njëmbëdhjetë anëtarë. Gjithashtu zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues, të paraparë me ndërrim nga ministria, ka qenë mirë të bëhet ndryshe, pra të bëhet nëpërmjet një konkursi dhe vlerësimi i kandidatëve të bëhet nga një komision i Kuvendit dhe në fund kandidatët e kualifikuar nga komisioni të sillen në Kuvend për votim.

Gjithashtu, edhe detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues ka qenë mirë të rishikohen dhe të definohen qartë.

Lidhur me përcaktimin e kriterëve për konkurrim dhe pranim të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, si në atë publik dhe në atë privat, konsideroj se duhet të jenë të njëjta.

Nëse kriter për konkurrim për një kandidat në institucionet e arsimit të lartë publik është kalueshmëria e testit të maturës, kjo duhet të vlejë edhe për bartësit e arsimit të lartë privat.

Gjithashtu, edhe konkursi për pranimin e studentëve të rinj duhet ta ketë një limit kohor, e jo të ndodhë sikur që ka ndodhur deri më tani, që konkurset në universitetet private të zgjasin gjatë tërë vitit.

Pra, defektet edhe mangësitë e evidentuara në leximin e parë të Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës mendoj që duhet të rregullohen në lexim të dytë nëpërmjet amendamenteve.

Përndryshe, mendoj se nëse nuk bëhen këto ndryshime, ky projektligj nuk ndryshon prej ligjit paraprak që e kemi pasur.

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuara deputete! Sa për informacionin tuaj, për fjalë janë të lajmëruar shtatë deputetë. Nëse jeni të interesuar, pasi po shoh që interesimi i disa deputetëve është për të shkuar në pauzë për drekë, mirëpo vendimi është juaji nëse jeni të gatshëm për pauzë. Unë jam vetëm një, ju jeni 50. Shumica vendos. Atëherë shkojmë në pauzë deri në orën 15:00. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Xhafer, e ke fjalën i pari, pasi je ankuar. Zoti Xhafer Tahiri e ka fjalën.

XHAFER TAHIRI: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të vazhdoj me fjalimin që e kam përgatitur lidhur me Projektligjin për arsimin e lartë, dua të bëj një kundër-replikë me kryeministrin, i cili megjithëse nuk është këtu, e krahasoi qeverisjen e LDK-së me këtë qeverisje të tij. Unë dua thjesht të them që unë jam një prej atyre studentëve ose nxënësve që e ka kryer shkollën fillore nga viti '90 deri në vitin '99 dhe ajo që mund të them është se ai sistem arsimor dhe ai arsim që është bërë në atë kohë ka shumë më tepër kredibilitet, ka pasur shumë më tepër kredibilitet, seriozitet në punë, se sa që ka tani në procesin e arsimit në Kosovë, për fat të keq. Dhe, nëse do që ta krahasojë qeverisjen e tij me qeverisjen e LDK-së, duhet në radhë të parë t'i referohet atij organizimi të jashtëzakonshëm, që e kishte bërë Lidhja Demokratike e Kosovës në ato vite të vështira.

Ndërkohë që sa i takon Ligjit për arsimin e lartë, që sot e kemi para vetes, na paraqitet si ligj i ri, por në fakt në esencën e tij është plotësim-ndryshim i ligjit aktual.

Duhet thënë që në fillim se ky projektligj nuk i adreson rekomandimet e debateve të iniciuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe të aprovuara në këtë Kuvend mbi gjendjen në UP dhe në arsimin e lartë në Kosovë.

Arsimi i lartë do të duhej të ishte ajo pjesë e organizimit tonë si shoqëri që do të mbetej jashtë ndikimit të politikave ditore dhe që do të prodhonte kuadro dhe strategji për zhvillimin tonë të gjithëmbarshtëm shoqëror.

Mirëpo, për fat të keq, ndër sektorët më të shkatërruar dhe më të keqpërdorur nga qeverisja aktuale e PDK-së është arsimi universitar. Në mënyrë të paprecedent, Qeveria Thaçi gjithnjë në këto vite tentoi të manipulojë me studentët dhe arsimin e lartë, në përgjithësi, duke i parë ata gjithnjë vetëm si numra e vota, por asnjëherë si potencial për zhvillimin e Kosovës.

Qeveria aktuale hyn në radhën e atyre qeverive autokratike që për qëllime puro-politike e populliste, e në funksion të fushatës elektorale, pa e pyetur fare universitetin, në mënyrë të paparë deri më tani askund në botë, vendos nga kabineti për pagesat në universitet.

KRYESUESI: A po hyn në temë, a po ta ndërpres fjalën?

XHAFER TAHIRI: Për temën jam duke folur!

KRYESUESI: S'ka asgjë... të bëjë me...!

XHAFER TAHIRI: Nuk ka ndodhur asnjëherë në histori më herët një precedent i tillë, madje as në kohën e komunizmit. Studentët e sotshëm, elita e ardhshme e këtij vendi e kuptojnë këtë hile të Qeverisë, prandaj në kohën e duhur edhe do ta vlerësojnë drejt këtë.

Vendi ynë e ka përqindjen më të lartë të të rinjve, jo vetëm në rajon, por edhe në Evropë. Pra, ne e kemi shansin e papërsëritshëm që këtë fakt ta kthejmë në përparësi për zhvillim e përparim.

Andaj, ne duhet që arsimin e lartë ta konsiderojmë si mundësi për ta përdorur potencialin e të rinjve në funksion të forcimit të vlerave të shoqërisë sonë dhe të shtetit tonë.

Por, në këto vite, në vend që universitetet të ishin tempuj të dijes, me politizimin e plotë të institucioneve të arsimit të lartë, Qeveria aktuale e ka shkatërruar perspektivën e zhvillimit të universiteteve. Duke emëruar njerëz të politikës në universitete publike, e duke mos krijuar kushte për hapjen e asnjë vendi të ri të punës, Kosova sot prodhon të papunë të diplomuar dhe studentë që çdo ditë kërkojnë azil në vendet e Bashkimit Evropian.

Universitetet publike përballen sot me mungesë të stafit dhe të objekteve, dhe rrjedhimisht më të dëmtuarit prapë janë studentët dhe perspektiva jonë si shoqëri.

Ndërsa studiuesit e shkencëtarët e rinj nuk i kanë as kushtet më elementare, siç janë bibliotekat e literatura, apo edhe fondet për punë kërkimore e shkencore.

Si pasojë e tërë kësaj, aktualisht arsimi i lartë në Kosovë nuk është në funksion të zhvillimit ekonomik, e as nuk është duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Prandaj, ka kaq të diplomuar që, për fat të keq, nuk punojnë në profesionin e tyre, ose edhe më keq janë krejt të papunë.

Për ta vërtetuar këtë dhe për ta treguar vizionin e kësaj qeverisjeje për arsimin e lartë mjafton ta përmendim një fakt. Burim kryesor i zhvillimit ekonomik në Kosovë janë minierat, mineralet dhe teknologjia e avancuar.

Shihini universitetet publike që ka hapur kjo Qeveri dhe vlerësojeni a i përshtaten teknologjisë, a u përshtaten drejtimit...

KRYESUESI: Xhafer, t'i nuk je kryeministër për t'i sqaruar të gjitha, ai e ka në dorë.

XHAFER TAHIRI: ...të këtyre institucioneve, nevojave të tregut të punës. Një padrejtësi e madhe që kjo Qeveri ua ka bërë studentëve dhe institucioneve private të arsimit të lartë është fakti që ka lejuar që këto institucione të funksionojnë si kolegje, e ndërkohë kolegjet nuk janë të organizuara në kuadër të sistemit publik të arsimit të lartë në Kosovë.

Kjo pabarazi formale ndërmjet institucioneve publike të arsimit të lartë dhe institucioneve private të arsimit të lartë i ka dëmtuar në veçanti studentët që sot, megjithëse kanë kryer

arsim të lartë në këto kolegje, madje dhe me pagesa goxha të larta, nuk janë të barabartë me kolegët e tyre që e kanë kryer arsimin e lartë në institucionet publike, qoftë kur aplikojnë për t'i vazhduar studimet e avancuara të magjistraturës e të doktoraturës, qoftë kur këta studentë diskriminohen pa të drejtë, kundërligjshëm, kurdo që aplikojnë për një vend pune, në krahasim me kolegët e tyre që i kanë kryer studimet në universitetin publik.

Pra, për t'u kthyer te projektligji - ky projektligj që na është sjellë tani në Kuvend dështon t'i adresojë problematikat themelore që e kanë karakterizuar arsimin e lartë në Kosovë në këto vite. Dhe, këto janë praktikisht vërejtjet e mia themelore në këtë dokument.

Nën një, projektligji nuk krijon parakushte për depolitizimin e institucioneve të arsimit të lartë, në të vërtetë sikur për ta dëshmuar apetitin e Qeverisë për të vendosur për çdo gjë në jetën tonë.

Ky projektligj, në nenin 3.14 thotë që bartësit e arsimit të lartë publik themelohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Kjo nuk mund të qëndrojë dhe duhet të ndryshohet. Institucionet publike të arsimit të lartë duhet të themelohen vetëm nga ky Kuvend dhe në asnjë mënyrë nga Qeveria, e aq më pak nga Ministria.

Për më tepër, nga diskutimi i kolegut në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, jo që flitet për depolitizim të institucioneve publike të arsimit të lartë, por dilema e tij është që anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga ministria të mos kalojnë fare nëpër këtë Kuvend për t'u emëruar si anëtarë të Këshillit Drejtues të Universitetit, dhe kjo është tendencë për politizim të plotë, për të vendosur gjithçka në universitet nga njerëzit e deleguar nga Qeveria.

Unë mendoj se kjo nuk mund të qëndrojë në këtë mënyrë, sepse tashmë i ka sjellë shumë dëme Universitetit "Hasan Prishtina", por është duke u shkaktuar dëme edhe universiteteve tjera publike. Merreni rastin e Universitetit të Prizrenit, ku një kryetar i dënuar është anëtar i Këshillit Drejtues, ose rastin e Universitetit në Mitrovicë, ku ish-kryetari i Komunës është prapë, ishte pjesë udhëheqëse e Universitetit Publik. Kjo nuk i kontribuon në asnjë mënyrë depolitizimit të arsimit të lartë, autonomisë shkencore dhe pavarësisë që duhet ta gëzojnë institucionet e arsimit të lartë, përkundrazi.

Prandaj, Këshilli Drejtues dushet ta ndryshojë natyrën e vet edhe funksionin e vet në kuadër të universiteteve publike. Ai nuk mund të ketë rol vendimtar në qeverisjen e universitetit. Ai duhet të ketë rol këshillëdhënës, ndërsa anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë njerëz kredibilë që i kanë përfunduar studimet e tyre të avancuara dhe që në atë këshill kanë përvoja të jashtëzakonshme jetësore dhe i ndihmojnë ngritjes së universitetit, e jo njerëz që e shfrytëzojnë atë pozitë në Këshill, qoftë për t'u plasuar në kuadër të institucioneve arsimore, qoftë për t'i përfunduar studimet e tyre.

Dhe, vërejtja tjetër themelore ime në këtë projektligj ka të bëjë me atë se nuk arrin në mënyrë të qartë të krijojë barazinë formale e juridike ndërmjet bartësve privatë dhe bartësve publikë të arsimit të lartë. Unë them se duhet të ketë barazi të plotë formale-

juridike ndërmjet niveleve të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe atyre private. Kriteret dhe standardet që i ofrojnë këto institucione determinojnë se kush nga këto do të mbijetojë në tregun e arsimit të lartë në Kosovë.

Për fund, dua të shpreh përkrahjen time po ashtu për të gjitha ato propozime të bashkëbiseduesve të mëhershëm ose diskutuesve të mëhershëm që kanë ftuar për një autonomi më të madhe të universiteteve, por edhe për rikthim të subjektivitetit të fakulteteve në kuadër të universitetit, qoftë Universitetit Publik “Hasan Prishtina”, qoftë të universiteteve tjera publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nijazi Idrizi nuk është. Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është parë si shumë i nevojshëm, sidomos për shkak të trazirave që ndodhën në Universitetin e Prishtinës kohë më parë. Të ju them të drejtën, gjatë analizës që ia kam bërë projektligjit, unë kam hasur shumë pak risi në të, që do t'i shmangte pakënaqësitë të cilat na u shfaqën para pak kohe.

Po filloj t'i përmend disa vërejtje dhe konkludime që i kam unë, sa i përket këtij projektligji. Neni 5, pika 2 thotë se nuk do të ketë kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë në Kosovë. Shpresoj se kjo pikë do të respektohet dhe se, në radhë të parë, në institucionet e arsimit të lartë do të respektohen vlerat, të cilat i prezanton një kandidat. Po ju sjell në kujtesën tuaj se në vitin 2008, mbi 120 magjistrave të shkencave në Fakultetin e Mjekësisë nuk iu lejua as e drejta për të hyrë në konkurrencë për ta fituar të drejtën për doktoraturë, ku si kriter kryesor përjashtues ishte mosha e kandidatëve. Vlen të përmendet se shumë prej tyre ishin të moshës 35-vjeçare, ndërsa vlerat profesionale a shkencore që posedonin ata, komisioni as që mori mundin për pranim që t'i shqyrtojë. Uroj që diçka e tillë të mos përsëritet më dhe kjo dispozitë në të ardhmen të respektohet.

Neni 6, pika 1.6, një detaj që konsideroj se është mirë të plotësohet, thuhet se inkurajohet përdorimi i gjuhës angleze, krahas gjuhëve zyrtare. Pajtohem se duhet inkurajuar përdorimi i gjuhës angleze, por preferoj që të paktën të shkruhet ‘dhe gjuhëve tjera’, sidomos duke pasur qëllim integrimin në Bashkimin Evropian, ku gjuha gjermane dhe frënge janë dominuese, prandaj mendoj se nuk duhet t'i anashkalojmë ato.

Te neni 18, siç po shihet, Këshilli Drejtues do të vazhdojë të jetë autoriteti kryesor qeverisës. Për këtë u pa kohë më parë se kishte pakënaqësi dhe si duket do të vazhdojë të mbetet njëjtë. U dhanë këtu disa propozime, sidomos vlen të përmenden ato të deputetit Arsim Bajrami, me anë të të cilave do të relaksohej pozita e Këshillit Drejtues karshi Universitetit, dhe konsideroj se ato rekomandime duhet të merren parasysh gjatë amendamentimit të këtij projektligji.

Neni 19 ka të bëjë me autoritetet menaxhuese. Konsideroj atë që e kam thënë edhe gjatë debatit parlamentar që e kemi pasur lidhur me gjendjen në Universitet, se rektori dhe dekanët duhet ta kenë titullin më të lartë, pra të profesorit ordinar, sepse si të tillë...

(Ndërprerje gabimisht nga regjia.)

KRYESUESI: Regjia, gabuat me mikrofonin. Shtypeni edhe një herë!

AURORA BAKALLI: ...sepse konsideroj se profesori me titullin më të lartë do të duhej të kishte edhe integritet personal më të lartë. Në ato institucione të arsimit të lartë, ku nuk kanë profesor të titullit ordinar, atëherë këtë post duhet ta mbante profesori me titullin më të lartë, që ka ai fakultet. Prandaj, propozoj që të futet një pikë e re në këtë nen që e parasheh një gjë të tillë. Gjithashtu, rektori duhet të ketë biografi të pastër dhe të mos ketë qenë pjesë e aferave të ndryshme korruptive, apo të keqpërdorimit.

Te neni 26, titujt dhe gradat e personelit - kjo ishte një ndër çështjet që hapi shumë debate dhe pakënaqësi në të kaluarën, por sa i përket kësaj problematike unë nuk hasa në zgjidhje me këtë projektligj që na është prezantuar sot. Domethënë, çdo gjë u lihet statuteve të institucionit të arsimit të lartë. Në pikën 4, në mënyrë shumë të përgjithësuar thuhet se kandidatët për gradat e profesorëve duhen të kenë sfond të suksesshëm të publikimit në revista me recension ndërkombëtar. Ngjashëm ishte edhe në ligjin para tij, por çfarë mund të jetë ky sfond i suksesshëm e kuptuan të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Nëse dëshirojmë profesorë kualitativ, ka mundësi tjera për të kërkuar, qoftë me indeksim të revistave ku publikohen, qoftë me përdorimin e impakt-faktorit dhe mendoj se këto do të ishin të vlefshme në ngritjen e kualitetit të mësimdhënësve në universitetet tona.

Pika 13 thotë se stafi akademik i angazhuar në pozita menaxheriale në nivel të njësive akademike, apo në nivel të institucionit, nuk mund t'u nënshtrohet procedurave të avancimit akademik, derisa e mban pozitën. Po që se e futim amendamentin e ri, ku për rektorin dhe dekanët kërkohet që ta kenë titullin më të lartë - profesor ordinar, atëherë nuk do të ketë nevojë për këtë pikë dhe mendoj se është shumë më racionale dhe shumë më e qëndrueshme.

Këto janë vërejtjet e mia sa i përket këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Pra, edhe një herë, angazhohemi fuqishëm që me Ligjin për arsimin e lartë ne t'i sigurojmë të gjitha parakushtet që vërtet ta kemi një arsim konkurrues dhe që të gjithë studentët tanë, kur ta marrin një diplomë, ajo diplomë të jetë konkurruese, si brenda në Kosovë, po të krahasohet edhe me bashkëmoshatarët e vet edhe në gjithë Evropën, vlerat

të cilat ne të gjithë po i pretendojmë. Por, kur bëhet fjalë se si të arrihet deri aty, e thamë edhe më herët se do të duhet gjithsesi që Universiteti të depolitizohet dhe të mos jetë në interes të asnjë politike dhe të asnjë qeverie veç e veç, e kjo mund të sigurohet nëse i sigurohet autonomie.

Por, autonomia nënkupton edhe mënyrën dhe politikat financiare që do t'i ketë Universiteti dhe në këtë drejtim unë angazhohem fuqishëm që shteti ta parapërcaktojë cili do të jetë buxheti për Universitetin dhe ai të mos varet nga vullneti individual, as i ministrit, kryeministrit, as edhe i vetë Kuvendit. Dhe, siç thotë një fjalë e popullit: “Kryeministër, a nuk dita me të kallëzue, a nuk more vesh?”, unë fola për autonominë. Nuk isha kundër. Unë jam përkundrazi, në angazhim se sipër që Universitetit t'i dyfishohet buxheti dhe të mos i ndërhyhet në planifikimet e veta.

Unë mendoj se po të ishim angazhuar sinqerisht për ta dyfishuar buxhetin e Republikës së Kosovës, ose për t'i rritur të hyrat, sot buxheti i Kosovës do të ishte 2 miliardë, ose 2 miliardë e gjysmë, dhe do të shtrohej pyetja pastaj se çka do të mund të bëjmë. Vetëm po ta shohim ekonominë informale, unë mendoj se së paku 200 milionë sot do të kishte qenë buxheti edhe kjo është mjeshhtëria, kjo është fuqia, jo vetëm se si shpërndahen mjetet. Jo që jam kundër, përkundrazi unë mendoj se pse për këto 3-4 vjet të jetë rritja 25%. Unë angazhohem që kjo të jetë 50% dhe po të ishte qeverisur mirë Kosova, sot do të kishim biseduar për 50%.

Nuk jam kundër, angazhohem fuqishëm - kjo rritje është shumë e vogël në krahasim me nevojat që i ka edhe Universiteti, edhe shtresat tjera të shoqërisë.

Jo, kryeministër, nuk jam kundër që janë rritur pagat e minatorëve, por minatorët po pyesin çka po ndodh që kaq vite. Ata janë nënë mëshirën e Dhomës së Veçantë, e jo nën mëshirën e AKP-së...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Regjia, replika është 2 minuta. Replikë bëre, ti nuk po flet për ligjin. Fjalën e ka Halit Krasniqi.

(Reagime nga salla.)

KRYESUESI: Ai ka të drejtë të flasë, edhe ti ke pasur të drejtë të bësh replikë. Ulu tash në vend! Fjalën e ka Halit Krasniqi. Nuk je në kuadër të temës, ti je duke replikuar me kryeministrin. Ulu tash, pastaj ta jap fjalën, e kryen replikën. Ta jap fjalën për fjalën për universitet, nëse do të flasësh...

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Problemet në Universitetin e Prishtinës dhe me arsimin e lartë shkarazi i kam trajtuar publikisht dhe i kam shprehur idetë, konceptet dhe mendimet e mia për gjithë atë gamë problemesh që e ka karakterizuar si Universitetin e Prishtinës, po ashtu edhe arsimin e lartë, në përgjithësi.

Do t'i filloj në mënyrë koncize dhe përmbledhtazi të gjitha ato preokupime që i kam edhe aktualisht tani, duke filluar nga regjistrimi i studentëve e deri te organizimi dhe mbarëvajtja e përgjithshme e funksionimit të arsimit të lartë. Do të filloj me një brengë që është edhe e juaj, e shumicës këtu, por që natyrisht që unë për veten time e kam diskutuar edhe me autoritetet e Universitetit të Prishtinës.

Studentët nga Lugina e Preshevës, nga Mali i Zi dhe viset tjera shqiptare nuk do të duhej t'i kishin kufizimet që i kanë tani dhe unë mendoj nga ky staf i Ministrisë së Arsimit dhe të gjithë atyre ekspertëve që e udhëheqin arsimimin e lartë do të kenë ndikim këto ide që i jap dhe kjo kërkesë që e bëj tani.

Precizimi i publikimeve të bëhet nga një ekspertizë e kualifikuar dhe të mos ndodhin përplasje e probleme sikur që kanë lindur para pak kohësh dhe që e prodhuan atë krizë, të cilën ne e njohim të gjithë. Arsimimi i lartë në institucionet private, jo vetëm të bëhet licencimi i këtyre universiteteve, por edhe respektimi i kriterëve dhe kushteve reciprokisht, edhe nga Ministria e Arsimit, edhe nga institucionet private. Kushtet e studimit duhet të trajtohen në mënyrë të plotë që nga regjistrimi, akomodimi, ushqyerja dhe deri te të drejtat tjera, të cilat do të duhej të respektoheshin reciprokisht, si nga studentët, gjithashtu edhe nga universitetet.

Do të përpiloj në amendamente preokupimet e mia për këtë ligj dhe do të përpiqem të bart idetë që unë mendoj se janë të dobishme dhe me ekspertë të fushës jam konsultuar shumë herë dhe do të konsultohem edhe gjatë draftimit të këtyre amendamenteve, sepse konsideroj që qasja për arsimin e lartë nënkupton trajtimin e trurit nacional. Për krijimin e kuadrove në profesionet e caktuara me integritet dhe rrjedhimisht për emancipimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë në kulturë e shkencë për arritjen në nivele bashkëkohore, si dhe shoqëritë tjera, të cilat kanë hyrë në mileniumin e dytë në arsimimin e lartë.

Me këtë rast, kërkoj nga të gjithë ekspertët e arsimit të lartë që ta ofrojnë ekspertizën e tyre dhe të kontribuojmë në begatimin e këtij projektligji, rrjedhimisht pasi të votohet, të këtij ligji shumë të rëndësishëm, jo vetëm për Universitetin dhe arsimimin e lartë, por edhe për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë sonë dhe të shtetit tonë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjen e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Sadri Ferati paska kërkuar replikë. Urdhëro, e ke fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit, Unë do të vazhdoj në kontest të temës që e kemi, por janë disa tema nganjëherë që po ndërliiden dhe do ta begatoj po ashtu çështjen që unë dua të them edhe nga ky kënd. Larg asaj që dikush që diskuton për Ligjin për Universitetin të jetë kundër pse bëhet autostrada kudo, por edhe për Mitrovicë. Unë jam përkundrazi kritik, çka u bë, se në vitin 2007 janë fituar zgjedhjet me këtë autostradë e nuk është kryer, e në vitet 2009, 2010 e 2013, dhe nëse unë them tash pse çka po ndodh me këtë autostradë, të kuptohet se jam kundër autostradës, larg asaj. Çka po ndodh?

Katër palë zgjedhje fitohen, e autostrada është hala në mes të rrugës! Unë nuk jam kundër, përkundrazi. Është fat i mirë që rriten pagat e minatorëve, por minatori nën mëshirën e vendimit të Gjykatës së Veçantë dhe të AKP-së, ata nuk po arrijnë të zhvillohen. Atje saktësisht dihet që po qe se ata e krijojnë autonominë e veprimit, mund të punësohen me mijëra punëtorë dhe ata shtrojnë pyetje: Po më rritet mua rroga nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe po më vjen mirë, por ku do t'i vijë rendi të hyjë në punë fëmijës tim?

Çka të bëjmë me ata minatorë që sot qëndrojnë në shtëpi dhe i marrin nga 50 euro dhe, nëse unë interesohem që 'Trepça' ta ketë autonominë dhe zhvillohet dhe të nënkuptohet se unë jam kundër rritjes së pagave. Përkundrazi, jam shumë kritik. Qe sa vite ne e shohim duke u fundosur 'Trepça', dhe tash në paga të zgjedhjeve na bie në mend se duhet ta amendamentojmë një ligj dhe prapë mungon Ligji për 'Trepçën', për të cilën kam folur, e këtu shihet se kujt po i dhemb zemra për minatorët, e kush po i përmend sa herë po ka zgjedhje.

Prandaj, edhe një herë, jo që jam kundër, përkundrazi kam shumë kërkesa. Edhe për minatorët kam shumë kërkesa dhe nëse unë tash angazhohem që të ketë barna në spital, nuk jam kundër rritjes të pagave për mjekët. Prandaj, do të kthehem në temë. Faleminderit kryetar që pate durimin të më dëgjosh dhe që nuk më ndërpreve.

Ndërsa, në kontest të kësaj, po i kthehem idesë fillestare, unë mendoj që kjo shoqëri është pjekur që të ketë institucion publik, siç është Universiteti i depolitizuar dhe t'i krijohet autonomia. Pse të dyshojmë që ata profesorë dhe ata studentë nuk janë në gjendje ta menaxhojnë një universitet, por duhet të interferohet nga jashtë dhe a ka modele të autonomisë në universitete? Ka kudo në botë? A ka autonomi të ndërmarrjeve publike? Po, ka kudo në botë.

Ne e kemi postën që e kemi sakatuar dhe nga 700 milionë ia kemi sjellë vlerën në 270 milionë dhe këto ditë do të dëgjoni se do të hapen konkurse për vende të punës në postë, që të fundoset përfundimisht. Faleminderit!

KRYETARI: Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Projektligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës pa dyshim e ka edhe një rëndësi dhe specifikë të veten, për vetë faktin që, jo vetëm që merret me gjendjen e arsimit të lartë, por edhe duke pasur parasysh rrethanat të cilat i kemi kaluar ditëve të kaluara, konkretisht Universiteti Publik i Prishtinës, arrestimet, skandalet thënë troç krimin i cili ndodhet në Universitetin e Prishtinës dhe i cili është vështirë të luftohet aty.

Prandaj, ky projektligj pa dyshim, me shpresë se do ta harmonizojë sadopak dhe do të japë një dritë në përmirësimin e gjendjes aktuale, e ka edhe peshën e vet.

Unë, pa dashur ta zgjas më shumë, ngase puna kryesore i mbetet edhe Komisionit Parlamentar për amendamentimin e këtij ligji, por dua ta jap një propozim të veçantë, konkret dhe të shpresoj që këtu është edhe ministri i Arsimit, do ta ketë këtë parasysh këtë propozim timin, i cili është mjaft produktiv edhe për Universitetin e Prishtinës, në përgjithësi, por edhe për lëmin për të cilin po flas.

Ministër i nderuar, unë propozoj, edhe pse prapë po them - detyra kryesore i mbetet Komisionit Parlamentar, që të themelohet Universiteti i Shkencave Mjekësore, duke pasur parasysh se vetëm këtu i kemi 5 njësi akademike mjekësore, duke filluar nga mjekësia e përgjithshme, stomatologjia, farmacia, fizioterapia dhe infermiera. Të gjitha këto 5 njësi, unë mendoj se janë ngarkesë dhe barrë e rëndë për Universitetin aktual të Prishtinës, i cili me të gjitha vështirësitë që i ka, e ka vështirë ta menaxhojë situatën aktuale në Fakultetin e mjekësisë. Prandaj, unë propozoj që ta shqyrtoni me seriozitet këtë propozim timin - që të themelohet një universitet i shkencave mjekësore, dhe unë mendoj që është mjaft kredibil dhe i ka të gjitha kapacitetet që i duhen, i ka edhe kuadrot të cilat i duhen aktualisht.

Fakulteti i Mjekësisë nëse kalon në universitet të shkencave mjekësore, mendoj që është koha e duhur që ta nisni iniciativën në këtë drejtim dhe mendoj se do të jetë edhe shumë më i dobishëm, ndoshta edhe më i arsyeshëm se disa universitete, qoftë private apo publike, të krijuara deri më tash, prandaj unë shpresoj në mirëkuptimin e juaj si ministër, por edhe të Komisionit Parlamentar që ta marrin parasysh këtë kërkesë, ngase kemi të bëjmë me një substancë shumë të rëndësishme, që ka të bëjë me Universitetin e Shkencave Mjekësore, do të thotë me fushën e mjekësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra, e fundit e lajmëruar për diskutim.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit kryetar!

Besoj që u shter debato dhe po befasohem dhe po më vjen keq nga ata studentë që sot e kanë pasur rastin ta dëgjojnë këtë seancë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku më tepër është diskutuar për çështje dytësore, posaçërisht nga opozita, se sa për Ligjin për arsimin e lartë, sepse ne sot më së paku është dashur që të diskutojmë për çështje tjera.

Është thelbësore që studentët të jenë të informuar me ligjin dhe me rregulloret që ne si Kuvend po i bëjmë sot dhe ajo që duhet të thuhet është se këtu u përmend edhe mensa e studentëve dhe unë po them se edhe vet kam qenë 'mensiste' dhe studente në konvikt, dhe e di sa e vështirë ka qenë jeta aso kohe për familjet të cilat kanë pasur dy ose tre studentë dhe pa dyshim se vendimi i fundit ka ndikuar që të ketë lehtësira për studentët, por edhe për mësimdhënësit.

Po befasohem me qasjen e opozitës sot këtu.

Sa i përket Ligjit për arsimin e lartë, unë kam disa vërejtje, me të cilat konkretisht pajtohem me kolegun Ramë Vataj, i cili parimisht foli lidhur me specifikat e ligjit, ndërsa nja dy-tri rekomandime që i kam do t'i përmend që në fillim. Do të thotë është mirë që të publikohen tezat e doktoraturës dhe kjo të bëhet nëpërmjet Ligjit. E di që ka pasur

ndryshime në ligj. Pastaj edhe programet ose plan-programet studimore, secili fakultet të jetë i detyruar me ligj që t'i paraqesë në mënyrë që të mos kemi telashe gjatë akreditimit, sepse ka pasur disa universitete, kolegje, në fakt fakultete, të cilat nuk kanë arritur që t'i akreditojnë programet e tyre.

Një problematikë tjetër është zgjedhja e stafit akademik. Konkursët e pranimeve dhe të avancimeve në gjithë Evropën bëhen në mënyrë online. E di që edhe Universiteti i Prishtinës e ka bërë një avancim në këtë drejtim. Publikimet ose paraqitja e provimeve është online, por pres që edhe në këtë drejtim të ketë progres. Dhe, në fund pres që ligji të jetë i pranueshëm dhe studentët të kenë mundësi dhe të kenë qasje në drejtimet në të cilat dëshirojnë që të kenë publikime dhe hulumtime të ndryshme shkencore. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë dua në parim që ta mbështes Ligjin për arsimin e lartë dhe kontributin tim do të përpiqem ta jap edhe përmes amendamenteve në Komisionin për Arsim.

Gjithashtu, dua të mbështes edhe kolegun tim për idenë e themelimit të Universitetit të Shkencave Mjekësore që mendoj që është e domosdoshme që të bëhet kjo dhe njëherë e mirë të bëhet profilizimi i lëndëve ose thjesht i drejtimeve dhe mos të kemi përzierje të kompetencave, ndoshta do të thosha.

Gjithashtu, dua të lidhem pak a shumë me bisedën e koleges sime ose debatin e koleges time nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Donika Kadaj-Bujupi, e cila tha që studentët po lodhen duke i ndjekur profesorët për nënshkrime nëpër Universitet. Më vjen keq, e nderuara kolege, keni mbetur pak mbrapa, sepse siç e dini me ardhjen e Partisë Demokratike në pushtet, është bërë digjitalizimi i Universitetit dhe studentët tashmë janë të pajisur me kartela digjitale dhe nuk kanë nevojë fare që të vrapojnë pas nënshkrimeve.

Gjithashtu, kam edhe një pyetje për kolegen kur tha që njëherë në shtatë vjet kryeministri ushqehet në Mensën e Studentëve, lë të ma jep një shembull në botë ku ekziston që kryeministri i vendit të ushqehet çdo ditë në Mensën e Studentëve. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Kryetar, unë shqetësimin e shpreha pse kryeministri ka rrahur studentët jo pse ka shkuar për të ngrenë gullash e fasule, më paskan keqkuptuar.

KRYETARI: Mirë! Ganimete, edhe një herë një minutë e ke.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe njëherë nuk është marre për të pranuar kur nuk është mjaftë e informuar, sepse pikërisht tha që studentët po vrapojnë pas nënshkrimeve dhe kjo nuk është e vërtetë.

Kështu që edhe njëherë po ia përkujtoj që me ardhjen e Partisë Demokratike në pushtet, është bërë digjitalizimi i Universitetit dhe studentët s'kanë nevojë të vrapojnë.

Është mirë kur nuk jeni e informuar të pranoni, të thoni më vjen keq s'e paskam ditur, por unë po ju njoftoj që është bërë digjitalizimi.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar koleg ministër,

Të nderuar dhe shumë të respektuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, Ju falënderoj shumë për debatin, gjithsesi për kontributin. Pajtohem shumë me shumëçka që u tha këtu e kurrësesi s'pajtohem dhe nuk tumir absolutisht fyerjet dhe vetë fyerjet që u bënë, duke fyer institucionet tona arsimore dhe jemi të gjithë produkt të tyre dhe bile tash jemi edhe prodhues nga ato institucione, këtu s'pajtohem, por e lëmë nuk po dua të zë emra në gojë as në asnjë mënyrë të cenoj askënd, as ta provokojë për të folur, e lëmë atë punë.

Por, dua të them për një element që në preambulë të këtij projektligji që në fakt do të amendamentohet dhe s'është ligji i ri, duhet ta ri kuptojmë këtë gjë, flitet për mos diskriminimin dhe nga Ministria e Arsimit drafti që unë e kam pasur së fundi është nisur pa pikën 5 të nenit 16, duke diskriminuar publikisht dhe hapur dhe pa asnjë dilemë institucionet private nga ato publike.

Nëse këto institucione i akreditojmë dhe i licencojmë, si është puna atëherë. Unë pajtohem me atë pjesë të debateve që u tha nuk do të duhej në asnjë mënyrë ky ligj nesër i amendamentuar dhe i përplotësuar të jetë ligj që diskriminon, sepse e thëna dhe e bëra dallojnë shumë dhe një nen që po kështu ishte i futur përsëri në draft e propozimi ka qenë që të hiqet, sepse kolegjet tanimë private thuhet që do të duhej të nxjerrin nga vetja 5 doktorë, përveç numrit të studentëve dhe profesorëve, që të bëhen ose të emërtohen universitete, në fakt atyre kurrë nuk u janë akredituar programet për doktoratë.

Kështu që, lus Komisionin për Arsim dhe të tjera, sepse është emër i gjatë, emërtimi i gjatë dhe s'po i them të gjitha, që ta kenë parasysh edhe në diskutim publik që këto gjëra t'i kenë parasysh dhe të mos deklarojmë diçka tjetër dhe të veprojnë diçka tjetër, sepse në fakt ne këta studentë që janë të institucioneve private të arsimit të lartë do të duhej t'i barazonim siç kam insistuar vazhdimisht me këtë pjesë ligji që më ka lejuar ta bëjë këtë, por bën akoma më të mirë seç është tani ligjin në mënyrë që ne të mos kemi nevojë të merremi edhe njëherë me këtë çështje.

Andaj, ju lus sinqerisht ku do të jem shumë aktiv dhe kontribuues sa herë që të më kërkonin siç kam qenë gjithmonë në Komision, që këtë ta bëjmë në mënyrë më të mirë të mundshme. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një fjalë do ta thotë ministri.

MINISTRI RAMË BUJA: Po, u fol për universitete të reja në Prishtinë, unë po ju them që në tavolinën time janë tri projekte për Universitetin e Shkencave Mjekësore, Universitetin e Shkencave Teknike dhe Universitetin e Shkencave Sociale ose Shoqërore, por atë do t'i aprovoni ju në Kuvend, sepse nuk e bën Ministria bash ashtu lehtas qysh edhe mund të bëhet ndonjëherë.

Kështu që unë po ju lus që ta keni mirëkuptimin për këtë gjë edhe në ligj të fusni diçka që e lejon këtë mundësi që ta bëni ju. Faleminderit!

KRYETARI: Nëse mund t'i shtoni hala ne keni shpëtuar. 57 deputetë janë prezentë, por po ju njoftoj me një rregull ligjore që e kemi këtu, një këshillë juridike, po ju përkujtoj për kur të bëhet numri duke u bazuar në nenin 81, amendamenti 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për miratimin e ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e garantuara përkatësisht, këto janë të rezervuara, për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë.

Çka do të thotë edhe po t'i kem numrat, duhet të jenë 13 vota për të komuniteteve pakicë dhe duhet të jenë 61 vota të shqiptarëve si shumicë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike

Në bazë të nenit 56, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ministrin nuk e kemi këtu, por në emër të ministrit Fadil Ismajli është ministri Dardan Gashi, e zëvendëson. Ministër e ke fjalën.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit! I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

Siç jeni në dijeni, Kuvendi i Kosovës më 22.4.2013 i ka rekomanduar Qeverisë që të procedojë Projektligjin për “Trepçën” për miratim në Kuvend, me qëllim të nxjerrjes së Kompleksit “Trepça” nga kompetencat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Sipas këtij projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, me propozim të Qeverisë, Kuvendi i Kosovës mund të marrë vendim që të heqë nga kompetencat Agjencisë Kosovare për Privatizim, ndonjë ndërmarrje shoqërore ose njësi të caktuar organizative të një ndërmarrje shoqërore, përfshirë asetet e tyre dhe të autorizojë Qeverinë që kjo ndërmarrje shoqërore, përkatësisht njësitë e caktuara organizative të një ndërmarrje shoqërore, t'i regjistrojë si ndërmarrje publike qendrore në pronësi të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Kosovës e merr këtë vendim nëse për një veprim të tillë ekziston interes madhor publik.

Po ashtu ky projektligj përcakton se me rastin e regjistrimit si ndërmarrje publike qendrore të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ndërmarrjes shoqërore, përkatësisht të njësive të caktuara organizative të një ndërmarrje, bëhen të drejta dhe detyrime ndërmarrjes publike qendrore, e cila që nga data e regjistrimit i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës që zbatohet për ndërmarrjet publike.

Me këtë rast, të nderuar deputetë duke pasur parasysh rëndësinë e “Trepçës” dhe me qëllim të krijimit të kornizës ligjore për rregullimin e ushtrimit të të drejtave pronësore në këtë ndërmarrje, në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare, ju rekomandoj aprovimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit, kush e ka fjalën se kryetari s’qenka këtu? Fjalën e ka deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Komisionit si nënkryetar i dytë, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë dhe Tregti, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 1.4.2014 shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të ndërmarrjeve publike dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë rekomandim.

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshim- plotësim të Ligjit për ndërmarrje publike. Komisioni vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e paraparë edhe nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe rekomandim këtë miratim në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Para se t’ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare, pasi u përmend Agjencioni Kosovar i Privatizimit, unë dëshiroj t’ju njoftoj juve deputetë edhe përmes juve edhe ata që na dëgjojnë se përgjegjësia për mos kompletimit të Bordit Agjencisë Kosovare - AKP-së nuk është e Kuvendit, Qeveria duhet t’i sjellë kandidatët në Kuvend për t’i votuar. Dhe, nuk është mirë të luhet me opinionin dhe gjithë problemi t’i hedhet Kuvendit.

Kuvendi me ligj i emëron ata, po pa i propozuar Qeveria, Kuvendi s’merret me propozimin e tyre. Ne para dhjetë ditësh kemi kërkuar nga Qeveria që t’i bie emrat për bordin e AKP-së, por ata deri më tani nuk kanë ardhur.

Në emër të Partisë Demokratike kush e do fjalën? Sala Berisha- Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Kabinet qeveritar,

Të respektuar minatorë të gjigantit “Trepça”,

Të gjithë ju që po na ndiqni nëpërmjet televizionit në këtë seancë,

Sot po e shqyrtojmë në parim plotësim- ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, ky ligj lidhet direkt me fatin e “Trepçës”. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës vlerëson se është jashtëzakonisht e rëndësishme që sektori mineral të zhvillohet, të krijohen politika më të mira dhe ligje më të mira, të cilat mundësojnë që ky sektor mineral i cili një kohë të gjatë ka qenë edhe mburrje e zhvillimit ekonomik të Kosovës, ka qenë ikonë e zhvillimit ekonomik, të vazhdojë edhe më tutje duke krijuar hapësirë për të zhvilluar ekonominë e Kosovës, por para se gjithash duhet të sigurojmë një infrastrukturë të mirë ligjore.

Andaj, Partia Demokratike e Kosovës përmes grupit të saj parlamentar vlerëson se ardhja e këtij ligji në Kuvend është një ngjarje e rëndësishme. Sot, në Kuvendin e Kosovës e kemi në shqyrtim një çështje shumë të rëndësishme për ekonominë dhe kahet se kah do të shkojnë pasuritë nëntokësore të Kosovës, respektivisht mineralet e plumb, zinkut, arit, argjendit dhe “Trepça” në veçanti.

Me të drejtë kompleksi “Trepça” cilësohet si thesar i Kosovës, andaj “Trepçën” duhet trajtuar më ndryshe nga ajo si është trajtuar deri më tani. Sot po e diskutojmë pra kahet që duhet të marrin pasuritë minerale, ato të plumb, zinkut përmes këtij kompleksi. Një dekadë më parë, të nderuar deputetë, ish-administrata ndërkombëtare e UNMIK-ut e kishte konsideruar “Trepçën” si dinozaur që i takon së kaluarës.

Por, më vonë u dëshmuar e kundërta që edhe sot me miratimin e këtij projektligji do të dëshmohej e kundërta e asaj që kishte thënë më herët administrata ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Është shkruar e debatuar shumë tash e 15 vjet për fatin e “Trepçës” si gjigant i madh mineral industrial. Është debatuar edhe në këtë Kuvend disa herë fati i kësaj ndërmarrjeje, janë prononcuar ekspertë të pavarur të “Trepçës” dhe të institucioneve akademike shkencore dhe emëruesi i përbashkët ka qenë që “Trepça” të largohet nga menaxhimi jo efikas dhe i paarsyeshëm i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Largimi i këtyre resurseve dhe kapaciteteve të “Trepçës” nga AKP-ja është hapi më i rëndësishëm dhe më i drejtë për t’i hapur rrugë “Trepçës” për ristrukturim, për t’i hapur rrugë “Trepçës” për të treguar veten si faktor i zhvillimit ekonomik, për t’i hapur rrugë zbutjes së madhe të papunësisë, për t’i hapur rrugë shtetit të Kosovës që të menaxhojë me pasuritë e veta.

Po ashtu, me rastin e transformimit të “Trepçës” si ndërmarrje publike që është synim i këtij draftligji, përveç që do të nis të promovohet dhe fillon një faqe e re e zhvillimit ekonomik, në të njëjtën kohë, do të hapen dyer për investitorë si vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë.

Jemi të bindur se draftligji do të krijojë kushte të lartë theksuara ku ky draft definitivisht “Trepçën” e shkëput nga AKP-ja dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, institucione këto të dëshmuara tash meqë ishin ngulfatëse të prosperimit të “Trepçës” dhe zhvillimit të saj.

Ky draftligj njëherë e përgjithmonë e ridefinon pronësinë e pasurive të “Trepçës”, e që të gjithë pajtohem se pronar i vetëm është shteti, respektivisht Republika e Kosovës. Në një formë apo tjetër kjo ka qenë dhe është kërkesë e niveleve menaxhuese të “Trepçës” dhe sindikatave të minatorëve të “Trepçës”.

Pra, të nderuar deputetë, të gjitha grupeve parlamentare, ju ftoj të votojmë në parim këtë projektligj, sepse edhe ashtu jemi vonuar, sepse ia kemi obligim ekonomisë së vendit, sepse ia kemi obligim “Trepçës” së djeshme, “Trepçës” së sotme dhe “Trepçës” së ardhme, ia kemi obligim të gjithë minatorëve të vjetër dhe të rinj që dhanë mund, djersë e gjak për t’u zhvilluar dhe ruajtur pasuritë në vendin tonë.

Patjetër që dua ta mbylli këtë fjalë me thënien e minatorëve: “me fat”.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Në realitet po duket që kemi pak një keqinterpretim edhe të ligjit edhe të asaj që është Ligj i “Trepçës”, Projektligji që është pru me asnjë dispozitë nuk e përcakton që ky është Ligji për “Trepçën”. Në realitet ne besojmë se kjo është një shmangie nga rekomandimet e Kuvendit, debatin që e ka thënë mbi “Trepçën” nëse konceptohet që kjo është Ligj për “Trepçën” në atë aspekt po flas, është një shmangie nga ajo që kemi biseduar për “Trepçën” dhe rekomandimet e Kuvendit që Qeveria ta sjell një Ligj për “Trepçën”.

Kështu që ky projektligji që sot po e diskutojmë, në realitet nuk është Projektligj për “Trepçën”, por është projektligj për çdo ndërmarrje publike, pavarësisht cila ndërmarrje publike i përket asaj.

Kështu që në këtë aspekt LDK-ja beson se duhet të insistohet edhe më tutje që Projektligji për “Trepçën” të vijë në Kuvend dhe si Kuvend të vendosim për çështjen e atij gjiganti ekonomik të Kosovës.

Sa i përket projektligjit janë dy çështje që duhet të ceken: e para ka të bëjë me definimin e interesit madhor publik, me projektligj nuk definohet se çka është interes i madhor publik, si do ta definojmë a ka vetëm aspektin ekonomik apo aspektin politik, apo aspektin ushtarak, a mbrojtës apo çka është ai interes madhor publik.

E dyta ka të bëjë me, në rastet kur merret një ndërmarrje e caktuar shoqërore nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, barten edhe të drejtat, obligimet kështu që duhet të kihet natyrisht jashtëzakonisht shumë kujdes për shkak se një ndërmarrje e caktuar, posaçërisht nëse barten në Qeveri edhe obligimet e asaj ndërmarrje i barten Qeverisë.

Derisa të jetë në AKP, kemi një kufizim, kemi një mbrojtje, themi si Qeveri apo si buxhet sa i përket trajtimit ndonjë ndërmarrje publike, por në momentin kur një ndërmarrje

shoqërore kthehet në ndërmarrje publike dhe i merr Qeveria gjitha obligimet e saj, themi se duhet të kihet një kujdes i shtuar.

Për fund, mendoj se ky është tani hapi i parë që duhet mendohet se si të trajtohet AKP-ja, vetë funksionimi i AKP-së, atë që kryetari e përmendi edhe në fillim me emërimin e bordit dhe tërë funksionimin dhe organizimin e AKP-së dhe në atë mënyrën e trajtimit tash e tutje të ndërmarrjeve shoqërore, në përputhje ndoshta me ndryshimet që do të bëhen në Ligjin për ndërmarrjet publike.

Natyrisht, edhe Grupi Parlamentar i LDK-së do ta votojë pro projektligjin, ndërsa do t'i mbajë rezervat e saj se projektligji nuk i plotëson të gjitha kërkesat apo të gjitha të priturat që i ka rekomanduar Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Në mbledhjen e datës 18 prill të vitit 2013, Kuvendi i Kosovës ka kërkuar nga Qeveria që në afat prej 90 ditësh të procedojë Projektligjin për “Trepçën”. Ky projektligj do të duhej t'i ishte paraqitur Kuvendit për shqyrtim më së largu deri më 17 korrik të vitit të kaluar.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për ta shndërruar “Trepçën” në ndërmarrje publike përmes amendamentimit të Ligjit për ndërmarrjet publike vjen me 9 muaj vonesë dhe në prag të zgjedhjeve të përkohshme parlamentare.

Një vit kohë janë shumë për 4 amendamente, por 4 amendamente janë të mjaftueshme për të lënë Kosovën 100 vjet mbrapa. Lëvizja “Vetëvendosje” në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, të datës 18 prill 2013, është përcaktuar që “Trepça” të kthehet në ndërmarrje publike.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për ta shndërruar “Trepçën” në ndërmarrje publike e zhvendos “Trepçën” nga rreziku i likuidimit që i kanoset aktualisht nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por njëkohësisht rrezikun e koncesionit dhe të privatizimit e sjell te Qeveria.

Pika 5, e memorandumit shpjegues që është dërguar në Kuvend së bashku me plotësim-ndryshimin e ligjit, tregohet qartë se synimi i Qeverisë është privatizimi i kësaj ndërmarrje.

“Trepça” është një aset kombëtar me një rëndësi të veçantë strategjike dhe kombëtare. Kuvendi i Kosovës nuk duhet të krijojë asnjë mundësi ligjore që çfarëdo Qeverie të ketë mundësi të abuzojë me “Trepçën” duke e shitur pjesërisht apo tërësisht atë. Për shkak të rëndësisë strategjike dhe ekonomike, Lëvizja “Vetëvendosje” insiston që “Trepça” të trajtohet si ndërmarrje e interesit të veçantë shtetëror dhe si e tillë të trajtohet përmes një ligji të veçantë.

“Trepça” duhet të shpallet me ligj e paprivatizueshme dhe të ndalohet koncesioni i saj përndryshe ajo do të përfundojë dhe do të përjetojë fatin e ndërmarrjeve të tjera që janë privatizuar në Kosovë. Vendimet për “Trepçën” duhet të merren me 2/3 e deputetëve e jo me shumicë të thjeshtë, siç thotë Ligji për ndërmarrjet publike.

Industria bazë e saj e që janë minierat, metalurgjia dhe industria kimike kërkojnë investime urgjente për t’u revitalizuar, këto pastaj do të paraqesin bazën e zhvillimit të industrisë së përpunimit të metalit.

Shteti duhet të marrë pjesë aktive në revitalizimin e këtyre degëve të industrisë së Kosovës për shkak të interesit afatgjatë që këto bartin për Kosovën. Asnjë prej këtyre çështjeve nuk është trajtuar nga Qeveria e Kosovës ose të paktën nuk kanë treguar se çka kanë ndërmend të bëjnë pas kthimit të saj në ndërmarrje publike.

Shndërrimi i “Trepçës” në ndërmarrje publike për t’i hapur rrugë privatizimit të saj është i papranueshëm për ne. Duke pasur parasysh se Kuvendi i Kosovës është para përfundimit të mandatit të tij, duke qenë të vetëdijshëm se Qeveria e Kosovës nuk ka asnjë plan për “Trepçën” së paku jo të publikuar deri tani, së paku jo të njohur për opinionin, me të drejtë shtrohet pyetja, pas këtij gjumi një vjeçar pse tani kjo nguti para zgjedhjeve?

“Trepça” do të kthehet në një ndërmarrje publike, por nuk duhet të trajtohet si të gjitha ndërmarrjet tjera. Ajo është e veçantë dhe ligji duhet ta trajtojë si të veçantë. Projektligji që ne e kemi para nesh duhet ta tërheqë “Trepçën” nga kthetrat e AKP-së, por duhet edhe t’i ndalojë Qeverisë çfarëdo veprimi tregtar me pasurinë kombëtare, pra para nxjerrjes së një ligji të veçantë për “Trepçën”. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Po shihet që ashtu sikur katër vjet më parë kur kryeministri Thaçi tha në katër vjetët e ardhshme Kosova do të jetë në NATO e në fakt në katër vjetët e qeverisjes së tij ne përfunduam në bankën e të akuzuarve si shtet, do të ndodhë edhe me këto veprime e tij fushateske, në fillimin e fundit të mandatit të tij që është lajm i mirë për Kosovën. Do të thotë, krejt çka po bën është krejt në fund edhe do të përfundojë së shpejti.

Edhe ky kamuflim për projektligjin i cili emrin e ka Ligji për ndërmarrjet publike, e këtu dalin deputetët e shumicës edhe flasin për Ligjin për “Trepçën”, në fakt është një përpjekje për të kamufluar. Ai s’është këtu për të na treguar çka është duke dashur të bëjë, po “ia ndien krismën”.

Grupi Parlamentar i Aleancës e përkrah në parim me të gjitha këto vërejtje, që u thanë edhe nga kolegët paraprakisht të partive opozitare. Prej leximit të parë deri në të dytin do të mundohemi për aq sa ka mundësi për t’u rregulluar ky ligj, mirëpo, po them lajmi i mirë është se është fillimi i fundit dhe nuk do të zbatohet nga Qeveria Thaçi. Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrin dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh se po ky Kuvend i Republikës së Kosovës dhe Grupi Parlamentar i LDK-së me një kërkesë të tyre, kanë kërkuar që... po ky Kuvend me një debat nga Grupi Parlamentar i LDK-së ka kërkuar që Qeveria të sjellë Ligjin për “Trepçën”, mirëpo në efekt Ligji për plotësim dhe ndryshim i ndërmarrjeve publike parasheh pikësëpari, që “Trepça” të shpallet ndërmarrje publike dhe pas shpalljes së ndërmarrjeve publike, besoj që do të vijë ligji shumë efektiv për “Trepçën”, se “Trepça” nuk mund të privatizohet, është e vërtetë.

“Trepça” është ndërmarrje e cila i takon qytetarëve të Kosovës dhe besoj që edhe pse jemi në vit zgjedhor, ia kemi obligim edhe minatorëve edhe Kosovës, që kjo ndërmarrje, gjiganti i Kosovës të hiqet nga kthetrat e AKP-së dhe të kthehet në ndërmarrje publike.

Është hapi i parë për “Trepçën”, ndërsa hapi i dytë për “Trepçën” do të jetë po ai ligj, të cilin e ka kërkuar zotëri Ferati me grupin e vet parlamentar dhe i është dhënë përkrahja po nga të gjitha grupet parlamentare në Kuvend të Kosovës.

Si Koalicion për Kosovë të Re do t’i japim përkrahje, se e dimë që minatorët e meritojnë një pagë më të mirë, e dimë që do t’i mbesin përgjegjësi të Qeverisë, në rast se hiqet “Trepça” nga AKP-ja, mirëpo edhe prapëseprapë në AKP-së çdoherë i kemi ndarë pare edhe me buxhet edhe nuk e dimë fort mirë, se ai raporti i auditorit nuk e nxjerr mirë edhe ashtu-kështu AKP-në.

Në parim do t’i japim përkrahje dhe besoj që brenda Komisionit Parlamentar, të gjitha sugjerimet e të gjitha grupeve parlamentare janë të mirëseardhura për arsye se “Trepça” është e Kosovës dhe nuk është e asnjë partie politike. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Në debatet e mëhershme ne, aktivistët e “Vetëvendosjes”, që jemi deputetë këtu, kemi shpjeguar dhe arsyetuar rolin e “Trepçës” në të kaluarën, vlerën aktuale të saj dhe rëndësinë jo vetëm socio-ekonomike, por edhe politike për të ardhmen.

“Trepça” e ndarë dhe Mitrovica e ndarë, nuk janë dy çështje as të ndara e as të ndashme. Mirëpo, te Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, së pari e kanë fshirë dispozitën sipas së cilës AKP-së i njihet e drejta, që për cilëndo ndërmarrje publike, e cila gjendet në listën e ndërmarrjeve publike, sipas këtij ligji mund të kërkojë që pjesa e cila do t’i takonte AKP-së si administruese e pronës shoqërore, të aneksohet nga lista e ndërmarrjeve publike.

Po ashtu, dispozita e nenit 3.4 vinte pengesa juridike, që cilado pronë të jetë transferuar në statusin e ndërmarrjes publike. Me këtë dispozitë i pamundësohej Qeverisë, që në çfarëdo forme të përvetësonte dhe ndërhynte në statusin e pronës shoqërore dhe atë përshtatshmërisht të përkthente në pronë publike, e cila në çfarëdo kohe do të mund t'i nënshtrohej procedurës së privatizimit të aksioneve.

Pra, kjo ishte dispozitë e cila ishte pengesë ligjore për çfarëdo transformimi të “Trepçës”, duke pasur parasysh se ajo ka status të veçantë të ndërmarrjes shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Dispozitat tjera, të cilat do të futen në nenin 11, me numrin rendor të paragrafit 3 dhe 4, përkufizojnë se me propozim të Qeverisë, propozim i cili nuk është saktësuar se në çfarë procedure do të merret, siç është rasti i vendimit për shitje të aksioneve, Kuvendi mundet që me një vendim, i cili merret me shumicë të thjeshtë, të heqë nga kompetenca e administrimit cilëndo ndërmarrje shoqërore të administruar nga AKP-ja apo cilëndo njësi të ndërmarrjes së caktuar.

Pra, Qeveria do të vlerësojë, zakonisht sipas tregut dhe kjo s'ka të bëjë me propozimin, të cilin e procedon para Kuvendit, ta marrë rrezikun për gjithë ndërmarrjen, por mjafton që këtë ta bëjë madje edhe për një njësi të vetme.

Në rastin e “Trepçës” kjo mund të ndodhë kështu: minierat, flotacionin, Fabrikën e pajimeve dhe atë të akumulatorëve ta regjistrojë secilën si shoqëri aksionare ndërmarrje publike të veçantë dhe të njëjtat t'i regjistrojë si shoqëri aksionare. Kjo nënkupton se lëre që po përgatitet privatizimi i njësive të caktuara të “Trepçës”, por edhe copëtimi i saj po bëhet gati, me qëllim të uljes së vlerës për t'u përgatitur shitja e aksioneve.

Edhe nëse në parim nuk do të ishte qëllimi i shitjes së aksioneve të këtyre ndërmarrjeve, duke qenë se do të regjistrohen si shoqëri aksionare, ato e fitojnë subjektivitetin e plotë juridik.

Si entitete juridike ato pastaj nuk do të detyroheshin që të kenë raporte kontraktuale me njësitë e tjera, por si ndërmarrje të veçanta mund të kontraktonin punën e tyre me cilëndo ndërmarrje tjetër. Për shembull, Fabrika e Akumulatorëve nuk do të ishte detyruar që për prodhimin e produkteve të saj të furnizohet me repromaterial nga minierat e “Trepçës”, edhe kjo njëjtë si ndërmarrje publike, por këtë furnizim mund ta bëjë me cilëndo ndërmarrje tjetër, e cila do ta furnizonte me lëndën e parë.

Kështu mund të shtyhen shumë njësi në falimentimin e tyre dhe në procedurën e falimentimit do t'u ulej shumë vlera, krahasuar me vlerën në treg.

Sa jam në dijeni, Kombinati “Trepça” ishte entitet unik legal, prandaj në qarkullimin juridik kombinati ishte i centralizuar dhe nuk mund të vepronin njësitë prodhuese në mënyrë të pavarur prej njëra tjetrës.

Duke qenë kështu, kombinati ruante zinxhirin prodhues duke nisur nga nxjerrja e xehes, përpunimi i saj në lëndë të parë si dhe përpunimi dhe prodhimi i produkteve finale që nxirreshin në treg.

I gjithë ky proces është bërë nën autoritetin e Kombinatit “Trepça” dhe jo në mënyrë të pavarur nga secila njësi. Për shembull, “Trepça-komerc” ishte njësi, e cila mbante kontabilitetin e gjithë Kombinatit. Ky ligj ka për qëllim dhënien e së drejtës që Qeveria me propozimin e saj dhe vendimin e Kuvendit, ta ndryshojë statusin e ndërmarrjes shoqërore në atë publike, prandaj edhe punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve do t’u mohohet e drejta në 20% të aksioneve.

Ne jemi të bindur që kemi nevojë për një ligj të ri për “Trepçën” i cili e bën “Trepçën” ndërmarrje publike të interesit të veçantë strategjik kombëtar, një ndërmarrje e cila do të lidhej drejtpërsëdrejti me Kuvendin e nuk do të vihej nën duart e Qeverisë e nuk kemi nevojë për një kesi ligji, i cili nuk e përmend “Trepçën”, në fakt tërë kohën e mendon e paramendon “Trepçën” dhe synimi i të cilit është që “Trepçën” ta bëjë shpejt e shpejt ndërmarrje publike, pasi që e copëton atë dhe, më pastaj ta privatizojë, ashtu siç ka bërë në këto 14 vitet e pasluftës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë,

Pra, siç u tha, pas votimit të Rezolutës nga ana e Kuvendit dhe e përkrahur nga shumica e deputetëve, me çka i është rekomanduar Ministrisë përkatëse, që të dalë me ligjin e veçantë për “Trepçën”, neve na vjen mirë që sot e kemi këtë propozim, që së paku si një shkallë e parë, si një fazë e parë definitivisht të shihet se “Trepça” do të dalë nga menaxhimi i AKP-së dhe se do të bëhen të gjitha veprimet, në mënyrë që “Trepçës” t’i sigurohet mundësia e autonomisë së veprimit, me çka gjithë ato rezerva nëntokësore, që i kemi dhe që vlerësohen, se në rast se shfrytëzohen në kapacitetin maksimal, ato do të jenë të mjaftueshme së paku për 100 vitet e ardhshme, që të krijojmë prodhime nga ato rezerva.

Dhe, sipas vlerësimit dhe të menaxhmentit po edhe të gjithë ekspertëve, vlerësohet se vetëm për fazën e parë trevjeçare nga aktualisht 16 mijë tonë, sa nxirret koncentrat, mund të shkohet në minimum 25 mijë deri në 30 mijë, çka nënkupton se flasim për dyfishimin e kapacitetit prodhues dhe në mënyrë proporcionale ajo ndikon, përveç në efektet financiare edhe në rritjen, pra në dyfishimin e të punësuarve nga 1 500 aktualë, në së paku 3 000, në të ardhmen.

Dhe, unë mendoj se kjo është forma më e mirë, që t’i kontribuohet gjithë atyre që u dhemb zemra për minatorët, ish minatorët pra, edhe minatorët aktualë, po jo vetëm për minatorët dhe ish minatorët, por edhe për fëmijët e tyre që të krijojnë një perspektivë.

Nëse është seriozisht kjo qasje dhe shpejt krijohen mundësitë për “Trepçën”, pra duke nënkuptuar edhe shfrytëzimin me kapacitet të plotë në minierat dhe flotacionin pra Stari Tërg, Tunel i Parë, si dhe Artanë dhe Kishnicë, por edhe kapacitetet e tjera, unë mendoj se atëherë me këtë ne do të arsyetojmë përkushtimin tonë që më në fund t’i kthehemi zhvillimit ekonomik, ngase deri tash shihet afiniteti ynë për ta shpenzuar paratë e buxhetit dhe paratë nga taksat, që vështirë grumbullohen nga qytetarët tanë. Dhe, më në fund, kjo është një hap i parë dhe i mirë, se ne do të fillojmë ngadalë me ditë, me u mësua, se si kursethet buxheti dhe si krijohen parakushtet për zhvillim duke u bazuar fillimisht, në resurset natyrore që ka ky vend, por edhe aftësinë dhe kreativitetin ndërmarrës që kanë shumica e kosovarëve.

Prandaj, përveç fillimisht, shfrytëzimit të këtyre kapaciteteve, unë mendoj se është shumë reale të pritet se pas rregullimit me ligj të statusit të “Trepçës” pastaj përgjegjësitë dhe detyrat e “Trepçës” do të jetë e mundshme që të vihen në funksion edhe disa kapacitete shumë fitimprurëse, por që për momentin kanë pengesë. Në rend të parë, pra shkrijetorja ose Elektroliza e Zinkut, ashtu siç quhet me terminologjinë më adekuate, zink-pluhurit dhe kapacitetet tjera dhe në kompleksin e “Trepçës”, por edhe në minierat tjera që e rrethojnë.

Kështu që, edhe njëherë, më vjen mirë që kjo është proceduar sot, sado që jo me ligj të veçantë, me një definim detaj të detyrave dhe përgjegjësisë, por së paku që me këtë do të hapet mundësia që “Trepça” pastaj të aktualizohet me vendimet çfarë parashikohen në Qeveri, Kuvend, menaxhment. Dhe, të shpresojmë se shumë shpejt, ndoshta jo brenda muajit, po brenda pak muajve t’i jepet mundësia që duke e pasur këtë bazë ligjore, njerëzit që janë profesionistë ta krijojnë një strategji, të cilën strategji do ta bëjnë publike dhe saktësisht njerëzit të shpresojnë se nuk ka nevojë, që të mbyten në lumin Tisa duke ikur nga Kosova, por të qëndrojnë aty se me kesi përkushtimi vijnë ditë më të mira për Mitrovicën, për minatorët, po dashtë Zoti edhe për Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Sala, çka do të shtosh?

SALA BERISHA-SHALA: Kryetar, në emër të grupit fola, ndoshta tash i kam të rezervuar dy minuta edhe në emrin tim personal, në qoftë se më lejohet.

E para, unë kisha dëshiruar që në temat e tilla të rëndësishme ta bëjmë si kulturë, që të na afrojnë neve si deputetë të Parlamentit të Kosovës, pavarësisht nga cilat parti politike jemi. Dhe, mua më vjen mirë që zoti Ferati, që vjen nga Mitrovica e ka kuptuar shumë drejt rëndësinë e këtij plotësim-ndryshimi të këtij ligji.

Mendoj, që ka kuptuar drejtë, sepse është për çdo ditë bashkë me ata minatorë dhe me ata qytetarë, të cilët e kanë pritur një ndryshim të tillë, pavarësisht se Grupi Parlamentar i LDK-së, më duket që nuk e mbështeti ligjin, por besoj se do ta votojnë tani.

Tani më lejoni edhe diçka, mua më vjen keq se dikush ka mungesë informacionit edhe lidhur me ligjin. Më lejoni të lexoj nga memorandumit shpjegues i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Çështjet kryesore të trajtuara, kjo le të jetë më shumë për opinionin publik që na përcjell, sepse deputetët i kanë materialet, secili. Çështjet kryesore të trajtuara në këtë projektligj kanë të bëjnë me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, krijimi i bazës juridike, që me vendim të Kuvendit të Kosovës të hiqen nga kompetenca e AKP-së ndërmarrje të caktuara shoqërore, ose njësi të caktuara organizative të një ndërmarrje shoqërore dhe këto të regjistrohen si ndërmarrje publike në pronësi të Republikës së Kosovës. Në rastin konkret të "Trepçës" kjo bazë ligjore mundëson që njësitë e caktuara të "Trepçës", si për shembull, minierat dhe flotacionet të ndahen nga ndërmarrja shoqërore "Trepça" dhe të shndërrohet në ndërmarrje publike të formës së shoqërisë aksionare me pronar Republikën e Kosovës. Njësitë tjera të "Trepçës" mund të mbesin në ndërmarrje shoqërore "Trepça". Ndaj secilës mund të vazhdojë procedura e riorganizimit pranë Dhomës së Posaçme.

Në këtë drejtim kanë punuar me vite të tëra ekspertë të kësaj lëmit dhe më herët veç i kanë ndarë në asetet kore dhe astetet nën kore. Këtu kemi mungesë të informacioneve nga deputetë apo nuk duan ta pranojnë një avancim të tillë, që më vjen keq, për hir se i ka takuar kësaj Qeverie që e ka pasur fatin që t'i bëjë këto ndryshime shumë kolosale edhe në segmentin e ekonomisë.

E sa i përket një koleges sime që shprehet shumë skepticiste po ia përkujtoj se Kosova ka marrë statusin e vëzhguesit në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, me gjithë skepticizmin e disa shteteve që nuk ia duan të mirën Kosovës dhe skepticizmin e një pjese të opozitës, e cila nuk do të pranojë kurrë, tani pritet të bëhet publike në qershor ky vendim.

Unë, edhe njëherë ju ftoj të nderuar kolegë deputetë, ta votojmë këtë plotësim-ndryshim të këtij ligji, sepse do të përfitojmë të gjithë, mbi të gjitha do të përfitojnë minatorët e "Trepçës", do të përfitojë zhvillimi ekonomik i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri po dëshiron të thotë diçka në fund të debatit.

MINISTRI FADIL ISMAILI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë jam i bindur se të gjithë deputetët e kanë të qartë se ligji është quajtur Ligji për "Trepçën" ajo nuk përmendet, por në esencë është Ligji për "Trepçën", sepse është draftuar dhe shkruar për ta bërë të mundur një vendim, për të bërë të mundur vendimin për "Trepçën" dhe... urdhëro, po ligji e ka plotësim ndryshimi për Ligjin për ndërmarrjet publike, mirëpo vetëm në ndryshim të këtij ligji bëhet i mundur. Edhe Ligji për "Trepçën" në gjuhë popullore po është Ligji për "Trepçën". Pra, pa e votuar këtë ligj nuk mund të nxirret "Trepça" nga AKP-ja.

(Debat në sallë.)

(Ndërprerje e incizimit.)

KRYETARI: Ministri e kreu, e mbylli. Tash diskutimet u harxhuan. Kemi 63 deputetë. Shkojmë votojmë. Regjia bëhuni gati dhe ju deputetë bëhuni gati të votojmë në parim ligjin që e dëgjuat. A ta lexoj edhe njëherë titullin se çka u diskutua deri tash?

Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike. A e keni të qartë? Mirë, votojmë tash.

Me 45 vota për, 10 kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin nr. 04/L-270 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

Ministri nuk është këtu, veç nëse e merr ministri i Arsimit. Nuk e kanë, nuk e di... atëherë komisioni, a e merr përgjegjësinë komisioni? Jo.

Mirë, s'ka të drejtë. E kapërcejmë. S'është. Mirë!

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin shëndetësor

Sa deputetë i kemi këtu? Vazhdojmë. A i kemi numrat? 61 deputetë, 62, 63, mirë, u kthyen, 64 u bënë.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për sigurimin shëndetësor dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari s'ka nevojë të flasë dhe vazhdojmë me amendamentimin. Kemi gjithsej 79 amendamente dhe të gjitha janë të Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 25

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 26

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 27

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 28

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 29

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 30

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 31

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 32

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 33

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 34

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 35

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 36

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 37

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 38

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 39

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 40

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 41

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 42.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 43

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 44

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 45

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 46

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 47

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 48

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 49

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 50

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 51

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 52

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 53

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 54.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 55

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 56

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 57

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 58

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 59

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 60

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 61

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 62

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 63

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 64

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 65

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 66

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 67

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 68

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 69

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 70

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 71

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 72

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 73

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 74

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 75

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 76

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 77

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 78

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 79

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Të pranishëm janë 64 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-249 për sigurimet shëndetësore.

9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuesja e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media është deputetja Teuta Haxhiu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne si grup punues, në kuadër të Komisionit, pra ka një vit që kemi filluar monitorimin e Ligjit të arsimit të lartë, me qëllim që të ndikojmë pra në plotësim-ndryshimin e Ligjit që sot ka ardhur.

Pra, edhe një herë, që në fillim e kemi përmendur se ka qenë mirë që së pari të diskutohet pra monitorimi - raporti i monitorimit, pastaj të vjen në shqyrtim edhe Ligji i arsimit të lartë.

Megjithatë, Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit bëri mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 04/L-037 për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2014 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime:

I rekomandohet Kuvendit që të miratojë Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, pra për Administratë Publike, me rekomandimet në vijim:

1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më së voni më 31 gusht t'i ofrojë Kuvendit një përmbledhje të raporteve për performansën e çdo bartësi publik të arsimit të lartë që merr fonde publike.
2. Këshilli Shtetëror i Cilësisë, çdo vit t'i raportojë Kuvendit lidhur me aktivitetet e akreditimit, dhe
3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të ndërmarrë masa ndaj bartësve privatë të arsimit të lartë të cilët përdorin emërtimet e tyre në kundërshtim me Ligjin për arsimin e lartë.

Andaj, i ftoj të gjithë deputetët që ta përkrahin raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar Raportin për monitorimin e Ligjit për arsimin e lartë dhe sigurisht që shumica e rekomandimeve të cilat i lexoi kolegja janë pjesë e kërkesës për ligjshmëri, kërkesës për të vendosur ligjshmëri, mirëpo tash si duket është "kofini pas të vjelave" pasi të gjitha ato u thanë gjatë diskutimeve për ligjin për Projektligjin e arsimit të lartë.

Dhe, si duket, edhe hartimi, do të thotë edhe rendi i ditës kur është hartuar është bërë pak gabim, pra është të diskutojmë më herët për këtë çështje, mirëpo disa vërejtje të cilat unë më herët i dëgjova gjatë diskutimeve për Projektligjin e arsimit të lartë mendoj që nuk ishin korrekte nga një pjesë e kolegëve të opozitës për arsye se kemi qenë bashkë në monitorim dhe ne kemi marrë ato vërejtje, por kemi dhënë edhe fjalë edhe kemi dhënë shpresa se ne do t'i përmirësojmë disa gjëra dhe këtu u bën kritika të cilat nuk i takojnë pra që t'i adresohen vetëm një grupi politik.

Konkretisht do të ndalem vetëm tek bordet e institucioneve publike të themeluara rishtazi ku personalisht kam pa anëtarë të bordeve të cilat u takojnë subjekteve politike të ndryshme, pra nuk janë vetëm as adhurues as votues të njërit subjekt politik.

Po ashtu tek vërejtjet që i kemi marrë edhe vizitën në Agjencinë e Akreditimit, ne kemi dalë me sugjerim që Agjencia e Akreditimit ta ketë një ligj të vetin dhe realisht ai ishte veç duke u hartuar, pra të gjitha rekomandimet janë pjesë të cilat edhe janë përfshirë në ligjin e ri.

Ne do të votojmë dhe mbështesim sigurisht këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Sadri Ferati e ka fjalën. Duhet ta kemi ndërmend, se ne si Kryesi nuk kemi gabuar. Ligji është lexuar më parë, tash janë rekomandimet dhe rekomandimet le t'i marrë Komisioni dhe t'i inkorporojë në ligj. Kurrfarë gabimi këtu s'është bërë, po mësonu të flisni për rendin e ditës dhe për çështjen që e keni përpara.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe unë isha pjesë e një grupi nga Komisioni FunkSIONAL, isha pjesë edhe e kontakteve, diskutimeve dhe vizitave. Dhe përveç rekomandimeve që ne si Grup Parlamentar do t'i përkrahim dhe votojmë, vërtet kemi pasur mundësinë që të njoftohemi nga afër edhe me shumë çështje që nuk janë pjesë të rekomandimeve, duke filluar nga kushtet në të cilat veprojnë, do të thotë, universitetet, pastaj nga shumë çështje që lidhen e që u thanë në pjesën e parë nga një funksionalizim më i shpejtë, do të thotë, i buxheteve, pastaj një mundësi e planifikimeve afatmesme të buxheteve të universiteteve dhe çështjeve tjera.

Pra, meqenëse edhe në pikën e parë, duke u bazuar pikërisht edhe në përvojën e monitorimit të ligjit, ne kemi dhënë ide pak më herët se çka duhet të ndryshojë në ligj në mënyrë që disa çështje të përfshihen, e që kanë qenë shqetësim edhe i vetë, pra gjatë këtyre vizitave.

Në grup nuk ka qenë diskutimi i përbërjeve politike të këshillave, po edhe po të kishte qenë për mua është e papranueshme të thuhet se krejt janë të mitë, po qenka edhe një i yti. Është e papranueshme kjo çështje, sepse asnjëherë kjo nuk e justifikon qëllimin primar që ne të kemi këshilla funksionale të fuqishëm profesional, prandaj për fund them edhe një herë që ne jemi reduktuar në këto formulime edhe pse ka mund këtë edhe çështje tjera, dhe ne i përkrahim dhe do t'i votojmë këto formulime me shpresën se shumë adresime, shqetësime nga këto vizita do të mund të inkorporohen në mes të dy leximeve tek Ligji për arsimin e lartë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues.

Dhe, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Edhe ne si Lëvizje e kemi shqyrtuar Raportin e Komisionit parlamentar për Arsim lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe si të tillë e përkrahim këtë raport.

Natyrisht ky raport ka mund të jetë edhe më i plotë për të hulumtuar sferën e arsimit të lartë, mirëpo sidoqoftë edhe këto gjetje që janë konstatuar përbëjnë disa shqetësime serioze.

Është shqetësuese mënyra se disa nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, e përdorin për shembull emrin universitet, edhe përkundër faktit se konditat institucionale brenda të cilave ushtrojnë veprimtarinë e tyre bien në kundërshtim me definimin ligjor për universitetin.

Pra kjo logjikë për të shënuar çdo godinë apo ndërtesë me emrin universitet duket sikur paraqet të kundërtën e kësaj strukture institucionale.

Po ashtu shqetësim paraqet edhe indolenca e Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe shpërfillja që ka treguar ndaj Kuvendit të Kosovës, përkatësisht Komisionit parlamentar për Arsim për ta informuar dhe raportuar me shkrim lidhur me punën e këtij institucioni i cili ndoshta është më i rëndësishmi në vend për nga detyrat e definuara si një mekanizëm që vlerëson cilësinë dhe akrediton bartësit e arsimit të lartë si publik ashtu edhe privat në vend.

Çështje tjetër me rëndësi që vlen padyshim të diskutohen, mbeten edhe shqetësimet lidhur me kushtet për studim në Universitetin e Prishtinës. Këto deficite janë treguar atëbotë edhe na autoritetet e atëhershme menaxheriale të këtij institucioni që në masë të madhe

kushtëzohen nga limitet financiare që e pamundësojnë punën e mirëfilltë akademike në UP.

Rrjedhimisht si pasojë e kësaj gjendjeje ky institucion është përballur dhe po vazhdon të përballlet me mungesë të stafit akademik në përputhje me numrin e studentëve, mungesë të literaturës së duhur shkencore, mungesë të punës kërkimore, detyrë kjo kryesore që ndoshta duhet ta ketë një institucion i cili pretendon ta ketë emrin universitet.

Brengosës mbetet edhe fakti se si Ministria e Arsimit nuk ka arritur që brenda afatit të duhur ligjor të plotësojë infrastrukturën ligjore, sikur se janë aktet nënligjore që do ta bënë të mundur zbatimin e ligjit. Po ashtu edhe detyrat që i ka pasur kjo Ministri për t'i ofruar Kuvendit të Kosovës një përmbledhje të raporteve dhe performansën e bartësve publikë të arsimit të lartë e që nuk ka bërë, flet për një shpërfillje serioze institucionale ndaj Kuvendit.

Marrë parasysh këto fakte, ne si Lëvizje e miratojmë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Më vjen keq që nuk është kryetari këtu. Më duhet edhe një herë t'ua sqaroj juve si kryesi e nderuar e Kuvendit, ju kenë bërë gabim gjatë renditjes së pikave të rendit të ditës, jo ne deputetët.

Prapë po e them dhe kjo është logjikë e thjeshtë. Pra gjatë monitorimit që e kemi bërë nëpër institucione të zbatimit të Ligjit të arsimit të lartë, të gjitha institucionet janë të shënuara në raport, unë nuk dua t'i mendoj deputetët, por megjithatë dua t'i përmend dy çështje shumë të rëndësishme që mendoj se i ndihmojnë shumë, do të thotë, edhe bërjes së ligjit, por njëkohësisht edhe funksionimit të drejtë të universiteteve, konkretisht të institucioneve të arsimit të lartë.

Së pari e përmendëm edhe një herë Agjencinë për Akreditim, edhe një herë më duhet ta përmendi. Përbërja e kësaj agjencie duhet të diskutohet, pastaj nuk duhet të jenë njerëzit që mendoj, mendoj po e them, që kanë konflikt interesi. Pastaj njerëz të pa përgjegjshëm brenda atij Agjencisë, ku vetë drejtori i asaj Agjencie, zoti Muja, gjatë vizitës që kemi pasur ne si Komision, kur ne e kemi pyetur se çfarë funksioni tjetër kryen zoti Muja, ai na është prononcuar se është edhe këshilltar i jashtëm i ministrit të Arsimit.

Prandaj edhe kjo është për mua një shqetësim që vetë zoti Muja, i nderuar ministër, e ka potencuar këtë. Janë të gjithë anëtarët që kanë qenë bashkë me mua në vizitë dhe që mund ta konfirmojnë.

Një çështje tjetër që në Agjenci, ne e kemi pasur një shqetësim që po e ngre vazhdimisht dhe edhe tani po e ngre, që institucionet private të arsimit të lartë kanë bërë shkelje të ligjit, po e përmend edhe një herë për të satën herë, kolegji AB, që edhe sot e kësaj dite

prapë bën shkelje të ligjit duke kamufluar mbishkrimin “institucion të arsimit të lartë” Askund, zoti ministër në Ligjin e arsimit të lartë nuk është ky mbishkrim, ky emërtim. Prandaj, këtu janë mbyllur sytë vazhdimisht, sot e kësaj dite prapë e kam përmendur sa herë janë autobusët me reklama që nuk janë hequr, sot e kësaj dite janë adresat elektronike UNI që thjesht prapë nuk janë përmirësuar dhe ai emërtim sot si institucion i arsimit të lartë nuk figuron në ligj, prandaj prapë është shkelje e ligjit.

Gjithashtu në Agjencinë për Akreditim kur ne kemi pyetur, kemi ngritur një shqetësim se a ka programe pra në institucionet private të arsimit të lartë që janë të akredituara për edukim, prapë zoti Muja na është përgjigjur se asnjë nga këto programe në agjencitë private nuk është i akredituar për edukim.

Këto janë ato që ne i kemi marrë nga zoti Muja në agjenci, prandaj unë them që prapë ka shkelje të ligjit.

Gjithashtu një shqetësim shumë të madh që e kemi hasur nëpër fakultete, pra nëpër universitete të reja që ata kanë kërkuar që të kenë pavarësi financiare dhe thjeshtë të jetë pra një decentralizim financiar, sepse janë kërkesat shumë minimale të cilët ballafaqohen pra thjeshtë me shumë vështirësi në këtë drejtim, çka u shkaktojnë edhe shumë probleme.

Mirë është që të mendojmë konkretisht edhe për fakultetet private, universitetet private që thjeshtë unë jo vetëm pse vi nga Gjakova, por të gjithë anëtarët që kemi qenë aty me të vërtetë jemi mirëpritur dhe njëkohësisht kemi pasur një pasqyrë shumë reale, edhe pse universitet i ri, por me një punë të përgjegjshme çka unë uroj që të gjitha fakultetet e tjera të kenë pra një punë serioze sikurse po ndodh në Universitetin e Gjakovës.

Megjithatë edhe në Universitetin e Prizrenit kemi pasur disa kërkesa jashtë pavarësisë financiare që është kërkuar edhe aty edhe rreth kuadrit të përzgjedhur, pra që na është thënë që kanë pasur shumë probleme për shkak të moshës që është me statutin e Universitetit të Prishtinës, që ne do të mundohemi që me ligj pra ta rregullojmë këtë çështje.

Unë edhe një herë them, ne kemi bërë monitorim e Ligjit të arsimit të lartë, po i përmendim shkeljet e ligjit, uroj që të ketë edhe institucione private ose jo publike, si doni të themi, që thjeshtë janë konkurrent, por konkurrent të mirëfilltë, konkurrentë real, pra le të ketë konkurrencë, por mos të bëhet shkelje e ligjit, sepse qytetarët po e vuajnë, ministër, po e vuajnë me diploma, të cilët edhe sot e kësaj dite shpeshherë na pyesin a janë të akredituar apo nuk janë?

Prandaj është mirë të shikohet pikësëpari vetë agjencia, të jetë më e përgjegjshme, t’i raportojë Kuvendit, sepse e ka me ligj dhe asnjëherë nuk i ka raportuar dhe dihet ministër pra se kush i ka përgjegjësitë, çfarë i ka Ministria, cilat janë të Agjencisë dhe thjesht të punohet në drejtim që interesi i të gjithëve besoj, pa parti politike, është që ta shohim arsimin jo vetëm në retorikën politike si shtyllë e një shteti, por thjeshtë të punojmë që ta bëjmë një arsim cilësor për t’u mburrë edhe me vendet tjera, pse jo në rajon dhe në botë. Faleminderit!

KRYESUESI: E ka fjalën zoti Svirca, në emër të Koalicionit për Kosovë të Re.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të re do t'i përkrahë rekomandimet e dala nga kjo mbikëqyrje e Ligjit për arsimin e lartë.

Unë kam qenë pjesë e grupit punues. Kemi marrë informacione bajagi të detajshme nga akterët të cilët i përfshin ky ligj dhe besojmë se informatat të cilat i kemi marrë do të na shërbejnë që ligjin e ri ta bëjmë sa më të zbatueshëm.

Shpresoj se edhe këto tri rekomandime të prezantuara këtu të zbatohen nga ana e Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Buja.

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Nënkryetar,

I nderuar koleg ministër,

Të nderuar deputetë,

E nderuar kryetare e këtij grupi për monitorim të ligjit,

Nuk është vetëm Universiteti i Gjakovës që është mirë, është edhe Universiteti i Gjilanit, edhe Universiteti i Mitrovicës, siç e festoi vetëm njëvjetorin e lindjes së tyre dhe janë shumë mirë për pozicionin që e kanë. Dhe, natyrisht që këtu po ju kujtoj se janë mirë të tria dhe mua më inkurajojnë shumë, por duhet të them edhe një fakt tjetër se me ligjin e vjetër që tani po e amendamentojmë dhe po e përplotësojmë, besojmë që ta bëni më mirë se që ishte. Agjencia dhe Ministria kanë paqartësi të mëdha dhe për këtë fakt edhe është nisur amendamenti i këtij ligji, sepse në fakt agjencia ka pavarësi të plotë dhe edhe kur akrediton institucione të caktuara private a publike të arsimit të lartë, merr vendim vet dhe Ministrinë vetëm e njofton.

Këtu duhet ta keni parasysh, ju duhet ta shihni tash këtë raport Agjenci – Ministri ose Ministri - Agjenci që ta qartësoni akoma më shumë, sepse ata marrin vendime për këtë gjëra, dhe kaq, Ministria dhe ministri vetëm njoftohet.

Dhe, për të qartësuar akoma më shumë këtë gjë, të nderuar deputetë, Ligji për arsimin e lartë orienton zhvillimin e arsimit të lartë drejt integritetit të plotë në zonën evropiane të arsimit të lartë siç mund të jeni në dijeni, besoj edhe komisioni që e ka bërë këtë punë të mbikëqyrjes e din që kemi formuar tanimë një komision për të përgatitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm duke pasur ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë për aderim në Bolonjë, në vitin që vjen dhe punët kanë shkuar mirë.

Por, plani strategjik i arsimit të Republikës së Kosovës, 2011-2016 mbështet rritjen e pjesëmarrjes në arsimin e lartë, cilësinë e arsimit sipas standardeve ndërkombëtare, harmonizimin e arsimit me nevojat e tregut, bashkëpunimin Akademi industri, mobilitetin

e stafit akademik dhe mobilitetin e studentëve, arsimimin e grupeve të marginalizuara dhe çështje tjera.

Synimi për realizimin e këtyre qëllimeve strategjike po vazhdon të arrihet me punën e përbashkët të institucioneve të themeluara nga MASHT-i dhe Qeveria si Agjencia për Akreditim, ato që i paraflës, Qendra për njohje, barasvlerë dhe informim akademik, që njihet me shkurtësën RAIK, autoritetit kombëtar të kualifikimeve me përgjegjësi për zbatimin e kornizës kombëtare të kualifikimeve dhe zhvillimin e vazhdueshëm të standardeve profesionale.

Të nderuar deputetë,

Ligji për arsimin e lartë dhe udhëzimet administrative të dala nga ky ligj janë garanci për arrijten e synimeve tona të përbashkëta. MASHT-i por edhe grupet e interesit kanë vërejtur disa mangësi në këtë nivel, siç e keni vërejtur edhe ju, të cilat na kanë penguar dhe në përmbushjen e obligimeve 100% të realizimit të udhëzimeve administrative për faktin se çështja është që implikohet edhe në ministritë e tjera, dy-tri ministri tjera andaj kjo është një çështje që ka penguar përndryshe nga 11 udhëzime, 8 janë të realizuara tanimë, ndërsa 3 është pengesë për shkak të implikimit edhe të ministrive tjera.

Për këtë fakt edhe u iniciua procedura për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit që e patëm në diskutim. Ministria i është përgjigjur Komisionit funksional në mënyrë të rregullt, në raportimin në mbledhjet e Komisionit si dhe ka ofruar bashkëpunimin, pa rezervë, siç e dini edhe ju për të gjitha çështjet për të cilat komisioni është i interesuar si në mbledhje ashtu edhe në vizitat në ministri dhe vizitat tjera.

Së bashku me komisionin janë diskutuar edhe mundësitë për ngritjen e nivelit të përgjegjshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë, në raportime që duhet t'i bëjmë, goftë në Kuvend, ashtu edhe në Ministri.

Mos të ju lodh më shumë, po ju them se sa i përket pikës 3 të rekomandimit, ajo tanimë është e realizuar për faktin se ne kemi çuar inspektoratin jo një herë dhe tani më janë proceduar ato institucione të arsimit të lartë privat që po e keqpërdorin emrin që s'e kanë dhe kjo procedurë do të prodhojë shpejt besoj, dhe kjo pikë është shteruar besoj, sepse e kemi realizuar atë, ndërsa dy rekomandimet e para me shumë respekt do t'i analizojmë për t'i përmbushur dhe respektuar, por me gjithë kërkesën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që raportet e obligimit ligjor që i kanë institucionet, akoma s'i kanë sjell asnjëherë, për fatin e keq, dhe tash kanë premtuar që do t'i sjellin dhe ne më 31 gusht kur ju përcaktoni, besoj se do të jemi në plotësi të realizuar.

Kështu që fare në fund po ju them se ato që u thanë në diskutim për ligjin dhe për plotësimin e tij dhe amendamentimin, unë jam edhe një herë po e përmend që mos të bëjmë amendamente dhe nene që diskriminojnë publikët nga privatët ose privatët nga publikët, por t'i barasvlerësojmë dhe t'i baraspeshojmë dhe vlerësojmë ashtu si duhet, sepse Agjencie Kosovare e Akreditimit e bën akreditimin, Ministria licencimin dhe përse ata të ndjehen ndryshe nga të tjerët, por aktualisht, kjo ekziston. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e raportit. Konstatohet se në sallë janë 62 deputetë.

Të nderuar deputetë, bëhuni gati për votim dhe votojmë tash.

E përsëris votimin edhe një herë. Votojmë tash!

Jo, nuk miratohet. Janë 56 vota dhe nuk miratohet.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë si propozues të çështjes. Kush është? Nuk ka...

(Ndërhyrje)

Unë mund ta qes në votim propozimin tënd, nëse mendon, ose nëse duhet të na shpjegosh diçka më shumë për këtë.

(Ndërhyrje)

Nëse doni, e lëmë për nesër, e shtyjme krejt seancën, ose e lëmë këtë si pikë.

(Ndërhyrje)

A e ke fjalën për këtë pikë të rendit të ditës apo po për të gjitha?

(Ndërhyrje)

Në rregull, nëse dy grupet e mëdha janë dakord, atëherë e lëmë që nesër në orën 10:00 ta vazhdojmë seancën.

* * *

E premte, 11 prill 2014

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 10 prill

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 10 prill 2014.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë, por është numër i pamjaftueshëm për ta votuar edhe një herë Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovës nëpërmjet e-edukimit”.

Është mirë që kryetarët e grupeve parlamentare ta arrijnë numrin 80, në mënyrë që të shkojë kjo marrëveshje.

Por, ne vazhdojmë. Seanca është në vazhdim, Teutë! Por, duhet lajmëruar arsyen pse po e kërkon fjalën.

Votimi i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Jo! Jemi në vazhdim të seancë dhe nuk ka fjalë më për asgjë. Vazhdimi i seancës vazhdon, diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi me votim është shtyrë.

Edhe kjo pikë e rendit të ditës, për shkak të mungesës së komuniteteve, bie.

(Reagime nga salla.)

Jo, jo, është kryer ajo!

A po merrni vesh, ajo pikë është kryer dhe asnjë fjalë për atë pikë të rendit të ditës!

(Reagime nga salla.)

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kinematografinë

Ministri nuk është këtu, ky ligj i kthehet Qeverisë dhe kur ata të bëhen gati pas nja 3-4 muajve mund të vijë në rend të ditës.

Jo, realisht nëse dikush duhet ta mbrojë ligjin, do ta mbrojë Qeveria. Ministri duhet të vijë këtu, ose ta ngarkojë një ministër të Qeverisë për ta mbrojtur ligjin. Por, ky Kabinet qeveritar, kështu siç po sillet me ligje dhe me seancën, ai ministër nuk meriton më të vijë të ulet në këtë sallë.

(Reagime nga salla.)

Ai sqarim u krye!

10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013

Komisioni Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Ramë Vataj, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2014, e shqyrtoi raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013 dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Që të miratohet raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013.

Në bazë të nenit 19 të Ligjit numër 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ia paraqet raportin vjetor të punës Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars e shqyrtoi këtë raport për vitin 2013 dhe vlerësoi se raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe ia rekomandon Kuvendit miratimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Pavarur, të pranishëm këtu,

Po e shqyrtojmë sot raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës si një agjenci e pavarur kushtetuese dhe më vjen mirë që sot në këtë raport, i cili është edhe më voluminoz, do të vlerësojmë që raporti e ka një përmbajtje dhe është shumë i pasur me informacione të selektuara dhe shumë të qarta për ne deputetët për ta kuptuar drejt gjithë performansën e tij.

Fillimisht theksoj se Grupi ynë Parlamentar e ka analizuar këtë raport dhe e vlerëson punën profesionale të këtij këshilli.

Ndërsa unë si anëtare e Komisionit FunkSIONAL e kam pasur rastin që këtë staf dhe anëtarët e bordit t'i shoh në vendin e tyre të punës, pasi me kërkesën e tyre ne si komision i kemi vizituar muajin e kaluar.

Fillimisht, e admiroj faktin që ky këshill ka shpenzuar 93% të buxhetit të paraparë dhe mendoj se në bazë të rubrikave të paraqitura lidhur me këtë menaxhim shihet se ky këshill ka punuar mjaftueshëm për të qenë edhe shpenzues i arsyeshëm.

Ky këshill e ka treguar performansën e vet vërtet si i pavarur dhe është një shembull i mirë i punës profesionale dhe të përgjegjshme.

Gjatë vitit 2013 ka pranuar 29 ftesa për vizita vëzhguese në procesin e monitorimit të emërimit të nëpunësve civilë në nivelin drejtues, mbi bazën e të cilave organet e punësimit kanë kërkuar që të vëzhgohen 38 pozita të nivelit drejtues.

Pas kësaj procedure, të cilën e ka edhe pjesë e misionit si këshill për pozitën e nivelit drejtues nga këshilli gjatë vitit 2013 janë nxjerrë 38 vendime përfundimtare, prej tyre 34 vendime përfundimtare të aprovuara si të rregullta.

Këshilli gjatë monitorimit të institucioneve ka vërejtur se planifikimi, programi dhe strategjia e trajnimeve të nëpunësve civilë nuk është në nivelin e nevojave për trajnim dhe zhvillimit profesional të personelit.

Mendoj se në këtë drejtim, vërejtjet e këshillit të të gjitha institucioneve duhet t'i marrin me seriozitet të plotë, sepse nëse ne si shtet nuk e kemi një administratë profesionale dhe të trajnuar në bazë të nevojave, nuk e kemi pastaj të qartë rrugën tonë drejt proceseve integruuese evropiane.

Ky këshill e ka përcjellë orarin e punës dhe vijueshmërinë e të gjithë shërbyesve civilë në kategorinë e Administratës Publike në të gjitha nivelet. Dhe, ka vlerësim se po thuaj se në të gjitha institucionet menaxhohet vijueshmëria në punë dhe respektimi i orarit të punës, i cili tanimë është në formë elektronike.

Po ashtu, është një vlerësim pozitiv të çështja e zëvendësimit të kontratave të nëpunësve civilë. Këtë vërejtje e kemi pasur vitin e kaluar në Raportin e Progresit dhe tanimë nuk ekziston. Pothuajse të gjitha institucionet që kanë të punësuar nëpunës civilë i kanë shndërruar kontratat me aktet e emërimit.

Te rubrika për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e njësive të personelit, shumica e institucioneve, si qendrore, ashtu edhe ato lokale, janë në përmirësim të zbatimit të gjitha rregulloreve dhe parimeve të shërbimit civil.

Këshilli për vitin 2013, për shkak të pamundësive buxhetore për t'i inspektuar të gjitha institucionet është detyruar ta hartojë një plan të kombinuar të monitorimit për organet e punësimit në nivel qendror dhe lokal nëpërmjet vizitave dhe pyetësorëve. Në këtë drejtim, ne do të sugjerojmë që të ketë më shumë buxhet, pra që ta kryejë punën e vetë deri në fund, siç duhet dhe siç e ka mision.

Nga të dhënat rezulton se nga 188 vendime për zbatim, organet e punësimit plotësisht i kanë zbatuar 142 vendime dhe ky është një vlerësim pozitiv për gjithë administratën shtetërore në vendin tonë. Pra, shihet që të gjitha institucionet kanë filluar t'i përfillin sugjerimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës.

Institucionet e Administratës Lokale - këshilli ka vendosur 152 ankesa kundër vendimit të institucioneve të administratës lokale, 147 prej të cilave janë të vitit 2013 dhe pesë ankesa të vitit 2012.

Këtu e kam një obligim të sqaroj, pasi tek administrata lokale e kemi një problem, i cili thekson se 30 ankimues në komunën e Vushtrisë janë paraqitur si shumicë në nivelin lokal. Mirëpo, në periudhën kur ka pasur ankimim, ne nuk e kemi pasur një rregullore në të cilën do të ishte bazuar komuna për t'i respektuar kërkesat e ankimuesve. Pra, ka qenë çështje e ndërrimit të periudhës, kur Ligji i shërbimit civil është ndryshuar, është amendamentuar dhe pjesa e administratës që shërben në njësitë e mësimdhënësve, pra që është administrata, nuk i takon shërbimit civil dhe këtu ka qenë vetëm një ngatërrësë.

Tek niveli lokal, e kemi një përmirësim të përgjithshëm të realizimit dhe implementimit të ligjeve.

Është interesant të theksohet se të gjitha nivelet, të tri nivelet e administratës në Republikën e Kosovës, i kanë të ndarë të njëjtët sektorë ku ka ankesa, pra përmbi 30% është administrata shtetërore, nivel lokal, nivel qendror, por po ashtu edhe tek institucionet e pavarura, gjykatat dhe agjencitë.

Ky këshill ka nevojë për zyre më të akomoduar, ka nevojë për punë më diskrete gjatë marrjes së dëshmive nga ankimuesit, pasi asnjë shërbyes civil nuk do të mund të shprehet hapur në prani të pesë personave në një zyrë. Pra, kjo është ankesa.

Ndërkaq, pa dyshim që Grupi ynë Parlamentar e vlerëson pozitivisht punën shumë të përgjegjshme dhe profesionale të anëtarëve të këshillit dhe do të votojmë për. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Edhe në komision dhe në kuadër të Grupit Parlamentar, pas shqyrtimit të raportit të KPM-së, ne e mirëpresim avancimin dhe pika kryesore në këtë raport për mendimin tim është numri i madh i lëndëve të implementuara, i vendimeve të KPM-së që është implementuar, dhe vetëm për kujtesën tonë, meqë para dy vjetëve, kur e kemi pasur raportin, numri i lëndëve të paimplementuara ka qenë diku rreth 44%, dhe tani në raportin e fundit e shohim se numri i lëndëve të paimplementume është disa, 40, 42 dhe të tjera.

Pra, është një avancim shumë i madh, prandaj ne inkurajojmë edhe KPM-në që të vazhdojë me këtë trend, ndërsa kërkojmë nga të gjithë kompetentët që të krijojnë mundësi dhe kushte më të mira për punën e KPM-së, dhe ndoshta shumë shpejt ne nuk do të merremi pastaj me numrin e lëndëve të paimplementushme, ngase nuk e ka kuptimin, sepse vendimet e KPM-së janë të formës së prerë, pra si shkallë e fundit administrative dhe ndoshta herën tjetër më shumë mund të merremi me performansën e vetë KPM-së, por jo që të kënaqemi pse po implementohen vendimet. Por, sot kemi të drejtë të jemi të kënaqur, ngase në të kaluarën kjo nuk ka qenë. Prandaj, kjo është edhe arsyeja kryesore që ne do ta mbështetim dhe do ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Nga “Vetëvendosje”, Afrim Kasolli, urdhëro!

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe si lëvizje ne e pranojmë këtë raport.

Konsiderojmë se këshilli brenda kapaciteteve që ka pasur ka arritur ta realizojë një punë profesionale me gjithë sfidat me të cilat është ballafaquar, ndoshta që nga mungesa adekuate e mjeteve financiare dhe sfidat tjera. Por, në njëfarë mënyre ka arritur ta monitorojë dhe ta vëzhgojë shërbimin civil në Republikën e Kosovës dhe t’i prezantojë të gjitha shkeljet që kanë ndodhur gjatë vitit 2013 në këtë segment të rëndësishëm të Administratës Publike. Ajo që është shqetësuese për shkak se këshilli në mungesë të mjeteve nuk ka pasur mundësi ta mbulojë kryesisht pjesën e ambasadave, pra do të thotë shërbyesit nëpër ambasada, dhe nuk kanë informata se çfarë ndodh nëpër ambasadat e Republikës së Kosovës në botën e jashtme.

Mbeten edhe disa shqetësime tjera, instancat e caktuara nuk i kanë respektuar në momentet e caktuara vendimet e këshillit, megjithëse ato vendime janë të formës së prerë dhe është obligim i të gjitha institucioneve të Shërbimit të Administratës Publike që t’i respektojnë këto vendime.

Këshilli për këtë moszbatim të vendimeve të tij e ka informuar me shkrim qoftë edhe Qeverinë, qoftë Kuvendin e Kosovës, qoftë eprorët e lartë të cilët nuk i kanë zbatuar këto vendime, por deri më tani është treguar një neglizhencë në këtë çështje, por sidoqoftë ne e

përshëndetim këtë raport për punën profesionale të këtij institucioni të pavarur kushtetues dhe si të tillë e miratojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Aleancës, Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Tash po e shfrytëzoj rastin. Faleminderit prej teje që po ma jep fjalën, mirëpo sikur të kisha pasur diçka personale, kisha ardhur në zyrë e të kisha thënë. Kryetar, e kam fjalën, megjithatë, ju vlerësojeni vetë, dje në seancë raporti për monitorimin e Ligjit të arsimit të lartë ka kaluar me 55 vota. 55 deputetë ishin të pranishëm, prandaj unë desha të diskutoj që do të ishte mirë të hidhet në votim, sepse nuk ka pasur kuorum dhe nuk mund të thuhet nuk kalon në momentin kur nuk ka kuorum. Kjo ishte arsyeja pse e kërkoja fjalën, por megjithatë vlerësojeni ju.

Kurse sa i përket raportit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, fatmirësisht e kemi një numër më të vogël të vendimeve të paekzekutuara të këtij këshilli, për çka Aleanca e ka përkrahur në komision, e njëkohësisht e përkrah edhe tani në seancë, mirëpo ne i kemi disa shqetësime që po e përcjellin shërbimin civil. Sikur edhe në pyetjen parlamentare që e kisha për ministrin e Administratës Publike, unë po ndalem pak a shumë te funksionet e këshillit, konkretisht tek ankesat e arritura sipas objektivit.

Te kompensimi i pagave dhe i shtesave, numri i ankesave është 140, çka do të thotë 30,39% janë vetëm për kompensim të pagave dhe shtesave, që edhe një herë për t'i treguar kësaj Qeverie që asnjëherë nuk është kujdesur të tregojë realisht se çfarë po bën dhe në fakt nuk po i zbaton ligjet vetë, për shkak se sikur rregulloret që kanë dalë nga ky ligj të implementoheshin ashtu sikurse janë, pra që janë të obliguar, e kam thënë edhe dje, po e them edhe sot, që nga 1 janari i këtij viti është dashur të fillojë të zbatuari Rregullorja për paga dhe shtesat. Prandaj, 140 kërkesa ose 30,39% nuk do të ishin si objekt i ankesave nga shërbyesit civilë.

Te zbatimi i vendimeve të këshillit nga organet e punësimit - ato kanë pasur obligim ligjor për t'i zbatuar 188 vendime të aprovuara nga këshilli, prej të tyre 149 vendime me të cilat ankesat janë aprovuar plotësisht, 10 vendime me të cilat ankesat janë aprovuar pjesërisht, si dhe 29 vendime me të cilat janë obliguar organet e punësimit që lëndët të kthehen në rishqyrtim. Përkundër këtij fakti që vendimet e këshillit janë të formë së prerë, që e kemi thënë vazhdimisht, në procedurë administrative nga të dhënat rezulton se 188 vendime për zbatim organet e punësimit plotësisht kanë zbatuar 142 vendime, pjesërisht e kanë zbatuar 1 vendim, ndërsa nuk i kanë zbatuar 27 vendime të këshillit. Megjithatë, edhe ky është një shqetësim edhe një vendim i pazbatuar i këshillit, duhet të jetë shqetësim për të gjitha institucionet.

Këshilli për 18 vendime nuk ka informata zyrtare nga organet e punësimit, nëse janë ekzekutuar apo jo. Kjo do të thotë që hezitojnë edhe t'i përgjigjen këshillit, pra thjesht ndoshta edhe për një informatë që institucionet janë të obliguara ta kthejnë në Këshilli. Këshilli për vitin 2013, për shkak të pamundësive buxhetore, e thanë edhe kolegët e mi për të inspektuar të gjitha institucionet, është detyruar që ta hartojë një plan të kombinuar

të monitorimit për organet e punësimit në nivelit qendror dhe lokal për mosvizita dhe pyetësorë.

Në bazë të këtij plani, këshilli ka realizuar 26 vizita monitoruese dhe e ka dërguar pyetësorin e 86 institucioneve qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës. Në pyetësorët e dërguar, të përgatitur në pajtim me rregullat dhe procedurat e ligjit, nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, janë përgjigjur 45 institucione, ndërsa 41 institucione nuk janë përgjigjur fare. Pra, ajo që mua më intereson dhe duhet t'u interesojë të gjithëve, janë 41 institucione pra që nuk janë përgjigjur fare. Këto janë shqetësimet që duhet të na preokupojnë dhe duhet të bëhet më shumë normal dhe këshilli të gjejë mekanizma se si ose thjesht të vetëdijesohen këto institucione se vendimet e këshillit janë të prera.

Prapë te klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil, problem më i madh që është edhe sot e kësaj dite, shumica e institucioneve ende nuk e kanë përfunduar klasifikimin e vendeve të punës, edhe pse ministri edhe dje tha që jemi në përfundim e sipër, një gjë e tillë në këtë raport nuk thuhet. Pra, është e kundërta.

Gjithashtu sistematizimi i vendeve të punës dhe rregullorja e brendshme, në pajtim me Rregulloren nr. 05/2012, pra për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli ka konstatuar se moszbatimi i rregullores ka ngecur me neglizhencën e institucioneve përgjegjëse për ta bërë klasifikimin e vendeve të punës, në mënyrë që të sigurohet një sistem i standardizuar i pagave. Pra, për të siguruar një sistem i standardizuar i pagave, kjo do të ishte në interes për tërë vendin, mirëpo kjo Qeveri nuk është e përgjegjshme dhe nuk i intereson të bëhet ky standardizim i pagave, sepse e ka interesin që të mbajë me kontrata mbi vepër shumë militantë partiakë.

Prandaj ne si Aleancë e kemi miratuar, po e miratojmë edhe sot këtë raport, mirëpo prapë shqetësohem se nuk është thjesht interesimi i kësaj Qeverie fatmirësisht në fund të mandatit të saj që ta bëjë një hap para, kështu ka ngecur 40 vjet në shërbimin civil, pra ka bërë që të shtohet numri i shërbyesve civilë dhe njëkohësisht nuk është interesuar që vendimet e këshillit të jenë vendime të prera pra dhe thjesht të zbatohen. Pra, nuk ka qenë dëshirë, nuk ka qenë vullnet i kësaj Qeverie që këto vendime të aprovohen. Faleminderit!

KRYETARI: Sa i përket shqyrtimit të raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, dje kryesuesi, përkatësisht nënkryetari dy herë e ka hedhur ë në votim. Prania ka qenë e mjaftueshme, nuk ka qenë vullneti i deputetëve të votojnë.

(Reagime nga salla.)

KRYETARI: Deputete, në sallë ka pasur më shumë se 61 deputetë kur është hedhur në votim.

(Reagime nga salla.)

KRYETARI: Deputete, ne kemi mirëkuptim për secilin angazhim të deputetit, por nuk ka mundur të hyjë në procesin e votimit pa qenë prania fizike së paku 61 deputetë.

Po, nuk është e vërtetë, se i kanë numëruar njerëzit! Asnjë votim, deputete, nuk e bëjmë pa e numëruar praninë e deputetëve në sallë.

(Reagime nga salla.)

KRYETARI: Shiko, unë jam i bindur se kanë qenë mbi 61 deputetë në sallë. Pse deputetët nuk votojnë, edhe unë shpeshherë po ua tërheq vërejtjen, që të keni vëmendje kur të votoni. Deputete dëgjo, se nuk e kam ndërmend të të besoj ty më shumë se këtyre të tjerëve. Nëse komisioni përkatës diskuton me grupet parlamentare dhe e bën kërkesën për ta futur këtë raport në votim, e futim, përndryshe raporti nuk është votuar.

Vazhdojmë. Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Përhëndetje për ministrin dhe për deputetët,

Duke marrë parasysh se raportet vjetore të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shkërbimin Civil të Kosovës ne i kemi çdo vit brenda Kuvendi të Kosovës, mirëpo për arsye që këto raporte vijnë me një vit vonesë në bazë të ligjit, mund të themi se të gjitha ankesat, kërkesat dhe realizimi i kërkesave të shërbyesve civilë tregojnë realitetin në të cilin ndodhet Kosova për momentin për arsye se ky është realitet ballkanik dhe nuk do të jetë shumë e lehtë çështja e rregullimit për shërbimin civil në Kosovë.

Në raport mund të themi se është paraqitur gjendja faktike, mirëpo dihet që vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil janë të pakthyeshme. Në parim mund të themi se raportin si të tillë, Koalicioni për Kosovë të re i jep përkrahje. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+” nuk është lajmëruar. SLS-ja nuk është këtu. Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Ne e kemi marrë një raport të këshillit dhe aty prezantohet puna e kënaqshme e tij. Siç u tha edhe nga kolegët më parë, e kemi vizituar Këshillin edhe në vendin e punës në kushte jo të kënaqshme, megjithatë i ka rezultatet e veta të punës, por nuk mund të thuhet se nuk ka reflektuar edhe në efikasitetin e gjithë asaj pune.

Në faqen 25 të raportit të punës jepen vendimet e këshillit, zbatimi i vendimeve të këtij këshilli dhe pa e përmendur, pa i përsëritur shifrat të cilat veç janë të evidentuara këtu, unë do të ndalem në një çështje për të cilën kemi pasur interesime më herët të drejtpërdrejta dhe e kemi pyetur edhe ministrin Jagxhilar në pjesën e dëmtimit të buxhetit

nga moszbatimi i vendimeve të këshillit, me gjithë fuqisë kushtetuese që e ka ai përmbartim kushtetuese dhe ajo në të cilën do të isha ndalur, ta kisha theksuar në këtë rast, është pse nuk merren asnjëherë masa nga eprorët apo nga punëdhënësit dhe pse ndodh kjo, edhe dëmtimi i buxhetit, edhe kur dihet se ata bëjnë shkelje ligjore dhe kushtetuese.

Prandaj, është momenti i fundit që të ndalet dhe të shikohen të gjithë ata që nuk i zbatojnë këto vendime, nëse duhet t'i lëmë të qetë dhe nganjëherë në disa raste disa edhe avancohen, me gjithë këtë performancë të dobët që ata vazhdimisht e bëjnë me këto shkelje ligjore, por duhet të ndalemi në atë se a duhet të japin llogari që edhe bëjnë shpenzim të buxhetit, edhe bëjnë shkelje të ligjeve dhe të Kushtetutës tonë.

Prandaj, duhet të ndalemi këtu duke filluar nga kryeministri, ministrat dhe zyrtarët tjerë të lartë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Unë desha dy-tri fjalë në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në raportin vjetor është i obliguar që sipas nenit 101, dhe 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, është i obliguar t'ia bashkangjes edhe raportin financiar.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës ku kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Anëtarët e Komisionit kanë ngritur disa çështje, të cilat kanë pasur të bëjnë me tejkalimin e shpenzimeve në disa kategori, si shërbimet kontraktuese, pajisjet tjera, shërbime, shpenzimet për informim publik dhe një pjesë, një tejkalim të shpenzimeve edhe për drekat zyrtare.

Pasi që komisioni i ka marrë arsyetimin nga Këshilli i Pavarur, përfaqësuesit e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, unanimit e ka përkrahur raportin. Ky këshill ka pasur një buxhet prej 251 716 euro, kurse ka shpenzuar 247 mijë e 716 euro çka do të buxheti i këtij institucioni është shpenzuar 98,40%, ku 98,84% janë shpenzuar për paga dhe mëditje, 98,04% për mallra dhe shërbime dhe 84,93% për shpenzime komunale. Nuk ka pasur mjete për investime kapitale.

Komisioni unanimit e ka përkrahur kështu që rekomandoj që deputetët ta përkrahin raportin financiar që i është bashkangjitur raportit të punës së këtij Këshilli të Pavarur Mbikëqyrës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Xhafer Tahiri.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe unë kam parë Raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe kam lexuar atë me vëmendje.

Vërej se Këshilli është duke kryer detyrën e vet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin dhe falë vendosmërisë së këtij Këshilli dhe pavarësisë së tij, vetëm këto ditë të fundit janë anuluar tri procese të përzgjedhjes së drejtorëve të departamenteve, dy në MPJ, dhe një në MASHT, përkatësisht drejtori i Departamentit të Shkencës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të cilat konkurse është tentuar të zgjidhen këshilltarët e ministrave aktual të këtyre dy ministrive në ikje, pra ka pasur tentime dhe vazhdon të ketë tentime gati në të gjitha ministrinë që nga stafi politik të emërohen në Shërbimin Civil, tash në këtë kohë të fundit.

Prandaj, unë me këtë rast i bëj thirrje Këshillit të Pavarur që të jetë vigjilent në këto raste. Sigurisht që LDK është duke i shënuar këto raste dhe do të rivendos ligjshmërinë në secilin rast pasi ta formojë Qeverinë e saj. Konsideroj se kjo dinamikë e re e Këshillit është meritë edhe e përbërjes së re të Këshillit ku janë emëruar njerëz profesional, të pavarur dhe me kredibilitet të lartë. Sigurisht që Këshilli dhe anëtarët e Këshillit duhet të vazhdojnë të mbeten plotësisht të pavarur në secilin rast që ata e trajtojnë.

Nuk mund të lë pa përmendur këtu faktin që e thanë edhe kolegët e tjerë se buxheti i Këshillit është shumë i vogël për të e quajtur një buxhet qesharak dhe e kufizon shumë Këshillin në kryerjen e funksioneve të monitorimit e të zbatimit të legjislacionit të Shërbimit Civil, si dhe funksionin e vëzhgimit të procesit të përzgjedhjes së pozitave të nivelit drejtues në Shërbimin Civil.

Po ashtu, Këshilli kryen funksionet e veta në një hapësirë shumë të vogël dhe në një gjendje të mjerueshme ashtu qysh e thanë edhe kolegët nga komisioni përkatës, të cilët e kanë vizituar Këshillin në vendin e tyre të punës.

E gjithë kjo për mendimin tim bëhet për faktin se kjo qeveri me sjelljen e saj ndaj Këshillit, me hapësirën dhe buxhetin e vogël që ia ka ndarë tenton të ndërhyjë në pavarësinë e këtij institucioni të rëndësishëm të vendit tonë.

Buxheti i Këshillit duhet të thënë se është nga buxhetet më të vogla që i është ndarë një institucioni të pavarur, pastaj nuk mund të lëmë këtu pa përmendur rastet kur ka pasur tentim të ndërhyrjes në pavarësinë e Këshillit Mbikëqyrës të pavarur të Shërbimit Civil madje në mënyrë publike dhe kujtoj këtu rastin e deklaratës së ministrit të Punëve të Brendshme, i cili në mënyrë të paligjshme praktikisht ka vepruar me shërbyesit civil dhe pas veprimit të Këshillit dhe rivendosjes së ligjshmërisë në mënyrë publike e ka kritikuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil.

Konsideroj se këto lloj deklaratash e cenojnë pavarësinë e Këshillit dhe secili ministër, madje dhe vetë kryeministri duhet të ndërmarrë masa që të tilla raste të mos ndodhin asnjëherë në të ardhmen.

Për fund, dua të konstatoj se ky këshill është duke e kryer punën e vet në mbështetje të ligjit dhe është duke vendosur standarde të punës profesionale dhe të pavarur, të cilat duhet t'i marrin si model edhe institucionet e tjera të pavarura. Faleminderit!

KRYETARI: Diskutuesi i fundit është deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Konsideroj që raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është një raport i mirë me të cilat është paraqitur tek deputetët e Parlamentit, dhe njëkohësisht ka marrë edhe miratimin e komisionit, mirëpo në krejt këtë raport përkundër faktit që vendimet e Këshillit janë të formës së prerë në shumë institucione të vendit, qoftë ato lokale apo edhe këto qendrore, edhe njëkohësisht nga agjencitë e ndryshme këto vendime nuk po implementohen. Dhe, unë konsideroj që mos implementimi i këtyre veprimeve i kushton buxhetit të Kosovës dhe shumë raste të tilla të shërbyesve civil kemi edhe nëpër gjykata në të cilat nuk po marrin ende vendimin e prerë dhe po kthehen zakonisht mbas një viti apo dy vjetëve dhe kjo i kushton shumë buxhetit të konsoliduar ose buxhetit të Kosovës, në përgjithësi.

Prandaj, konsideroj që institucionet e Kosovës, qofshin ato lokale, qofshin vendore duhet t'i implementojnë vendimet të cilat i jep Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. Tek fushat mbikëqyrëse në Shërbimin Civil me të cilin janë paraqitur në këtë raport, kemi të bëjmë me njësitë e personelit ku vlen të theksohet se menaxherët apo udhëheqësit e personelit ende nuk kanë rolin, përgjegjësinë dhe ende nuk kanë autorizime që u takojnë sipas ligjit. Dhe, me të drejtë në këtë rast Këshilli ka rekomanduar zyrtarët kryesorë administrativë që menaxherët... t'u njihet pavarësia profesionale.

Po ashtu, një çështje tjetër që ka të bëjë Këshilli ka konstatuar se disa institucione kanë vende të lira të punës dhe nuk posedojnë me rekrutimin në pajtim me ligjin, por i mbajnë me ushtrues detyre. Ka shumë institucione, qoftë ato lokale apo qendrore, edhe më mirë të them më shumë ato qendrore që në shumë dikastere, në shumë drejtori, departamente vazhdojnë që këtë detyrë t'i ushtrojnë me ushtrues detyre, gjë që bie në kundërshtim me ligjet e Shërbimit Civil në përgjithësi.

Po ashtu, një çështje shumë e rëndësishme me të cilën ne tash kemi miratuar edhe Ligjin për aftësimin dhe riaftësimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara obligohen institucionet qendrore dhe ato lokale që në çdo të 50-in të punësuar duhet të punësohet edhe një person me aftësi të kufizuara. Dhe, ky obligim ligjor ende nuk po përmbushet në institucionet e Kosovës dhe mendoj që do të ishte mirë që edhe në këtë rast edhe Qeveria, edhe agjencitë tjera të pavarura, njëkohësisht edhe niveli lokal ta respektojë ligjin edhe njëkohësisht të ketë një kujdes të veçantë pra për personat me aftësi të kufizuara.

Një çështje e cila u ngrit këtu edhe nga deputetët e Parlamentit edhe nga grupet tjera parlamentare u tha se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës ushtron punën dhe veprimtarinë e tij në kushte jashtëzakonisht të rënda. Unë konsideroj që Qeveria e Kosovës dhe

institucionet e vendit duhet që urgjentisht të krijojnë hapësira më të mira për punësim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, sepse konsideroj që puna e tyre po e dëshmon veten edhe në raport, njëkohësisht po e dëshmon veten edhe në të gjitha institucionet e vendit, qoftë ato të nivelit qendror, po ashtu të nivelit lokal. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka më të lajmëruar për diskutim. Unë e shoh të arsyeshme të jap dy informacione. Informacioni i parë: nivelimi i pagave ka qenë i përfunduar në legjislaturën e parë dhe rezervë për t'u realizuar ai kanë pasur 7 milionë euro.

Legjislatura e dytë nuk e ka realizuar nivelimin e pagave dhe ka filluar me ushtrues detyre. Ushtruesit e detyrës kanë filluar prej qeverisjes së parë, të dytë në fund të vitit 2004 dhe si duket ka mbetur sëmundje për të vazhduar deri sot, gjë që nuk është e mirë. Dhe, një çështje mendoj që nuk u ngrit këtu dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa është dashur ta dijë, u tha se në raport shkuan diku 104 vetë janë kthyer në punë. Por në ato 104 vende kanë qenë edhe 104 punëtorë tjerë, sa është dëmtuar buxheti i Kosovës duke paguar paga të dyfishta.

Mendoj që kjo është dashur të thuhet në raport, ose është dashur të thuhet në raport, në fjalën e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Të pranishëm i kemi 71 deputetë, kështu që mund të votojmë. Praninë gjithnjë e themi edhe në seancën e djeshme kanë qenë 62 deputetë të pranishëm, por kanë votuar herën e parë 55, dhe herën e dytë 56.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Konstatoj se me 69 vota për, asnjë kundër, një abstenim. Kuvendi miratoi raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2013.

11. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar për miratim.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, Qeveria s'është këtu. Edhe këtë pikë të rendit të ditës e shtyjme.

12. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për

emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Arsimit, zotin Buja që ta prezantojë çështjen.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Propozim vendimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës bëhet konform Ligjit për veprimtaritë kërkimo-shkencore.

Lista me emrat e anëtarëve të Këshillit është gjithëpërfshirëse në kuptimin e përfaqësimit të institucioneve gjegjëse shkencore me arsyetimet për punën, hulumtimet dhe rezultatet në shkencë, të cilat i kanë ofruar .. dhe vetë kandidatët.

Komisioni Funkcional për Arsim i Kuvendit dhe deputetët janë të njoftuar me CV-të e të gjithë kandidatëve, ky propozim vendim është përkrahur edhe nga Komisioni për Arsim duke besuar se propozimet që kanë arritur nga institucionet gjegjëse të përkrahur nga MASHT-i dhe Qeveria janë propozime të qëlluara dhe të arsyetuara me punën e deritanishme, me bindjen se do të arrijnë të kryejnë misionin e vet konform ligjit dhe strategjisë për shkencën, ju ftoj deputetë të nderuar që ta votoni këtë përbërje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

E ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zotin Ramë Vataj për arsyetimin e raportit me rekomandime.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 62.1. të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2014, shqyrtoi propozim vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04 / 172 të datës 27 shkurt 2014 lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim që të miratohet propozim vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e 15 anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës.

Në pajtim me nenin 42, të Ligjit nr. 04/L-135 për veprimtarinë kërkimore- shkencore anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës emërohen nga Kuvendi me propozim të Qeverisë, ndërsa mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës është katër vjet.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur, më 31 mars 2014, e shqyrtoi propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 27 shkurt 2014 për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe vlerësoi se anëtarët e propozuar i plotësojnë kushtet për

emërim sipas dispozitave të nenit 42 dhe 43 të Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore dhe vendosi për miratim të kësaj liste. Faleminderit!

Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, e do dikush fjalën? Ramë Vataj, përsëri a? Ke mund ta kryeje përnjëherë

RAMË VATAJ: Këshilli Kombëtar i Shkencës është një organ shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e shkencës dhe arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe puna e këtij këshilli është e rregulluar me Ligjin për veprimtari kërkimore- shkencore.

Ka pasur një mungesë të funksionimit të këtij këshilli, ka mbi dy vjet dhe kjo është bërë për arsye se një ligj që ka ardhur në fillim, nuk ka qenë aq si me thënë, e përfaqësuar mirë, ndërsa në mes listës propozimit të parë dhe të dytë ka marrë një kohë të gjatë, prandaj ne e mirëpresim këtë listë.

Unë mendoj që ka njerëz shumë të fuqishëm, shkencëtarë që i bëjnë nder edhe shkencës së Kosovës edhe shkencës së vendeve ku këta janë shkolluar. Prandaj, edhe institucionet shkencore duhet të mburren me emrat që i përmban kjo listë. Është e domosdoshme që të miratohet, sepse po ta kishim funksionimin e këtij këshilli me kohë, qysh para dy vjetësh, kur i ka përfunduar mandati, ne shumë probleme që kemi hasur tash në funksionimin, sidomos të arsimit të lartë dhe institucionet shkencore, nuk do t'i kishim, sepse ky këshill ka edhe me ligj është, si me thënë, i fuqizuar që të monitorojë veprimtarinë kërkimore, shkencore sikur në institucionet shkencore, po ashtu edhe në institucionet e arsimit të lartë dhe në njëfarë mënyre e bëjnë monitorimin e mbarëvajtjes dhe nivelit të gjendjes së shkencës apo nivelit shkencor në të gjitha institucionet që merren me shkencë.

Ne e përkrahim këtë listë, prandaj kërkojmë edhe prej kolegëve të tjerë deputetë, që ta miratojnë, sepse është e domosdoshme, që Kosova të ketë të funksionalizuar Këshillin Kombëtar të Shkencës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike s'është lajmëruar kurrkush. Në emër të Grupit të "Vetëvendosjes" Albulena Haxhiu e ka fjalën. Nuk është. Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja "Vetëvendosje" ka shqyrtuar listën e propozuar, propozimin e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Arsimit për emërimin e anëtarëve në Këshillin Kombëtar të Shkencës.

Padyshim, ne konsiderojmë që këtu ka shumë emra, të cilët janë të mirë dhe i kanë bërë nder veprimtarisë shkencore, mirëpo bindja jonë është se do të ishte më mirë që këta anëtarë të votohen një nga një dhe jo në pako, për shkak sepse edhe veprimtaria e tyre është individuale dhe nuk është e përbashkët, kolektive.

Kështu që konsiderojmë që zgjidhja do të ishte më ideale sikur për secilin të përcaktoheshin deputetët se për cilin do të votonin. Këtë e konsiderojmë instrumentin më të mirë për të zgjedhur këtë organ të rëndësishëm të veprimtarisë shkencore. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar listën e Këshillit Kombëtar të Shkencës. Edhe ne konstatojmë që ka qenë shumë më mirë që individualisht të votoheshin këta anëtarë, megjithëse shumë prej tyre i bëjnë nder kësaj liste, i bëjnë nder shkencës, sepse ka emra shumë të mirë, siç është emri i Eda Vulës dhe shumë shokëve e kolegëve të saj brenda asaj liste, por, megjithatë ne jemi që kjo listë të miratohet, për shkak se nuk mund t'i ndajmë. Mirëpo thashë, ka qenë shumë më mirë që të ishin votuar në mënyrë individuale.

Pra, konsiderojmë që ka edhe të tjerë jashtë kësaj liste, mirëpo çka desha të them është që shumë prej tyre, që janë brenda kësaj liste kanë qenë të befasuar, se nuk e kanë ditur se janë në këtë listë.

Për mua është një shqetësim pse nuk janë informuar me kohë apo ndoshta nuk është konsultuar edhe vetë Ministria me ta. Kështu unë kam biseduar personalisht me disa prej tyre dhe pasi që ne e kemi parë listën, më kanë thënë që ne nuk jemi të informuar se jemi në këtë listë.

Prandaj, unë edhe njëherë unë ju uroj punë të mbarë të gjithë këtyre anëtarëve, pa dashur për t'i veçuar, por thashë ka shumë emra prej tyre që i njoh, që janë shumë të mirë, që i bëjnë nder shkencës, po ka edhe disa të tjerë të cilët ndoshta është dashur në mënyrë individuale të votoheshin në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Ligji e përcakton atë. Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar listën e propozuar nga Qeveria për Këshillin Kombëtar të Shkencës dhe të njëjtës i jep përkrahje.

Pra, ne ftojmë që kjo listë të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+” Albert Kinolli ka kërkuar fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë rekomandim të Komisionit për Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e 15 anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës.

Ne do ta votojmë këtë rekomandim, mirëpo me të vetmen vërejtje, që në këtë listë prej 15 emrave është de facto, që ekziston një anëtar i komunitetit serb, mirëpo kjo nuk nënkupton që janë përfaqësuar të gjitha komunitetet tjera. Me këtë vërejtje ne do ta miratojmë këtë listë. Faleminderit!

KRYETARI: Të lajmëruar për diskutim nuk kemi. Vazhdojmë me procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash. Prezent janë 70 deputetë, prezenca fizike, elektronike janë 83.

Nuk kalon. Do të thotë, janë 48 vota për, 1 kundër, asnjë abstenim. Dhe, nuk marrin pjesë 60 deputetë. Jo, asnjë herë më.

Këtu, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, as s’mori pjesë në diskutim, as në votim. Kështu që, s’kemi çka e qesim në votim. Nuk kaloi. E drejta e tyre është të...

Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:

13. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Shoqata e Prokurorëve të Kosovës, ia kanë paraqitur Kuvendit propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, në bazë të nenit 3, pika 3 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, ka shqyrtuar propozimet për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar propozimin dhe ka konsideruar që i plotëson kushtet formalo-juridike dhe i rekomandon seancës që ta përkrahë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e do dikush fjalën? Fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, kryetar! Grupi Parlamentar do ta votojë rekomandimin e Komisionit për Legjislacion.

KRYETARI: Lidhja Demokratike, e kreu ndoshta Arbeni. “Vetëvendosja”, s’është lajmëruar. Aleanca, jo. Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Edhe Koalicioni për Kosovë të Re përkrah rekomandimin e Komisionit për Legjislacion.

KRYETARI: Nuk ka të lajmëruar për diskutim, shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash. Prezentë 69 deputetë, prezencë fizike, elektronike 83.

Nuk kalon. 48 vota për, asnjë kundër, 2 abstenime.

(Ndërprerje e incizimit.)

Vazhdojmë me pikën e katërbëdhjetë:

14. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Propozimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore e ka shqyrtuar Komisioni Funkcional për Legjislacion dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratimin e tij.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, deputetin Arben Gashi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!
Po ashtu, komisioni ka shqyrtuar edhe këtë rekomandim dhe ka konstatuar se i plotëson kushtet formale-juridike dhe i rekomandon seancës që ta përkrahë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe e përkrah në këtë seancë.

KRYETARI: “Vetëvendosja” s’është lajmëruar. AAK-ja s’është lajmëruar. Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Edhe Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje rekomandimit të Komisionit për Legjislacion për vendosjen e emërimit të anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

KRYETARI: Të lajmëruar për diskutim nuk kemi. Shkojmë në procedurën e votimit. Votojmë tash.

Me 61 vota për, 6 kundër, 1 abstenim, Kuvendi emëroi Adem Vokshin anëtar në Komisionin për Kërkesa Pronësore, me mandat njëvjeçar.

Vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë:

15. Zgjedhja e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Medie e ka shqyrtuar nominimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit i ka rekomanduar për votim dy kandidatë, Albana Beqiraj dhe Abit Hoxha.

E ftoj kryesuesen e Komisionit ad hoc, deputeten Xhevahire Izmaqu, që para deputetëve ta arsyetojë rekomandimin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pra, Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve për Komisionit të Pavarur për Medie, në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 mars 2014, zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve të nominuar për anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie, me votim të fshehtë, për një anëtar të KPM-së nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar propozohen kandidatët si në vijim, Albana Beqiraj dhe Abit Hoxha.

Kuvendi prej dy kandidatëve zgjedh një anëtar të KPM-së.

Mandati i anëtarëve të KPM-së caktohet me short. Dy anëtarë me mandat dyvjeçar, tre anëtarë me mandat trevjeçar dhe 2 anëtarë me mandat katërvjeçar.

Shorti për mandatin e anëtarëve të KPM-së është bërë pas emërimit të 3 anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës, më 19 mars 2014.

Pas tërheqjes së shortit për mandatin e anëtarëve të KPM-së kanë mbetur 1 pozitë për mandat dyvjeçar dhe 2 pozita për mandat trevjeçar. Andaj mandati i 1 anëtari do të caktohet me short pas emërimit nga Kuvendi i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ju njoftoj se në pajtim me nenin 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe në pajtim me rekomandimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, prej 2 kandidatëve të propozuar, deputetët me votim të fshehtë votojnë për njërin kandidat të propozuar, me shumicën e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues me përbërje nga deputetë prej secilit grup parlamentar, me mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Atëherë, po fillojmë me nominimin e këtyre anëtarëve të komisionit. Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kryetari i Grupit Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Për anëtar të Komisionit propozojmë Ramë Vatën.

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: LDK-ja e propozon deputetin Armend Zemaj.

KRYETARI: Vetëvendosje, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e propozon Albana Gashin.

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Aleanca, propozon deputeten Teuta Haxhiu.

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Koalicioni për Kosovë të Re, propozon deputetin Jeton Svirca.

KRYETARI: Dhe “6+”, kryetarja Mufera Shinik e ka fjalën.

MUFERA SHINIK: Grupi Parlamentar “6+” e propozon deputetin Fikrim Damka.

KRYETARI: Faleminderit! SLS, nuk është këtu. Na duhet një votim formal, por s’di a i kemi numrat.

Regjia, i bie ziles se deputetët kanë shkuar për kafe!

Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar!
Kërkoj ndjesë, por në vend të deputetit Jeton Svirca, në komision do të jetë deputetja Sevdije Lama.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, prezentë i kemi 79 deputetë dhe na duhet një votim formal.

Kush është për Komisionin? Faleminderit! Kundër? Nuk ka. Lus anëtarët e Komisionit që t'i zënë vendet e tyre. Do të kishte qenë mirë të shtohet numri i deputetëve, bile të kalohet numri 80, që të përsërisim votimin që i kërkon 2/3 e deputetëve të Kuvendit.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: A jeni gati për të vazhduar?

Atëherë, Adem Grabovci, Afërdita Berisha-Shaqiri...

Ju, komisioni në qoftë se doni t'i jepni fletëvotimet qysh doni ju, atëherë unë s'po i thërras me emra, dhe ose respektoni thirrjen me emra, e unë s'po thërras e ju ua jepni kush të vijë fletët dhe atëherë e konsiderojmë valid.

Afrim Hoti, Afrim Kasolli, Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Arsim Bajrami, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Ardian Gjini, mungon, Armend Zemaj, Aurora Bakalli, Azem Sylja, Bahri Thaçi; Bali Muharremaj, Berat Buzhala, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostiq, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Burim Ramadani, Danush Ademi... Daut Haradinaj, Sala Berisha-Shala, Donika Kadaj-Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Etem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Goran Marinkoviq, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Hashim Dëshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami; Emin Gërbeshi, Haxhi Shala, Xhavit Uka, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi; Faton Topalli, Lirije Kajtazi, Lumniçe Morina, Hatim Baxhaku, Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Novobërdaliu, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kymete Bytyçi, Sasha Millosavljeviç, Petar Miletiç, Rada Trajkoviç, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Xhafer Tahiri, Salih Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiç, Milivoje Stojanoviç, Sevdije Lama, Shaip Muja, Skender Hyseni, Boban Todoroviç, Sreten Ivanoviç, Teuta Haxhiu, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, ka votuar, Ukë Rugova, s'është, Vesimir Saviç,s'është, Vesna Mikiç,s'është, Visar Ymeri, s'është, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani,s'është, Valbona Dibra, Xhevahire Izmaçu, Xhevdet Neziraj , Zenun Pajaziti dhe Xhavit Haliti.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit, zoti Ramë Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni ad hoc për numërimin e votave do të fillojë numërimin e votave në mënyrë transparente.

Në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë.

Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, E pavlefshme, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, E pavlefshme, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Albana Beqiraj, Albana Beqiraj, E pavlefshme, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, E pavlefshme, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Albana Beqiraj, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, E pavlefshme, Abit Hoxha, Abit Hoxha, Abit Hoxha, E pavlefshme dhe Albana Beqiraj.

Tash në fund do të bëjmë verifikimin e votave dhe do ta lexojmë vendimin përfundimtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Komisionit ad hoc për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, jap këtë raport për rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarit të Komisionit për Media, në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit, më 11 prill 2014, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar: Ramë Vataj, nga PDK, Armend Zemaj, LDK, Albana Gashi, Vetëvendosje, Teuta Haxhiu, AAK, Sevdije Lama, AKR, Fikrim Damka, Grupi 6+.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar, në mbledhjen plenare të mbajtur më 11 prill 2014, konstaton:

Në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë, të pavlefshme janë 6 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Albana Beqiraj ka fituar 26 vota,
- Abit Hoxha ka fituar 51 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të

nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zoti Abit Hoxha, emërohet anëtar i Komisionit të Pavarur për Media nga radhët e komunitetit shumicë shqiptar.

Pasojnë nënshkrimet e anëtarëve të Komisionit, ndërsa i urojmë sukses anëtarit të porsazgjedhur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Vataj. Pas kësaj pike, tani e përfundojmë seancën. Mirupafshim në mbledhjen e ardhshme!

* * *

E enjte, 17 prill 2014

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 10 e 11 prill

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të pranishëm janë 71 deputetë.

Pikat e mëhershme që i kemi duhet të votohen nga 80 deputetë. Ne nuk i kemi 80 deputetë, i mi 71 deputetë.

A po e bëjmë një votim për praninë? Përgatitu regji dhe ju deputetë, për të votuar për praninë elektronike. Votojmë tash!

Prania fizike 83 deputetë.

Edhe një herë votojmë për praninë fizike. Votojmë tash!

A ka pa kartelë? Rita Hajzeraj. Mirë de, unë po e përdor veç njërin. Në sallë janë 83 deputetë. Megjithatë, shkojmë në votim.

- Miratimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”

Në seancën plenare të mbajtur më 10 prill 2014, me rastin e votimit është konstatuar se miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes me 78 vota për me elektronikë, dhe 2 vota për me ngritje dore, mirëpo në ndërkohë u konstatua se një deputet ka votuar 2 herë.

Prandaj, shkojmë në votim edhe një herë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se Kuvendi me 80 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratoi Ligjin numër 04/L-271 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese e lidhur ndërmjet

Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”.

- *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës*

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar, mirëpo në mungesë të kuorumit procedimi me votim është shtyrë.

Nuk i kemi minoritetet. Vazhdojmë.

Më falni, nuk është komuniteti serb, prandaj duhet votimi i dyfishtë, këtu problemi është.

Mirë, unë po e pranoj vërejtjen prej ju të tjerëve.

- *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës*

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin Berndard Nikaj, si propozues i çështjes.

MINISTRI BERNARD NIKAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Zonja e zotërinj,

Më lejoni të paraqes para jush vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 02/171 të datës 19 shkurt 2014, nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Kosovës, për kryesues dhe anëtarë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:

- Ahmet Krasniqi, kryesues,
- Halit Shabani, anëtar,
- Ramë Manaj, anëtar, dhe
- Arbnor Kastrati, anëtar.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve është bërë duke marrë për bazë Ligjin numër 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, përkatësisht nenin 25. 4, në mbështetje të Ligjit numër 03/L-189 për Administratë Shtetërore të Republikës së Kosovës, nenit 39, po ashtu Rregulloren e punës së Qeverisë 09/2011, neni 75 pikën 3, si dhe duke u bazuar në Rregulloren numër 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, neni 16 pika 6 dhe 7.

Vendimi i Qeverisë numër 02/171 është marrë në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 25 të Ligjit numër 03/L-229 për mbrojtje të konkurrencës dhe duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren numër 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, numër 09/2011.

Vendimi i Qeverisë, së bashku me biografitë e të propozuarve është proceduar për shqyrtim dhe emërim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 21 shkurt 2014.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Unë gjithashtu kisha përmendur edhe rëndësinë qenësore të këtij komisioni për implementimin e plotë të Marrëveshjes së Stabilizim-Aociimit dhe ashtu duke pasur parasysh edhe atë që u përmend më lart, ju ftoj që ta votoni dhe ta miratoni këtë vendim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe të njëjtin e ka aprovuar në komision.

Më lejoni të sqaroj pse është vonuar deri tash. Meqenëse në herën e parë të votimit kanë qenë 6 anëtarë të Komisionit, pra i kemi bërë dy herë krejtësisht gjithsej kemi votuar për këtë propozim të Qeverisë, në herën e parë kanë qenë 6 anëtarë, kanë qenë 3 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim.

Ne e kemi përcjell si vendim të tillë, pastaj Kryesia e Kuvendit ka kërkuar të votohej prapë në komision, meqenëse numri nuk ka qenë i mjaftueshëm, dhe votimin e kemi tentuar si Kryesi, ta interpretojë Kryesia ose Zyra Ligjore dhe të vazhdohet më tutje. Vonesa ka ndodhur për shkak të insistimit të Kryesisë që të votohet përsëri në komision.

Më lejoni po ashtu të konfirmoj edhe atë që ministri e tha rëndësinë e madhe që e ka për proces ky funksionimi normal i këtij komisioni dhe në raport me MSA-në, mendoj që është koha e duhur që ta çojmë përpara dhe ta kompletojmë këtë në bord dhe rrjedhimisht funksionimin normal të këtij institucioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, nuk e kemi asnjë paraqitje. A do kush paraqitje? Nuk ka.

Atëherë, ju e dëgjuat propozimin. Në sallë janë të pranishëm 80 deputetë. E vë në votim propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërtimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Votohet tash!

Pra, kemi një korreksion, janë tash të pranishëm janë 82 deputetë krejt. Kemi votimin: 7 kundër, 36 për dhe 1 abstenim. Nuk ka kuorum për vendimarrje.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*